

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje të sigurisë - 3

ÇËSHITJE TË SIGURISË *Security Issues*

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 3, pranverë 2007

Bordi botues:***Kryetar***

Gj. Lt. (rez.) Pëllumb Qazimi

Anëtarë

Prof. dr. Dhori Karaj – Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale

Franko Egro – Publicist, Kryeredaktor i TV Koha

Agri Verrija – Këshilltar i Kryeministrit

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Konsulentë

Geron Kamberi – M.A. në Studime Evropiane

Artan Karini – M.A. në Administrim Publik

Redaktor Përgjegjës

Enis Sulstarova – M. Sc. Shkenca Politike dhe Administrim Publik

*Ky numër i revistët botohet me mbështetjen financiare
të Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s në Bruksel dhe të
Birra Korça*

PËRMBAJTJA

Bordi botues

Shqipëria drejt anëtarësimit në NATO 2008: Përmbledhje e dy veprimtarive 7

Intervistë me Tom Ridge

Funksionimi i sistemit demokratik, sundimi i ligjit dhe ekonomia e tregut janë sfida të vazhdueshme për demokracitë 17

Prof. Dr. Servet Pëllumbi

Partitë politike dhe çështjet e sigurisë 24

Gary King dhe Christopher J. L. Murray

Rikonsiderimi i sigurisë njerëzore (I)

Zana Xhuka

Strukturat e Sigurisë dhe të Mbrotjes në Epokën e Informacionit 50

Jeffrey Winbourne dhe dr. Velizar Shalamanov

Menaxhimi i Urgjencave si Shtyllë e Sigurisë Civile: Një Qasje Praktike 60

Theodosia Georgiu dhe Matheu Vaikusis

Mundësi reale për integrimin në NATO për Shqipërinë dhe për vende të tjera të Ballkanit Perëndimor 80

Ivo Daalder dhe James Goldgeier

NATO-ja Globale 88

Paul Saveroux

ABC-ja e Direktivës gjithëpërfshirëse politike 99

Friedrich Steinhäusler

Kërcënimet terroriste ndaj vendeve të NATO-s 107

Kol. (rez.) Selim Shiroka

Lidershipi politik e ushtarak dhe roli i tij për sigurimin
kombëtar 115

English Summary 127

SHQIPËRIA DREJT ANËTARËSIMIT NË NATO 2008: PËRMBLEDHJE E DY VEPRIMTARIVE

Muajt e fundit janë intensifikuar veprimtaritë publike në lidhje me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Tashmë, me afrimin e Samitit të Uashingtonit, klasa politike, shoqëria civile, por edhe publiku i gjerë, po ndërgjegjësohen se përgjegjësia e anëtarësimit nuk qëndron thjesht te reforma në forcat e armatosura, as vetëm te reforma e sektorëve tradicionalë të sigurisë, por te qëndrueshmëria e demokracisë shqiptare, funksionimi i ekonomisë së tregut, shtetit ligjor dhe ndihmesa e Shqipërisë në sigurinë rajonale. Me fjalë të tjera, përgjegjësia e plotësimit të kërkesave të anëtarësimit është e strukturave shtetërore, klasës politike, sipërmarrjes, shoqërisë civile dhe shtirë deri te publiku i gjerë. Kjo gjë u theksua në dy aktivitete madhore që u zhvilluan në Tiranë për integrimin e Shqipërisë në NATO, në konferencën e organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë, “Drejt anëtarësimit në NATO, 2008: Përgjegjësitë dhe detyrimet” dhe në konferencën e organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, “Aleanca Civile 08: Së bashku drejt NATO-s”.

Drejt anëtarësimit në NATO, 2008: Përgjegjësitë dhe detyrimet

Me nismën e Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, Kuvendi i Shqipërisë, nën drejtimin e zonjës Jozefina Topalli organizoi më 3 Mars 2008 Konferencën Kombëtare me titull “Drejt anëtarësimit në NATO, 2008: Përgjegjësitë dhe detyrimet”, me pjesëmarrjen e autoriteteve

kryesore në vend, drejtues të lartë politikë të pozitës dhe opozitës dhe të shoqërisë civile, si dhe ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si vend kontakt i NATO-s për Shqipërinë. Në konferencë përshëndeti edhe Xhon Kolston, Ndihmësekretari i Përgjithshëm i NATO-s. Objektivat e kësaj veprimtarie mjaft të rëndësishme kërkonin të arrinin në një vlerësim të situatës aktuale dhe t'u kërkonte institucioneve përgjegjëse për Planin e Veprimit për Anëtarësim dhe aktorëve jo publikë të arrinin në një bashkëpunim më të gjerë dhe më të ngushtë për të marrë ftesën për anëtarësim në Samitin e NATO-s, në 2008-n. Kjo konferencë synonte të shprehte vendosmërinë e Kuvendit të Shqipërisë për të mbështetur qeverinë për të plotësuar të gjitha përgjegjësitë dhe detyrimet që Shqipëria të integrohet plotësisht në NATO, të integrojë më mirë shoqërinë civile, dhe të zgjerojë bashkëpunimin me parlamentet e vendeve anëtare të NATO-s për të marrë mbështetjen e tyre.

Duke vlerësuar cilësinë e kontributeve, në mënyrë të veçantë prirjen për aktive ndërpartiake të përfaqësuesve të Kuvendit të Shqipërisë, “Çështje të Sigurisë” paraqet një përmbledhje të ideve kryesore të kësaj konference siç u paraqitën nga çdo autoritet. Fjalët e plota të pjesëmarrësve ndodhen të botuara në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë: www.parlament.al.

Kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli theksoi se integrimi në NATO është një shans i madh për Shqipërinë, sepse kjo organizatë është unike në disa drejtime: është një forum ku mbliidhen së bashku amerikano-veriorët dhe evropianët, është një bashkësi popujsh që vlerësojnë vlerat e pluralizmit, lirisë, demokracisë dhe tolerancës, si edhe është një bashkësi sigurie. Ajo u shpreh se përveç reformës në ushtri, Kuvendi i Shqipërisë do të mbështesë çdo reformë tjetër që ka të bëjë me integrimin Evro-Atlantik dhe fuqizimin “soft security”, që është produkt i stabilitetit ekonomik, stabilitetit social, konkurrencës dhe tregjeve të hapura”.

Kryeministri Sali Berisha në fjalën e tij tha se “zgjedhjet e 18 shkurtit e sjellin Shqipërinë më pranë NATO-s dhe komunitetit të vendeve evro-atlantike, me të cilat ndajmë vlerat

e përbashkëta të lirisë, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Ne mbetemi të vendosur për të ndërmarrë të gjitha reformat për përsosjen e mëtejshme të procesit zgjedhor në Shqipëri”. Në lidhje me afrimin e vendit më pranë NATO-s, ai u shpreh: “Mesazhi inkurajues i Rigës ishte pa dyshim një lajm shumë i mirë për Shqipërinë, ndaj dhe përfitoj nga rasti të falënderoj Aleancën e Atlantikut të Veriut, SHBA-në dhe vendet e tjera të kësaj Aleance, për përkrahjen dhe ndihmën e vazhdueshme ndaj Shqipërisë. Por, nga ana tjetër, përmes deklaratës përfundimtare, krerët e shteteve dhe të qeverive të vendeve anëtare bënë të qartë qëndrimin e Aleancës, se thellimi dhe konsolidimi i reformave, në veçanti, për sa i përket luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, konsolidimit të shtetit ligjor dhe i reformave në fushën e mbrojtjes, mbeten e vetmja rrugë për marrjen e ftesës në samitin e parë gjerues të NATO-s”. Kryeministri deklaroi se përparësia e qeverisë është dhe mbetet konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe reformat e domosdoshme në sistemin e drejtësisë, në sistemin zgjedhor, si dhe lufta kundër krimit e korrupsionit. Për të arritur suksese në këto fusha kërkohet një konsensus i gjerë i të gjitha forcave politike dhe të mbarë shoqërisë shqiptare dhe qeveria e mazhoranca janë të gatshëm të bashkëpunojnë me të gjitha forcat politike që janë të interesuara për të ardhmen evropatlantike të Shqipërisë. Më pas kryeministri u zotua se Shqipëria do të rrisë kontributet e saj ndërkombëtare në fushën e sigurisë, si në misionin ISAF të drejtuar nga NATO-ja në Afganistan, kontributi i Ekipit të Përbashkët Mjekësor në ISAF, në kuadër të A-3, kontributi në misionet “Liria e Irakut”, ALTHEA të BE-së në Bosnjë, si dhe me vëzhgues në UNOMIG, në Gjeorgji, në operacionin “Active Endeavour” në Mesdhe, në kuadër të A-3 dhe të SEDM-it, do të ndërmerren projekte, stërvitje dhe operacione të përbashkëta dhe qeveria po planifikon masat për ngritjen në Tiranë në vitin 2007 të Kolegjit Rajonal të Mbrojtjes.

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara, Marsie B. Ries, në fjalën e saj përmendi se “Shqipëria luan një rol të përgjegjshëm, moderues në rajonin ku ndodhet. Dhe e ka demonstruar gatishmërinë e saj për punuar në mënyrë bashkëpunuese me

fqinjët e saj nëpërmjet diplomacisë aktive, pjesëmarrjes dhe udhëheqësinë në Kartën e Adriatikut, Ministerialin e Mbrojtjes së Evropës Juglindore, si edhe nisma të tjera rajonale”. Dihet se integrimi në NATO ka mbështetje të gjerë popullore në Shqipëri, por kjo nuk mjafton, tha ajo, sepse duhet plotësuar Plani i Veprimit për Anëtarësi, i cili përveç përbërësve ushtarakë ka edhe kushtet e forcimit të institucioneve demokratike dhe atyre të sundimit të ligjit. Këto reforma, së bashku me ato të anëtarësimit në BE janë të vlefshme për shoqërinë dhe brezat e tanishëm dhe ato të ardhshëm. Reforma si mirëqeverisja, pakësimi i korrupsionit, ballafaqimi me krimin e organizuar dhe forcimi i sistemit të drejtësisë, janë në të mirën e të gjithë qytetarëve në një demokraci dhe sukcesi i tyre kërkon përpjekje kombëtare, mbipartiake, të qeverisë dhe parlamentit, por edhe të shoqërisë civile dhe qytetarëve të zakonshëm.

Ndihmëssekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Xhon Kolston, tha se vendet aspiruese të NATO-s do të jenë nën një vëzhgim të kujdesshëm nga organizata dhe se Plani i Veprimit për Anëtarësim mbetet dokumenti udhërrëfyes për reformat. Edhe ai theksoi karakterin gjithëpërfshirës të reformave për hyrjen në NATO: “Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura janë në rrugën e duhur. Por në NATO nuk do të hyjë Ministria e Mbrojtjes, por i gjithë vendi, me të gjitha institucionet e tij. Aleatët e NATO-s sot nuk qëndrojnë të lidhur në bashkësi nga strukturat apo burokracitë, as nga një kërcënim i vetëm i përbashkët. Ajo çka i mban Aleatët së bashku, në radhë të parë, janë vlerat e përbashkëta të lirisë, demokracisë dhe sundimi i ligjit, vlera që ata i përkrahin dhe mbrojnë. Aleatët presin që edhe vendet aspiruese t’i përqafojnë këto parime”. Zgjedhjet e fundit parlamentare në Shqipëri ai i konsideroi një shans i humbur për dialogun pozitiv-opozitiv për të bërë dhe mbështetur reformat zgjedhore për të arritur standardet ndërkombëtare.

Zv/kryetari i Kuvendit, Ylli Bufi tha se përgjegjësia e klasës politike nuk identifikohet me numrin e ligjeve apo vendimeve qeveritare, por me shkallën e zbatimit të tyre dhe pengesë në këtë drejtim ka qenë fryma partiake, mungesa e kapaciteteve administruese, interesat e ngushta dhe korrupsioni. Sipas tij,

“konsensusi nuk duhet kërkohet vetëm në momentin e votimit si akt që rrjedh nga aritmetika e votave, por si një proces bashkëpunimi reciprok në hartimin dhe zbatimin e reformave. Komisionet parlamentare janë vendi i përshtatshëm për këtë bashkëpunim. Kuvendi i ka të gjitha mundësitë që në mënyrë institucionale dhe transparente të arrijë në marrëveshje dhe zgjidhje konsensuale, gjithmonë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet”.

Ministri i Punëve të Jashtme, Besnik Mustafaj në fjalën e tij në konferencë tha: “Është e domosdoshme hartimi i një platforme kombëtare për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Puna për hartimin e kësaj platforme ka filluar dhe synon së pari përsosjen e strukturave të angazhuara direkt në procesin Ministrinë e Punëve të Jashtme, në Misionin tonë pranë NATO-s, në Ambasadën tonë në Uashington, në ministrinë që marrin pjesë direkt në procesin e MAP-it, etj. Po punohet për krijimin e një mekanizmi që do të ndërtojë aktivitetin në drejtim të marrëdhënive me publikun dhe është në përfundim e sipër strategjia për ndërtimin e këtyre marrëdhënive”.

Ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu, foli për mbështetjen që Kuvendi dhe qeveria i kanë dhënë reformës në Forcat e Armatosura, si në rritjen e rolit mbikëqyrës të Kuvendit, në veçanti nga Komisioni i Sigurisë Kombëtare apo ashtu edhe miratimi i vendimeve të qeverisë për eliminimin e strukturave, njësisive e pajisjeve të tepërta e të vjetruara, transformimin e Forcave të Armatosura në një forcë profesioniste, rritjen e kontributit tonë në operacionet paqeruajtëse jashtë vendit, rritjen e buxhetit të mbrojtjes në 2% të GDP brenda vitit 2008, pra dy vjet para objektivit të përcaktuar në Strategjinë tonë Ushtarake. Për bashkëpunimin rajonal ai tha: “Shqipëria e sheh bashkëpunimin rajonal si komponent thelbësor në përpjekjen e saj për integrim. Dy iniciativa të rëndësishme që kanë arritur progres të dukshëm, janë SEDM-i dhe Karta e Adriatikut (A3)”.

Deputeti Kastriot Islami theksoi disa drejtime, ku, sipas tij, duhet përqendruar vëmendja e politikës dhe e shoqërisë shqiptare: (1) në aspektin politik, për rritjen e përgjegjshmërisë

së klasës politike dhe arritjen e objektivave që lidhen me konkretisht me vazhdimin e demokratizimit të vendit, sundimin e shtetit ligjor dhe forcimin e vazhdueshëm të institucioneve, garantimin e mirëqeverisjes së vendit e shoqëruar me një luftë institucionale e të standardeve ndërkombëtare kundër korrupsionit, krimit të organizuar e trafikëve me rezultate konkrete e të prekshme, respektim dhe ruajtje e të drejtave të njeriut, e të tjera, detyrime që përgjithësisht rrjedhin edhe nga angazhimet në procesin e integritimit në BE; (2) në aspektin e ndërtimit të një procesi gjithëpërfshirës politik ku të gjithë aktorët politikë bashkëpunojnë në mënyrë koherente; (3) në aspektin e konsultimit me publikun e pjesëmarrjen e shoqërisë civile në mënyrë që të rritet maksimalisht vizibiliteti i këtij procesi dhe njëkohësisht perceptimi pozitiv në funksion të ndërtimit të një imazhi pozitiv; (4) në aspektin e ndërtimit të një lobingu funksional që garanton konsensusin për mbështetje maksimale nga të gjithë vendet anëtare të NATO-s.

I ftuar nga shoqëria civile në këtë aktivitet ishte drejtori i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Sotiraq Hroni, i cili theksoi: “Edhe aktorë të shoqërisë civile në vend, për të qenë më të efektshëm, kanë dhe po institucionalizojnë praktika të veprimit të përbashkët në koalicione të ndryshme si mund të përmenden koalicionet për zgjedhje të lira, koalicioni antikorrupsion, koalicione për të drejtat e njeriut, forma të tjera më afatshkurtra të veprimit të përbashkët për elementë të veçantë të reformave dhe institucioneve në vend. Është kjo prirje e organizatave të shoqërisë civile dhe e ekspertëve të pavarur që shumë lehtë mund të integrohet në një zë të vetëm për të mbështetur dhe nxitur politikën për të përmbushur gjithë detyrimet dhe realizuar gjithë përgjegjësitë edhe në kuadër të pritshmërisë së ndërkombëtarëve për integrimin Evro-Atlantik të vendit”. Ai paraqiti edhe idenë e Aleancës Civile 08, një grupim i OFQ-ve nga Shqipëria, Maqedonia dhe Kroacia, si komponent i shoqërisë civile të Kartës së Adriatikut.

Aleanca Civile 08: Së bashku drejt NATO-s

Kontributi i shoqërisë civile në integrimin e Shqipërisë në NATO dhe thellimi i bashkëpunimit rajonal ishte tematika e konferencës kombëtare “Aleanca Civile 08: Së bashku drejt NATO-s” e organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) më 20.04.2007. Në të merrnin pjesë përfaqësues të organizatave joqeveritare, parlamentare, anëtarë të qeverisë, politikanë, diplomatë të vendeve të NATO-s, akademikë, opinionbërës e analistë të mediave, etj. Në seancën e hapjes përshëndetën kryetarët e dy grupeve parlamentare të PD-së dhe PS-së, përkatësisht Bamir Topi dhe Ben Blushi, ministri i Punëve të Jashtme, Besnik Mustafaj, ambasadorja e SHBA-së dhe pika dhe kontakti i NATO-s për Shqipërinë, Marcie B. Ries, zv/ministri i Mbrojtjes Petrit Karabina, dy përfaqësuesit e organizatave partnere të IDN-së, përkatësisht Saso Ordanovski nga FORUM, Qendra për Kërkime Strategjike dhe Dokumentim në Shkup dhe Damir Demonja nga Instituti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Zagreb, si edhe komandanti i përfaqësisë ushtarake të NATO-s në Shqipëri Brig. Gen. Anastasios Rintis. Konferenca tërhoqi interesimin e madh të publikut dhe të mediave.

Kjo konferencë shërbeu si lancim publik i Aleancës Civile 08, një koalicion i organizatave joqeveritare nga Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia, si dimension i shoqërisë civile i Kartës së Adriatikut (A3). Organizatat themeluese të Aleancës Civile 08 janë Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim nga Tirana, FORUM, Qendra për Kërkime Strategjike dhe Dokumentim në Shkup dhe Instituti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Zagreb. Qëllimi i Aleancës Civile 08 është hapja e procesit të integritimit në NATO ndaj shoqërive dhe rajonit dhe stimulimi i sektorit jofitimprurës në vendet e A3 që të marrin përsipër përgjegjësi dhe të jenë partnerë aktivë të qeverive në integrimin evro-atlantik. Aleanca Civile 08 do të mobilizojë qeveritë, shoqëritë civile dhe opinionin publik në vendet e A3 që deri në Samitin e Uashingtonit në vitin 2008, këto vende të kenë realizuar reformat për anëtarësim në NATO. Secila organizatë e Aleancës Civile 08 do të bashkërendojë në nivelin kombëtar

“Kwadrin për Veprim 2007-2008” për organizatat joqeveritare që të promovojnë përkushtimin e tyre afatgjatë për monitorimin dhe avancimin e standardeve parësore për integrimin evropian të vendeve tona – forcimin e vlerave demokratike, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, transformimin demokratik të sektorit të sigurisë dhe thellimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë e të bashkëpunimit rajonal. Përveç kësaj, Aleanca Civile 08 do të ofrojë një forum për nisma të përbashkëta lobuese në Bruksel dhe Uashington për anëtarësimin e Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë në Samitin e vitit 2008.

Një veçori tjetër e kësaj konference ishte mbështetja që dha për realizimin e saj sipërmarrja private: kompanitë Elka, Birra Tirana, kompania farmaceutike Almegipharma e Grupit Pipero, Qendra Mjekësore e Aleancës Civile dhe Hotel Tirana. Kjo tregon se po përhapet vetëdijësimi që përgjegjësia e integritetit të vendit në NATO nuk është vetëm e qeverisë apo e strukturave të mbrojtjes, por e gjithë shoqërisë, përfshirë edhe sipërmarrjen private.

Në fjalën e tij të hapjes së konferencës, z. Sotiraq Hroni, drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, theksoi se Aleanca Civile 08, është e institucionalizuar si një dimension civil i Kartës së Adriatikut. Si perspektivë në një plan me afatgjatë Aleanca Civile 08 do të përcjellë frymën e saj të bashkëpunimit në aktivitete rajonale ku do të përfshihen edhe vende të reja të partneritetit për paqe: Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, pse jo edhe Kosova e autoritetet ndërkombëtare aty.

Tematikat e dy seancave të tjera u përqendruan në dialogun politik, stabilitetin e proceseve zgjedhore, si edhe në rolin e shoqërisë civile në mbështetjen/avokimin e shtetit ligjor dhe luftës kundër korrupsionit. Ndër folësit kryesorë në këto seanca ishin Preç Zogaj, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Politikën e Jashtme, Prof. Dr. Artan Fuga, Universiteti i Tiranës, deputeti Blendi Klosi dhe Gjergj Buxhuku i Konfindustrisë, etj.

Në fund të konferencës u diskutua dhe miratua “Kwadri për Veprim” i shoqërisë civile në Shqipëri (shih më poshtë).

Konferenca e Tiranës u ndoq nga dy konferenca të ngjashme në Maqedoni dhe Kroaci, përkatësisht në Shkup më 23.04.2007 dhe në Zagreb më 07.05.2007. Edhe në këto veprimtari, aktorë politikë dhe të shoqërisë civile diskutuan mbi reformat kombëtare në kuadër të përgatitjeve për të qenë shumë shpejt anëtarë me të drejta të plota të NATO-s. Secila konferencë miratoi kuadrin për veprim të shoqërisë civile në vendin përkatës. Komponenti që u theksua vazhdimisht në to ishte edhe ai i bashkëpunimit rajonal mes vendeve të A3 dhe më gjerë. Shoqëria civile e Shqipërisë u përfaqësua në Shkup dhe Zagreb nga Sotiraq Hroni, drejtor ekzekutiv i IDN-së dhe bashkëthemelues i nismës së Aleancës Civile 08.

Drafti i Kuadrit për Veprim Civil: 2007-2008

Me shpresën e përmbushjes së aspiratës historike për t'u integruar në NATO në samitin e ardhshëm në Uashington, me mbështetjen e plotë ndaj reformave strukturore të forcave tona të armatosura, organeve të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të tjera, me besimin se shoqëria civile ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në procesin e integritit, ne si organizata të shoqërisë civile në Shqipëri, zotohemi të bashkojmë përpjekjet tona për të punuar së bashku në këto drejtime:

- Nxitja dhe mbështetja e një dialogu civil dhe të frytshëm midis qeverisë dhe opozitës për përmbushjen e reformave me interes vital për vendin dhe objektivin e integritit në NATO;
- Bashkëpunimi i ngushtë me partitë politike për arritjen e mirëkuptimit për reformën elektorale;
- Monitorimi i zbatimit të reformave për fuqizimin e shtetit ligjor dhe thellimin e zbatimit të parimeve demokratike në vend;
- Ndërmarrja e nismave dhe e partneriteteve me agjencitë qeveritare për luftën kundër korrupsionit në sektorin publik;

- Mbështetja dhe pjesëmarrja në programe për ristrukturimin e sektorit të sigurisë, mbikëqyrjes civile dhe kontrollit demokratik të forcave të armatosura;
- Ndërmarrja e fushatave të vetëdijesimit publik mbi detyrat dhe përgjegjësitë e integritit të vendit në NATO;
- Mbështetja dhe pjesëmarrja në bashkëpunimin rajonal dhe nisma të rritjes së mirëbesimit ndërkufitar;
- Pjesëmarrja në lobime në rrafshin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar në Bruksel dhe Uashington për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, së bashku me Kroacinë dhe Maqedoninë.

Intervistë me Tom Ridge

FUNKSIONIMI I SISTEMIT DEMOKRATIK, SUNDIMI I LIGJIT DHE EKONOMIA E TREGUT JANË SFIDA TË VAZHDUESHME PËR DEMOKRACITË

**(Intervistë me Tom Ridge,
ekskluzivisht për Çështje të Sigurisë)**

Këshilltari i Kryeministrit Berisha dhe Ish-Sekretari i Sigurisë i Presidentit Bush, z. Tom Ridge ka lindur në Pitsburg, Pensilvani, më 1945 në një familje të klasës punëtore. Më 1967 u diplomua për jurist në Universitetin e Harvardit me diplomë nderi. Pa e mbaruar shkollën ai u thirr nën armë dhe shërbeu në Vietnam ku fitoi disa medalje. Pas diplomimit, punoi si jurist privat dhe si prokuror i Kontesë Eire. Më 1982 u zgjodh në Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan dhe u rizgjodh nga votuesit e Pensilvanisë pesë herë si përfaqësues i tyre, pa humbur asnjë herë. Në vitet 1995–2001 ai u zgjodh dy herë guvernator i Pensilvanisë, duke drejtuar një zhvillim të vrullshëm teknologjik, arsimor, ekologjik dhe shëndetësor të atij shteti. Pas ngjarjeve tragjike të 11 Shtatorit 2001, Presidenti Bush i kërkoi Guvernatorit Ridge të vinte në Uashington për të zhvilluar dhe bashkërenduar një strategji kombëtare gjithëpërfshirëse për të fuqizuar mbrojtjen kundër kërcënimeve terroriste ndaj SHBA-së. Më 8 tetor 2001 Tom Ridge u emërua Ndihmësi i parë për Sigurinë e Atdheut pranë Presidentit Bush. Nga viti 2003 deri në vitin 2005 ai ishte i pari Sekretar i Departamentit për Sigurinë e Atdheut. Pas më se 25 vjetësh shërbimi publik, tani Tom Ridge këshillon për një sërë çështjesh, përfshirë sigurinë, marrëdhëniet ndërkombëtare, zhvillimin ekonomik, ndërtimin e institucioneve civile, teknologjinë, arsimin, etj. Ai angazhohet me aktivitetet jofitimprurës pranë një sërë organizatash. Gjatë karrierës së tij në sektorin publik dhe atë privat, ai është nderuar me shumë dekorata

e tituj. Së bashku me bashkëshorten Michele dhe dy fëmijët Lesley dhe Tommy, banon në Uashington.

Sekretari Tom Ridge u tregua i gatshëm t'i përgjigjej disa pyetjeve që Çështje të Sigurisë i drejtoi në lidhje me zhvillimet e fundit në fushën e sigurisë në Shqipëri, integrimin në NATO dhe bashkëpunimin rajonal. Më poshtë është intervista e tij ekskluzive për revistën tonë.

Për opinionin e Sekretarit Tom Ridge cilat janë sfidat e sigurisë me të cilat përballlet Shqipëria?

Sikurse me shumë kombe të tjerë, veçanërisht demokracitë e reja, çështjet sfiduese të sigurisë përqendrohen në menaxhimin e kufijve dhe veprimtaritë kriminale, si tregtia e drogës, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimi i organizuar. Gjatë një periudhe kohore, zbatimi i ligjit ka qenë i dobët dhe në nivel të ulët, ndërsa sistemi i drejtësisë ka vuajtur nga korrupsioni endemik. Për shumë vite Shqipëria ka qenë një vend transit si edhe strehim për kriminelët, korrupsionin dhe veprimtaritë joligjore të lidhura me to.

Megjithatë në dy vitet e fundit krimi i organizuar ka marrë një goditje të fuqishme, sepse grupet kryesore kriminale janë nxjerrë para drejtësisë dhe lidhjet midis krimit dhe politikës janë këputur. Kjo ka sjellë stabilitet të shumënevojitur në rajon.

Gjithashtu është përmirësuar kultura e bashkëpunimit brenda agjencive të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve informative, si edhe midis agjencive partnere, që i ka bërë këto të veprojnë në mënyrë më efikase kundër elementëve kriminalë të Shqipërisë brenda dhe jashtë vendit. Për më tepër, transparenca më e madhe dhe reformat e tjera po shfaqin një ndikim në uljen e korrupsionit dhe shumë përpjekje të tjera po ndërmerren në këtë drejtim.

Siguria e kufijve është kthyer në një sfidë kritike për të gjitha kombet, përfshirë edhe kombin tim. Në Shqipëri, masat e ndërmarra së fundmi të kontrollit të kufijve kanë rritur sigurinë për njerëzit dhe mallrat që përshkojnë kufijtë e shtetit. Me fuqizimin e këtyre masave autoritetet do të jenë në gjendje të identifikojnë më mirë ata që tentojnë të hyjnë në vend për

qëllime kriminale.

Përveç kësaj, reformat qeveritare që synojnë sistemet e regjistrimit dhe identifikimit të qytetarëve do të thellojnë institucionet e demokracisë dhe, ç'është më e rëndësishme, do të krijojnë një mjedis ku qytetarët e Shqipërisë mund të marrin pjesë në zgjedhje të ndershme. Kështu, ndërsa Shqipëria përballet me këto sfida, përparim domethënës po bëhet për t'i adresuar ato, gjë që dëshmon për një Shqipëri më të sigurt që ecën përpara.

Për mendimin e Sekretarit Ridge, cili është mesazhi i Samitit të Rigës për vendet e Kartës së Adriatikut? A mund të kthehet Samiti i Uashingtonit i vitit 2008 në një histori suksesi për secilin prej këtyre vendeve për të marrë ftesën e anëtarësimit në NATO?

Mesazhi i Samitit të Rigës mbi Kartën e Adriatikut është një mesazh shprese. Një bashkësi globale patjetër që fuqizohet prej këtyre vendeve që dëshirojnë të përmirësojnë jetët e qytetarëve të tyre. Ka shpresë (optimizëm) midis Aleancës dhe, si rrjedhojë, një dëshirë për të ndihmuar qytetarët dhe qeveritë e Shqipërisë, Kroacisë dhe Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë për të përmbushur përgjegjësitë e anëtarësisë së NATO-s.

Aleanca kërkon vende që përmbushin standardet uniforme, por edhe që janë në gjendje të kontribuojnë konstruktivisht në sigurinë dhe stabilitetin evro-atlantik. Mendoj se ka arsye për shpresë në lidhje me Samitin e 2008-ës. Tashmë ne kemi parë suksese që ia vlen të përmenden. Paqeruajtja ndërkombëtare, bashkëpunimi me shtete të tjerë në një klimë të vështirë të sigurisë dhe përpjekje për të avancuar bashkëpunimin rajonal kanë qenë të mirëpritura dhe janë në fakt të nevojshme për luftën e sotme ndërkombëtare kundër terrorizmit.

Zhvillimi parimor dhe i përmirësuar i Zgjedhjeve Parlamentare të 2005-ës ka fituar një vëmendje të favorshme – sikurse edhe masat për të përqaftuar dhe mbrojtur zbatimin e ligjit dhe luftuar krimin e organizuar. Edhe Kroacia ka lënë përshtypje të mirë, me bashkëpunimin e saj me Gjykatën

Ndërkombëtare për Krimet në ish-Jugosllavi dhe me sukseset për avancimin e reformave në politikë, ekonomi, zbatimin e ligjit dhe mbrojtje. Ndërsa për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, edhe ajo në vitin 2006 zhvilloi zgjedhje parlamentare të përmirësuara. Janë premtuese përkushtimi dhe përpjekjet e saj për të rrenjosur më tutje reformat ekonomike, politike, të mbrojtjes dhe juridike.

Në vendet e Kartës së Adriatikut (A3) po ndodh një progres domethënës në shumë fronte për të lehtësuar hyrjen në NATO, në mënyrë që këto vende më së fundi të jenë anëtarë të plotë, të respektuar dhe kontribues. Kam shpresë së Samiti i vitit 2008 do ta pranojë progresin e rëndësishëm që është bërë drejt plotësimin të kërkesave për anëtarësinë në NATO.

Në opinionin e Të Nderuarit Tom Ridge, cili është roli që mund të luajë shoqëria civile në reformimin dhe qeverisjen e sektorit të sigurisë? Si mund të arrihet bashkëpunimi sa më i mirë i institucioneve dhe autoriteteve të sigurisë me shoqërinë civile?

Nëpër të gjithë botën ne e kemi parë rolin e rëndësishëm dhe me ndikim të shoqërive civile në kontekstet e qeverive të veta. Qytetaria brenda çdo vendi dhe brenda bashkësisë ndërkombëtare ka përgjegjësitë e veta. Përparimet që janë bërë i detyrohen qytetarëve që kanë kërkuar dhe përkrahur siguri për familjet e tyre, drejtësi në sistemet ligjore dhe mundësi më të mëdha ekonomike në vendet përkatëse.

Ne e kemi mësuar këtë në Amerikë – sepse ne jemi vënë në lëvizje nga zërat e atyre që kanë mbrojtur përkrahur lëvizjet e të drejtës së votës dhe të drejta të barabarta për personat e çdo race, feje, gjinie dhe besimi. Pas 11 Shtatorit qytetarët me vend kërkuar përgjigje për shumë pyetje: Ç’po bën qeveria për të siguruar vendin? Kush e siguron vendin e punës? Kush i siguron fëmijët tanë në shkolla? Dhe, një pyetje të cilën ne i nxitëm qytetarët tanë ta ngrinin: si mund të ndihmoj?

Shoqëria civile e Shqipërisë ka potencialin për të luajtur një rol vital në avancimin e çështjeve prioritare të qeverisë, përfshirë edhe sigurinë. Ky rol mund të arrihet me anë të fuqizimit të dialogut dhe komunikimit midis qytetarëve dhe

qeverisë. Në kohën e tanishme OJF-të që veprojnë në sektorin e sigurisë janë të pakta, ndërsa ato që fokusohen në zbatimin e ligjit janë të kufizuara kryesisht në veprimtari për rritjen e vetëdijes së publikut.

E gjithë mund të ndryshojë dhe ka filluar të ndryshojë. Fuqizimi i sektorit të OJF-ve dhe llogaridhënia e transparencës më e madhe prej institucioneve qeveritare janë dy mënyra kryesore me anë të cilave po fillojmë të shohim një kulturë bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe qeverisë. Shqipëria ka filluar ta shohë këtë nivel shkëmbimi. Disa organizata të shoqërisë civile kanë qenë me ndikim në ushtrimin e trysnisë mbi qeverinë për të përmirësuar sundimin e ligjit dhe zbatimin e ligjit, si edhe për të promovuar politika dhe programe për përmirësimin e rendit shoqëror dhe ekonomik të vendit. Këta janë hapa pozitivë. Hapa të mëtejshëm duhen nxitur. Komunikimi i hapur midis njerëzve dhe qeverisë është një karakteristikë përkufizuese e shoqërive demokratike. Ai prodhon ide të reja, besim, përparim, ndryshim konstruktiv – dhe një klimë pozitive në të cilën të gjitha palët mund të debatojnë çështje të vështira dhe të prodhojnë marrëveshje, përfundime dhe përparim.

“Mbrojtja e sovranitetit të një shteti jo domosdoshmërisht përputhet me mbrojtjen e integritetit territorial të tij”. Cili është komenti i Sekretarit Ridge mbi këtë shprehje? Çfarë nënkupton kjo për sigurinë dhe bashkëpunimin në Evropën Juglindore?

Detyrimi parësor i një vendi për të mbrojtur sovranitetin, në gjykimin tim, duhet të përfshijë një përkushtim të qëndrueshëm për të mbrojtur integritetin e vet territorial. Çdo përpjekje kombëtare e hartuar për të siguruar qytetarët dhe mbrojtur rendin civil, ekonomik dhe shoqëror është e paplotë pa një menaxhim efektiv të kufirit, i cili legjitimon dhe mbron kalimin e ligjshëm të njerëzve, sendeve dhe shërbimeve.

Shumë prej sfidave me të cilat përballen demokracitë në formim dhe ekonomitë në zhvillim të Evropës Juglindore janë të ndërlikuara më tej nga faktorët historikë dhe realitetet e një bote globale e konkurruese.

Ndërsa çdo vend duhet dhe do të planifikojë rrugën e vet të arritjes së qëllimeve të tij politike, shoqërore dhe ekonomike, bashkëpunimi rajonal është në mënyrë absolute thelbësor për të përmbushur ato aspirata. Respekti i ndërsjellë për sovranitetin dhe integritetin e njëri-tjetrit është absolutisht i rëndësishëm për stabilitetin dhe suksesin e çdo grupimi rajonal të fqinjëve.

Veprimtaria ndërkufitare kriminale dhe imigrimi ilegal kanë një efekt të ngadalshëm gërryes mbi sovranitetin e një vendi dhe kjo është arsyeja pse bashkëpunimi i ndërsjellë është një integral i çdo nisme kombëtare në këtë drejtim. Zhvillimi bashkërisht i menaxhimit të kufirit dhe i sistemeve kombëtare të identifikimit do të ndihmojë në përparimin e shumë qëllimeve të përbashkëta të vendeve të veçanta në rajon, përfshirë integritimin, stabilitetin, sigurinë dhe mirëqenien ekonomike.

Cilat duhet të jenë këshillat apo parimet që shteti dhe shoqëria shqiptare duhet të ndjekin për të përmirësuar efikasitetin e sigurisë dhe zhvillimin e vendit?

Një luftë e vazhdueshme kundër krimit dhe korrupsionit, fuqizimi i mëtejshëm i institucioneve dhe një përkushtim për mirëqeverisjen janë qëllimet kryesore që Shqipëria duhet të përpiqet të arrijë. Zgjedhjet e hapura dhe të lira, stimuj më të mëdhenj ekonomik dhe një infrastrukturë e brendshme më e mirë do të rivitalizojnë Shqipërinë dhe jetët e qytetarëve të saj. Shoqëritë e lira dhe të sigurtat i bëjnë kushtet më të vështira për terroristët dhe veprimtaritë kriminale dhe kështu unë do të nxisja më shumë lëvizje në reformat, po shohim se po ndërmerren – si p.sh. masat për menaxhimin e kufijve dhe përpjekjet për të zbatuar një sistem kryesor identifikimi.

Sfidat e vendit janë ato që të bëjnë të mundur një demokraci funksionale, një sundim konsistent të ligjit dhe një ekonomi të lirë të tregut. Por këto janë sfida që çdo demokraci e di që janë të vazhdueshme. Janë sfida që duhet të monitorohen dhe mbajtur gjallë vazhdimisht dhe ndryshuar me të ndryshuar kohërat dhe rrethanat.

Unë kam besim se me mbrojtjen dhe çuarjen përpara të këtyre parimeve, përparimi dhe zhvillimi i Shqipërisë do të bëhet i qëndrueshëm. Dhe me përkushtim të vazhduar, ajo çfarë është një demokraci e re në Shqipëri, do të lulëzojë dhe rritet për të qenë një anëtare e suksesshme, me iniciativë dhe me kontribut të bashkësisë globale. Ata ndër ne që kanë një dashuri të fuqishme për popullin shqiptar do ta mirëprisnin këtë arritje.

Prof. Dr. Servet Pëllumbi

PARTITË POLITIKE DHE ÇËSHTJET E SIGURISË

Hyrje

Në dhjetëvjeçarin e fundit në fushën e politologjisë nisi të përpunohej në mënyrë intensive një vizion i ri lidhur me çështjet e sigurisë duke e vënë theksin, më tepër mbi sigurinë e njerëzve sesa të territoreve dhe të shteteve; më tepër mbi “zhvillimin njerëzor” për garantimin e sigurisë sesa mbi “shtimin e armatimit e përsosjen e tij”. Tashmë, kur kemi hyrë në Epokën e Globalizmit, po bëhet e gjithëpranuar, se mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të njeriut, e interesave dhe qëllimeve, e idealeve dhe e vlerave, e lirisë dhe e të drejtave të tij, është prioritare për të siguruar të ardhmen e njerëzimit.

Ky problem madhor vetëm kohët e fundit ka filluar të trajtohet edhe te ne, prandaj dhe shoqërohet ndjeshëm nga një prapambetje relative, si në konceptimin e tij, ashtu dhe në projektet dhe në veprimet praktike të subjekteve, tashmë të shumtë, në fushën e sigurisë. Megjithatë, duke vlerësuar gjerësinë e problemit, e quaj të rëndësishme që të kufizohem në vizionet e partive politike shqiptare lidhur me këtë aspekt të sigurisë.

Metoda

Duke marre si pikënisje nivelet teorike, tashmë të arritura për çështjet e sigurisë, përmes kalimit nga abstraktja te konkretja, nga e përgjithshmja (teoria e sigurisë) tek e veçanta (rasti i Shqipërisë) analiza do të përqendrohet te niveli i sotëm i sistemit politik pluralist, jo aq për të rreshtuar defekte e kufizime sempliste të çështjes së sigurisë, sesa për të nënvizuar nevojën e reformave dhe të ndërrimit të paradigmave. Në këtë

vështrim me interes më është dukur ideja e David Law, teoricieni i njohur i sigurisë, sipas të cilit partitë politike duhet të jenë “në rolin e gjeneratorëve të politikës së sigurisë”.¹ Në ç’masë janë të tilla forcat politike te ne mbetet për t’u vërtetuar në rrugë empirike pa lënë pas dore ballafaqimin me standardet e vendeve të BE-së, ku Shqipëria synon të integrohet.

Partitë politike dhe sfidat e sigurisë

Shpallja e pluralizmit politik në Shqipëri dhe krijimi i partive të para jo konformiste u prit me entuziazëm dhe shpresë për ardhjen e shpejtë të një shoqërie demokratike dhe të një cilësie më të mirë të jetës për të gjithë. Gjithsesi, paraqitja e kalimit nga ekonomia e komanduar dhe totalitarizmi në një shoqëri demokratike, të begatë dhe të sigurt, si lehtësisht i realizueshëm, doli jo i saktë.

Në të vërtetë edhe në përvojën tonë të deritanishme provohet se ka patur shumë më tepër vështirësi, probleme, zigzage e kohëzgjatje nga ç’përfytyrohej. Pluralizmi politik partiak që të jetë funksionues e produktiv, medoemos duhet të jetë faktor që ndihmon kohezionin e shoqërisë dhe realizimin e lirisë. Veçse ai s’mund të jetë i tillë vetvetiu dhe për më tepër që në fillimet e tij. Në një shoqëri tranzicioni (siç është rasti i Shqipërisë) vihet re mospërputhje serioze dhe me risqe të shumta. Shoqëria ka nevojë për një kohezion në diversitet që të mund të realizojë, pa shumë dhimbje, reforma të thella për të kaluar në një ekonomi tregu, ndërsa krijimi i partive të shumta përmban rrezikun e ndarjeve, të copëzimeve, pra edhe të destabilitetit. Vihet re që ndërsa numri i partive rritet me shpejtësi (zhvillim ekstensiv) duke u shndërruar në një lloj “mode”, pjesëmarrja e qytetarëve në procesin politik bie. Me sa duket ndikon jo pak fakti që opinionimi mbingarkohet me zhgënjime nga premtimet e pambajtura. Kështu, sipas të dhënave të anketës “Demokracia si angazhim” realizuar nga Instituti i Sociologjisë në fund të vitit 2006, 64.8 % e të anketuarve u shprehën se janë pak ose aspak të interesuar për

¹ Revista “Çështje të Sigurisë”, nr. 2, 2006

politikat partiake, prej të cilëve gati 70% e tyre të grupmohës 18-29 vjeç. Ndërsa vetëm 2.9% e të anketuarve (1.4% femra dhe 4.4% meshkuj) shprehen shumë të kënaqur nga demokracia pluraliste.

Shoqëria e bazuar mbi ekonominë e tregut dhe barazinë e shanseve, shoqërohet edhe me rritje të papërcaktueshmërisë, me pabarazi sociale, madje me kontraste e polarizime pasurore gjë që çon në krijimin e grupeve të marginalizuara, të cilat s'kanë mundësi reale për të ushtruar trysni dhe as për të nxjerrë liderë të vet për të afirmuar vetveten dhe për të përfituar nga hapësirat që krijon demokracia pluraliste. Në këtë rrafsh shoqëria jonë vazhdon të ketë probleme serioze për liritë dhe të drejtat e njeriut. Politikat ekonomiko-financiare thellojnë hendekun midis të pasurve dhe të varfërve. Aksesit ndaj shërbimit shëndetësor, arsimit dhe burimeve të tjera të domosdoshme për një zhvillim e një jetë normale është i tillë që sjell pabarazi dhe nxit qëndrime ekstremiste. Trysnia e administratës për shkarkime nga puna sipas kritereve partiake sjell një “edicion të ri” të frikës dhe të pasigurisë. Thënë ndryshe, vend për iluzione nuk ka, sepse demokracia është e duhet vlerësuar si “shoqëri e risqeve”, por që në vetvete përmban edhe “antidodën” e sigurisë në normalitetin dhe funksionimin e mirë të saj.

Do të kishte kuptim për një paraqitje më të mirë të një problematike të tillë që të futej në qarkullimin politik e shkencor koncepti i “sigurisë politike” duke përfshirë në të:

- kushtet politike në të cilat jeton apo është i detyruar të jetojë komuniteti i dhënë;
- projektet politike, aspiratat dhe mundësitë e realizimit të tyre;
- gjendjen e palëve në një proces politik, në rastin e dhënë të partive politike, sa janë ato bashkëpunuese për stabilitetin politik dhe sigurinë e qytetarëve;
- aftësinë për të rregulluar sferën e veprimit të forcave spontane e destabilizuese për të mos i lënë gjërat në vetërrjedhje;
- balancimin politik të interesave të grupeve të ndryshme që janë të interesuar për shtet ligjor, stabilitet politik dhe luftë kundër dukurive negative që frenojnë zhvillimin normal

të demokracisë (krimit të organizuar, korrupsionit, trafiqeve, etj.).

Për analogji me vlerë do të ishte edhe “familjarizimi” me konceptin “siguri ekologjike” duke përfshirë në të një kompleks gjendjesh, dukurish e veprimesh që synojnë një ribalancim ekologjik nga veprimet rrënuese e spontane të 15 viteve të tranzicionit (që fatkeqësisht po vazhdojnë) për të arritur një nivel të kënaqshëm sigurie dhe “mirëqenieje ekologjike” për popullsinë. Veçse, është për të ardhur keq që forcat politike në Shqipëri, që e trajtojnë pluralizmin politik kryesisht si “hapësirë lufte” për pushtet, deri tani nuk kanë arritur që t’i njohin vetes ndonjë detyrim për të vlerësuar sfidat e sigurisë që vijnë nga brenda sistemit apo dhe nga mjedisi. Kjo çon në një tip politik, pasojat e së cilës, janë të paparashikueshme.

Po e konkretizoj me qëndrimin që mbahet ndaj konfliktualitetit midis forcave politike, të djathta dhe të majta. Nuk jam i prirur që të përfytyroj një shoqëri demokratike, bile edhe në trajtën e saj të zhvilluar, pa konflikte dhe pa politeknologjinë e zgjidhjes së tyre. Veçse, na duhet të pranojmë se si rregull partitë politike dhe liderët e tyre “mbijetojnë” në politikë në bazë të konfliktualitetit të lënë në vetërrjedhje dhe që gjeneron kriza, destabilitet, pra siguri të cinguar.

Duke abstraguar nga situatat e krijuara të viteve 1996, 1997, 1998 apo 2006, po i referohem rastit të zgjedhjeve vendore të 18 shkurtit 2007. Të dy krahët e politikës, e djathta dhe e majta, duke i parë zgjedhjet si “arenë lufte”, për të fituar legjitimitet e kapital politik, sipas raportit të ODHIR-it, morën një “shans tjetër të humbur”, si për MSA-në, ashtu dhe për ftesën në Samitin e Uashingtonit që do të mbahet në vitin 2008.

Më e keqja qëndron në një rivalitet të pakuptimtë në vlerësimin e rezultatit të zgjedhjeve. Kur “humbja e shansit të fundit” është humbje për të gjithë shqiptarët. Pa reflektuar për këtë, të djathtët sajojnë ngjyrosjen e hartës së Shqipërisë në ngjyrë blu për të deklaruar një “Blue Albania”, ndërsa të majtët edhe pse kësaj here disi më realiste, gjithsesi shkëputin “votën urbane” nga “vota rurale”. Mbi këtë bazë gjenden dhe “teoricienet” që zbulojnë në këtë rezultat deri dhe “përplasje

civilizimesh”(!!!). Për pasojë ndërsa zgjedhjet, si rregull, në një shoqëri demokratike sjellin stabilitet, më tepër siguri e optimizëm për njerëzit, te ne po ndodh e kundërta. Ende nuk po kuptohet se standardet e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të ndershme u përkasin të gjithëve dhe për to duhet të përgjigjen të gjitha “krahët” e politikës. E njëjta gjë mund të thuhet për institucionet, për funksionimin normal të të cilëve kërkohet një klimë bashkëpunimi që krijon dhe u hap rrugën shanseve për të mos i humbur ato. Kjo e bën dhe politikën produktive. Fatkeqësisht sot njerëzit ende ndiejnë pasiguri, sepse kriminaliteti është në rritje, shkelja e ligjeve, ndërtimet pa leje, aksidentet në rrugë po ashtu, mungesa e dritave, mungesa e reformave dhe papërgjegjshmëria për të patur një qeverisje më të mirë pas zgjedhjeve, quhen “gjëra të vogla” përballë “aritmetikës së votave” për të qëndruar në pushtet! Kjo u dëshmuo edhe në zgjedhjet në zonën 26 (Shijak) më 11 mars. Në këtë mënyrë me vetëdije ose jo, vetë partitë politike bëhen gjeneratorë të pasigurisë, duke sajuar lloj-lloj “përgjigjesh asimetrike” për problemet reale që kërkojnë zgjidhje adekuate.

Strategjia e sigurisë dhe partneriteti brenda sistemit politik partiak

Vendi ynë, që tashmë ka nënshkruar MSA-në dhe që shpreson të anëtarësohet më parë në NATO, ka një strategji të sigurisë (e lidhur ngushtë me strategjinë e BE-së) dhe që pret të përpunohet më tej e sidomos që të implementohet. Për mendimin tim, kjo përbën një nga fushat prioritare për të cilën nuk duhet vënë kurrësi në pikëpyetje vlera e bashkëpunimit, nga pozita partneriteti, i të gjitha forcave politike shqiptare. Çështje të tilla duhet t’i mbledhin së bashku jo vetëm liderë të politikës, por edhe specialistë, studiues, aktivistë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfaqësuesit më në zë të shoqërisë civile.

Në kuadrin e një aktiviteti shkencor të Institutit të Studimeve Politike e Shoqërore në vitin 1999 jam përpjekur të argumentoj natyrën e dyfishtë të partive politike, së pari, si hallka ndërmjetësuese midis shtetit dhe komunitetit për

formësimin e strukturave shtetërore mbi bazën e votës së lirë; së dyti, si bashkime vullnetare që kanë përherë nevojën e hapësirave të gjera të shoqërisë civile, pra për lidhje të ndërsjellta ndihme e bashkëpunimi² (shih “Politika dhe Shoqëria”, nr. 2, viti 2000 ose “Sprova në sociologjinë politike”, Dudaj, 2000). Me të dyja këto nivele, sipas David Law, “partitë politike duhet të jenë në rolin e gjeneratorëve të politikës së sigurisë”.³ Në një kuptim sa më të thjeshtë kjo do të thotë se partitë politike nga vetë natyra e tyre si pjesë thelbësore e politikës, por dhe si kërkuese e shoqërisë civile kanë mundësi të shumta për të krijuar kapacitete të reja sigurie. Prej tyre varen në një shkallë të madhe (për të mos thënë totale) zhvillimet e qëndrueshme në marrëdhëniet midis institucioneve, midis qytetarëve dhe shtetit, midis vetë partive politike brenda sistemit politik pluralist, dhe brenda shoqërisë civile. Jashtë një “traseje” të tillë s’do të kishte kuptim të kërkohej zgjidhje e problemeve të sigurisë (sidomos aspekti i saj si siguri e individit). Për arsytet e mësipërme partitë politike le t’i quajmë thjesht “aktore” të sigurisë. Veçse, duke iu referuar realiteteve konkrete mund të na imponohet që “aktorë” të tillë t’i shohim edhe si gjenerues kërcënimesh “të tipit klasik”, të krizave, përçarjeve e sherreve destabilizuese. Kjo përbën sfidën e sigurisë nga brenda sistemit politik. Si rrugëdalje nga një “kompleks i tillë” do të quaja partneritetin politik, mungesa e theksuar e të cilit përbën dobësinë themelore të sistemit tonë politik.

Çdo sistem politik në një shoqëri demokratike, është e duhet të jetë konkurrues. Veçse kjo konkurrencë mund të jetë një *garë* normale midis partive, në vartësi të pjekurisë së rendit kushtetues dhe të kulturës demokratike, ose një formë konfliktualiteti i skajshëm që rrjedh nga mungesa e tolerancës apo nga cektësia e kulturës demokratike. Ndërkaq kjo vështirë të quhet *garë* apo konkurrencë, sepse synon shkatërrimin e kundërshtarit politik, gjeneron pasiguri dhe mund të çojë vendin deri në nivelin e “luftës së të gjithëve kundër të gjithëve” të formuluar nga Tomas Hobs disa qindra vjet me parë!

² shih “Politika dhe Shoqëria”, nr. 2, viti 2000; ose Servet Pëllumbi “Sprova në sociologjinë politike”, Dudaj, 2000.

³ po aty

Kjo na imponon që të vëmë thekse të veçanta të partneritetit politik si forma më demokratike e konkurrencës, që buron nga nevoja e veprimit të partive politike si partnere të njëra-tjetrës brenda një sistemi. Partneriteti, si raport specifik, nisët nga nevojat e funksionimit normal të sistemit dhe garanton, më mirë se gjithçka tjetër, interesat reale e të motivuara të subjekteve të ndryshme të politikës, përfshirë dhe ato të komuniteteve dhe individëve të veçantë. Përvoja jonë na bind se kjo nuk është e lehtë. Ndërsa neglizhimi i zgjatur ka filluar të ketë një kosto relativisht të lartë për partitë në drejtim të kredibilitetit të tyre. Në sondazhin e organizuar nga Lëvizja “MJAFIT”, që përfshinte 3.000 vetë në 10 qytete të vendit (qershor 2006) besimi te partitë politike ishte në vendin e fundit ndër 18 subjektet e përfshira në anketim. Ndërsa në anketimin e Institutit të Sociologjisë (nëntor-dhjetor 2006) vetëm 12.9 për qind e të anketuarve shprehen se kanë interes për politikën dhe partitë. Të ndarë sipas grupmohave, më pak të interesuarit janë të rinjtë, të grupmohës 18-29 vjeç (vetëm 8.2 për qind). Kjo dëshmon se ndjenja e mosbesimit nga sistemi partiak po bëhet gjithnjë e më shqetësuese duke kaluar te komunitetet dhe te shoqëria civile. Kjo krijon shqetësime edhe në fushën e sigurisë.

Ndjenja e mosbesimit midis dy poleve të politikës, që më tepër ngjasojnë me “Fronte”, arriti para zgjedhjeve të 18 shkurtit (sidomos dhjetor-janar) nivele të tilla saqë vuri në pikëpyetje realizimin e zgjedhjeve edhe brenda afatit të dytë të dekretuar nga Presidenti i Republikës. Palët “në konflikt permanent” gjithnjë janë prirur si t’ia hedhin njëra-tjetrës edhe pse e dinë, tashmë, se kjo dëmton rëndë deri dhe rendin kushtetues dhe sigurinë e vendit. Kjo dukuri ka arritur një cak të tillë kur nuk mund të ecet më tej.

Nevojitet një reformim rrënjësor i sistemit politik. Sepse kur ai nuk jep rezultate vazhdon drejt qëllimeve të papërcaktuara. Funksionimi i sistemit, zhvillimi i vendit, stabiliteti dhe siguria e tij, integrimi me dinjtet në NATO dhe në BE kërkojnë për emërues të përbashkët bashkëpunimin ndërpartiak, fuqizimin dhe vënien në vendin që u takon institucioneve. Në raportet, partitë apo

institucionet, prioriteti, kurdoherë në një demokraci normale, u takon institucioneve.

Edukimi i qëndrueshmërisë

Siguria e njerëzve, respektimi i lirive dhe të drejtave të tyre, në thelb, përbëjnë qëllimin kryesor të politikës. Dhe, në këtë rrafsh do ta quaja të gabuar konceptin që këtë anë të politikës e trajton si atribut vetëm të forcave të majta dhe të filozofisë politike të socialdemokracisë. Në të vërtetë përmirësimi i vazhdueshëm i jetës dhe rritja e cilësisë së saj përbëjnë, në të njëjtën kohë, edhe sigurinë e jetës dhe kjo duhet të jetë prioritarë për çdo lloj qeverisjeje. Është e pafalshme që edhe pas 16 vjetësh ne ende na mungojnë strategji e programe afatgjata të nivelit kombëtar, obliguese për të gjithë, pavarësisht nga rotacioni i fuqisë.

Duke e marrë si pikënisje të domosdoshme një prioritet të tillë do të meritonin të nënvizoheshin posaçërisht të paktën dy nivele të problemit. Së pari, që të kuptohet jo vetëm nga partitë, nga politikanët, por dhe nga qytetarët se demokracia do të jetë vazhdimisht e mangët dhe e rrezikuar pa aspektin e saj human. Kjo ia imponon politikës në një shoqëri demokratike që të jetë qartësisht e orientuar tek individi, liritë dhe të drejtat e tij, që qeverisja të merret më përparësi me problemet e sigurisë së njerëzve që fillojnë me punën, banesën, shëndetin, arsimimin, me kërkesat për më shumë dritë, ujë, për mjedis të pastër e të sigurt, etj. Së dyti, që njerëzit, por edhe institucionet politike e shtetërore, të çlirohen nga reminishencat e një kuptimi të cekët të problemeve të sigurisë duke i reduktuar në aspektet ushtarake. Kjo do të thotë se “edukimi i qëndrueshmërisë” vazhdon të jetë thuajse jashtë vëmendjes, si të politikës, ashtu dhe të shoqërisë civile, që si qëllim të vetin ka bërjen sa më aktive e më pjesëmarrës të vetë qytetarëve - që nuk presin që çdo gjë “t’u bjerë nga qielli”. Kjo nuk e bën të tepërt që edhe vetë qytetarët me iniciativë duhet të organizohen në mbrojtje të sigurisë së tyre, të lirive dhe të drejtave të tyre. Kjo do të përbënte, sipas mendimit tim, përmbajtjen kryesore të konceptit “Edukimi i qëndrueshmërisë” që pret të zbatohet.

Aktorët e shumtë të sigurisë le ta fillojnë me sqarimin e më të thjeshtës: Pse marrëveshja e shkruar me BE-në quhet “Marrëveshje e Stabilizim-Asociimit”? Stabiliteti është një vlerë e madhe që nënkupton më shumë demokraci, një qeverisje më të mirë, funksionim sipas parimit “kontroll-balancim” të institucioneve, respektim konkret e jo me fjalë të lirive dhe të drejtave të njeriut, siguri të jetës, pasurisë, pronës, shëndetit, shkollimit, mjedisit ekologjikisht të pastër, etj.

Pra, sfida para se cilës gjendet sot “edukimi i qëndrueshmërisë” qëndron në “ndryshimin progresiv” të status-kuosë, kur të gjithë flasin për reforma e reformat ngecin. Siguria e njerëzve duhet të shihet në dinamikë, në proporcion të drejtë me kufizimin e faktorëve kërcënues deri në atë shkallë sa njerëzit ta ndiejnë veten të sigurt nga veprimi i çdo faktori kërcënues për jetën, pasurinë, bizneset dhe mirëqenien e tyre, duke filluar me nivelin ende të lartë të varfërisë, me papunësinë kronike dhe deri te korrupsioni, trafiket e krimi i organizuar. Tashmë është e qartë për këdo se me “barkun bosh e me bukë me listë” për shtresa të tëra, s’ka demokraci e stabilitet të sigurt. Por, pasiguri ndien edhe biznesi vendas i të gjitha niveleve përballë terrorit administrativ e gjobvënies dhe mungesës së një perspektive të qartë në zhvillimin ekonomik. Prandaj dhe kërkohet një ndërrim i prioritetëve. Për suksesin e luftës kundër “faktorëve kërcënues”, siç u theksua edhe më sipër, janë të nevojshme programe të bashkërenduara dhe një filozofi kombëtare, që përfshin, si forcimin e kohezionit social të shoqërisë sonë, ashtu dhe forcimin e familjes, edukimin e qytetarëve me arritjet e kulturës demokratike dhe të politikave të sigurisë. E kritikueshme është që përveç partive politike edhe mediat publike dhe të pavarura trajtojnë fare pak çështje të tilla që, kuptohet, s’kanë atë nivel sensacioni që kanë sherret midis politikanëve para kamerave!

Nuk e quaj të tepërt të përsëris në mbyllje, se dështimi në politikat ekonomike dhe të sigurisë, si dhe në “edukimin e qëndrueshmërisë”, mund të çojë në diskreditimin dhe humbjen e arritjeve të demokracisë. Edhe në rrafsh botëror liritë dhe të drejtat e njeriut, si instrument kryesor i sigurisë përbën një nga çështjet kyçe të globalizimit dhe të filozofisë së shek. XXI.

Gary King
Christopher J. L. Murray

RIKONSIDERIMI I SIGURISË NJERËZORE (I)

Në vitet 1990, dy fushat dominante të politikave të jashtme - zhvillimi ekonomik dhe siguria ushtarake - u bënë të ndërthurura. Zhvillimi i institucioneve të sigurisë gjithashtu ka pësuar një periudhë turbullire konceptuale, për arsye të mbarimit të Luftës së Ftohtë, të pranimit të modeleve shumë të pabarabarta të ndryshimit në komponentë të ndryshëm të zhvillimit, të ndryshimeve teknologjike dhe politike të emëtuara me termin “globalizim”. Një pasojë ka qenë shfaqja e konceptit të “sigurisë njerëzore” (ang. human security). I përdorur nga UNDP, ky term shpesh nënkupton “liri nga frika dhe varfëria”¹ Siguria njerëzore shumë shpejt zuri një vend qendror në diskutimet në lidhje me politikat e jashtme, p.sh. ministrat e Jashtëm të Grupit të të Tetëve (G8) në qershor 1999 deklaruan se janë “këmbëngulës për të luftuar shkaqet që ndodhen pas kërcënimeve të shumëfishta ndaj sigurisë njerëzore”.² Përveç lidhjeve të njohura mes zhvillimit dhe fushës së sigurisë, përkufizimi alternativ mbi sigurinë njerëzore dhe mbi agjendën kërkimore dhe politikëbërëse mbetet i paqartë.

Në këtë artikull ne propozojmë një përkufizim të thjeshtë, rigoroz, dhe të matshëm për sigurinë njerëzore: numrin e viteve të jetës së ardhme që do të kalohen jashtë gjendjes së “varfërisë së përgjithësuar”. Quhet varfëri e përgjithësuar

¹ Lincoln C. Chen, “Human Security; Concepts and Approaches” in T. Matslmae and L. C. Chen. eds., *Common Security in Asia: New Concepts of Human security* (Tokyo; Tokai University Press, 1995); United Nations Development Program (UNDP), *New Dimensions of Human security* (New York: Oxford University Press, 1994); A. Florini and P. J. Siuunons, *The New Security Thinking: A Review of the North American Literature* (New York: Carnegie Endowment for International Peace, 1998).

² Lloyd Axworthy, “An Address On Human Security,” Minister Of Foreign Affairs, To The G-8 Foreign Ministers’ Meeting, 9 June 1999.

atëherë kur një individ bie nën pragun e një fushe kyçe të mirëqenies njerëzore. Agjenda për kërkimet studimore me qëllim ndërmarrjen e veprimeve për të rritur sigurinë njerëzore rrjedh logjikshëm nga ky përkufizim në fushat e vlerësimit, parandalimit, mbrojtjes dhe kompensimit të risqeve. Ne propozojmë idenë që akademikët dhe komunitetet politikëbërëse të formulojnë metodat dhe të dhënat bazë parashikuese në mënyrë që të mund të ndërmerren matje rutinë të nivelit mesatar rreth sigurisë njerëzore në komunitete të ndryshme. Më poshtë ne fillojmë me shqyrtimin e zhvillimeve paraprake në fushën e ekonomisë së zhvillimit dhe sigurisë kombëtare, që çuan në shfaqjen e konceptit të sigurisë njerëzore. Në përfundim të artikullit ne diskutojmë në lidhje me disa fusha kërkimi dhe veprimi për të ngritur sigurinë njerëzore, të cilat kanë qenë neglizhuar dhe në lidhje me nevojën për një ndërveprim më të ngushtë mes disiplinave të ndryshme që adresojnë sigurinë njerëzore, siç janë p. sh. shkencat politike dhe shëndeti publik.

Nga siguria kombëtare te siguria njerëzore

Zhvillimi i shkencës së ekonomisë së zhvillimit

Që në shek. XVII dhe XVIII, në kohën e William Petty dhe Adam Smithit, fusha e shkenca e ekonomisë së zhvillimit është fokusuar mbi përkufizime dhe qëllime të gjera për përkryerjen dhe mirëqenien njerëzore.³ Gjithsesi, pas Luftës II Botërore, politikanët dhe punonjësit nëpër agjencitë ndërkombëtare ose dypalëshe të ndihmës, bashkë me komunitetin akademik dhe organizatat joqeveritare (OJQ), e kthyen fokusin e tyre drejt të ardhurave kombëtare duke i konsideruar objektin kryesor të zhvillimit. Ky ndryshim përkonte me zbatimin e gjerë të të ardhurave kombëtare dhe llogaritjeve të produkteve për të matur aktivitetin ekonomik,⁴ me krijimin e Bankës Botërore

³ Sir William Petty, *Political Arithmetick* (London: Robert Clavel and Hen, Mortlock, 1690); Adam Smith, *An Inquiry into the Nature and Causes of the Wealth of Nations*, 1776, (published Oxford,

⁴ Robert Eisner, *The Total Incomes System of Accounts* (Chicago; University of Chicago Press, 1989).

dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, dhe me perceptimin e përhapur që mirëqenia njerëzore avancohet në radhë të parë me anë të rritjes ekonomike.

Gradualisht, ky fokus i ngushtuar mbi të ardhurat për frymë u bë objekt kritike, sepse studiuesit vinin në dukje krahasimin drastik me një qasjen e mëparshme që ishte më përfshirëse.⁵ Pakënaqësia me zhvillimet e pakta në kushtet e vendeve të varfra, bashkë me gjendjen e vështirë të të varfërve në të gjitha vendet, bënë që në vitet 1970 të lindte lëvizja për të plotësuar nevojat më të domosdoshme, e cila theksonte si prioritet të parë arritjen e një standardi minimal për të gjithë.⁶ Në vitet 1980, vende si Sri Lanka, Kuba, Kina, Kosta Rika, dhe shteti i Keralas në Indi - që kishin jetëgjatësi të pritshme të lartë dhe me nivele të ulëta të të ardhurave për frymë⁷ - ndërgjegjësuam studiuesit për faktin se niveli i të ardhurave jo gjithnjë mund të përdoret si tregues edhe për komponentët e tjerë të mirëqenies. Përpjekjet e UNICEF-it për të studiuar ndikimin e rregullimit strukturor mbi shëndetin, ushqimin dhe arsimin e fëmijëve patën një ndikim të konsiderueshëm në lidhje me këtë çështje.⁸ Duke mbetur në të njëjtat çështje, Mahbub ul-Haq filloi botimin e *Raportit për Zhvillimin Njerëzor* të OKB-së në vitin 1990.⁹ Në këtë raport, UNDP argumentonte se zhvillimi duhet të fokusohet te njerëzit (edhe pse të grupuar sipas shteteve) - jo te siguria e kufijve kombëtare - si edhe tek avancimi i edukimit, shëndetit, lirisë politike, përveç

⁵ Mahbub Ul-Haq, *Reflections on Human Development* (Oxford, UK; Oxford University Press, 1995); Amarly K. Sen, "Development Thinking at the Beginning of the 21st Century" in Louis Emmerij, ed., *Economic and Social Development into the XXI Century*, (Washington, DC: Inter-American Development Bank distributed by Joans Hopkins University Press, 1997).

⁶ Stephen Knowles, "The Evolution of Basic Needs and Human Development," *Revista Internazionale di Science Echnomichice e Commerciali* 60 (1993): 513-42

⁷ Scott B. Halstad, Julia A. Walsh, Kenneth S. Warren, cds., *Good Health at Low Cos!* (New York; Rockefeller Foundation, 1985).

⁸ Richard Jolly, Andrea Giovanni, Frances Stewart, eds. *Adjustment with a Human Face: Protecting the Vulnerable and Promoting Growth* (New York: Oxford University Press, 1988).

⁹ UNDP1990

mirëqenies ekonomike. Zhvillimi u përkufizua në mënyrë të gjerë si zgjerimi i mundësive individuale në gati çdo fushë të rëndësishme. Për të promovuar dialogun rreth zhvillimit njerëzor dhe për të arritur një vëmendje më të madhe politike tashmë UNDP boton çdo vit “Indeksin e Zhvillimit Njerëzor” (ang. Human Development Index), i cili është pak më i ngushtë, por gjithsesi një matës i mirë i të ardhurave për frymë, jetëgjatësisë së pritshme në lindje dhe arritjeve në arsim.¹⁰ Këndvështrimi i përgjithshëm, sipas së cilit zhvillimi nuk është vetëm e ardhura ekonomike, lidhet në *Raportin e Zhvillimit Njerëzor* me teorinë e aftësive të Amartya Senit.¹¹ Formulimi më i fundit i Sen tenton të përligjë këtë lëvizje në terma të zgjerimit të lirive individuale.¹²

Perspektiva e zhvillimit njerëzor është ende kundërthënëse,¹³ por gjithsesi ka qenë gjerësisht ndikuese në theksimin e dimensioneve jo-monetare të mirëqenies në debatet në lidhje me politikat e zhvillimit. Në disa mënyra, fokusi në rritje i Bankës Botërore dhe FMN-së në lehtësimin e varfërisë, në dallim, qëllimi i mëparshëm i rritjes së shtimit material (ang. growth), mund të konsiderohen si përgjigje ndaj theksit të UNDP-së mbi zhvillimin njerëzor. Që të japim një shembull tjetër, Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillimin e Jashtëm dhe Ndërkombëtar (DFID) ka ndërmarrë një qasje të ngjashme dhe shpalli se strategjia e vet është përgjysmimi i nivelit të varfërisë deri në vitin 2015.¹⁴

¹⁰ Ul-Haq, *Reflections*

¹¹ Amartya K. Sen, *Inequality Reexamined* (Cambridge, MA: Harvard University Press, 1992).

¹² “Amartya K., Sen, *Development as Freedom* (New York; Knopf, 1999).

¹³ Martin Ravallion, “Good and Bad Growth: The Human Development Reports,” *World Development* (1997); 631-8; Harsha Aturupane, Paul Glewwe, and Paul Isenman, “Poverty, Human Development and Growth: An Emerging Consensus?” *American Economic Review, Papers and Proceedings* 84 (May 1994): 244-9,

¹⁴ Clare Short, secretary of state for International Development, UK Government

Natyra e ndryshueshme e sigurisë

Paralelisht me debatin mbi zhvillimin, një numër i madh aktorësh kombëtarë e ndërkombëtarë, organizatash dhe akademikësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë, kanë debatuar lidhur me kuptimin e sigurisë. Pikëpamja tradicionale mbi sigurinë është fokusuar kryesisht në përdorimin e ushtrisë për të garantuar integritetin territorial të shteteve të pavarura. Studimet mbi sigurinë dhe institucionet e sigurisë për një periudhë të gjatë kohe kanë qenë të përqendruara në formulimin e politikave dhe mekanizmave mbrojtës për të shmangur, parandaluar, dhe nëse e kërkonte nevoja edhe për të fituar në përballje ushtarake ndërshtetërore.¹⁵

Fondet e shpenzuara në mënyrë globale për sigurinë ushtarake deri tani kanë qenë aq të mëdha sa mund të llogariten me të ardhurat individuale të 49% të gjithë banorëve të të gjithë botës.¹⁶ Në mënyrë të ngjashme një masë e madhe vlerësimesh, debatesh, dhe mendimesh është shpenzuar për formulimin dhe implementimin e politikave dhe analizave të politikës së jashtme përgjatë gjithë botës. Fatkeqësisht, megjithëse në kohën e tyre këto fonde kanë ndihmuar për të arritur një siguri relative të vendeve të veçanta dhe mbizotërimi i konflikteve ushtarake ka rënë gradualisht gjatë viteve të fundit, numri i viktimave të shkakuar në mënyrë direkte ose indirekte nga konflikte të ndryshme ushtarake çdo vit rezulton të jetë rritur të paktën deri në fillimet e viteve 1990.

Akademikë dhe politikëbërës filluan të pranojnë që edhe shembujt e suksesshëm të sigurisë territoriale nuk garantonin domosdoshmërisht edhe sigurinë individuale të qytetarëve brenda një shteti, një fakt për të cilin rastet e Koresë së Veriut dhe Ruandës mund të shërbejnë si shembuj. Bashkë me Robert McNamara-n,¹⁷ edhe analistët të tjerë gjithashtu filluan të

¹⁵ Stephen J, Del Rosso, "The Insecure State: Reflections on 'the State' and 'Security' in a Changing World," *Daedalus* 124(2): 175-207; David A, Baldwin, "Security Studies and (he End of the Cold War)," *World Politics* 48(1); 117-41.

¹⁶ UNDP, 1994: Figure 3.1, 48.

¹⁷ Robert S. McNamara, *The Essence of Security: Reflections in Office* (New York: Harper & Row, 1968).

pranojnë degradimin mjedisor¹⁸ dhe fatkeqësitë natyrore si epidemitë, përmytjet, tërmetet, dhe thatësitë si një kërcënim serioz për sigurinë po aq sa dhe tragjeditë e ndërmarrja nga ushtritë njerëzore.¹⁹ Kolapsi i Bashkimit Sovjetik, reduktoi ndjeshëm edhe kërcënimin e një lufte mes fuqive më të mëdha, dhe dividendi i supozuar i paqes hapi debat të gjerë nëse duhej zgjeruar më tej koncepti i sigurisë.²⁰

Këto debate çuan në thirrje për të marrë në konsideratë sigurinë nga një perspektivë globale si dhe për të përdorur idenë e re të sigurisë së përbashkët, tashmë jo vetëm nga një perspektivë individuale e shteteve të veçanta.²¹ Kohët e fundit, studiuesit kanë vendosur të përdorin frazën “siguri njerëzore” për të nxjerrë më në pah aspektet e këtyre përpjekjeve të përqendruar te njeriu.²² Argumenti i sigurisë njerëzore në shkencat humane përmblihte këndvështrimin se fokusi i studimeve të sigurisë duhet të zhvendoset nga shteti tek individit dhe duhet të përfshijë si kërcënimet ushtarake ashtu edhe ato joushtarake.

Lidhja mes literaturave të zhvillimit të sigurisë

Ideja e sigurisë njerëzore ka çuar në ndërthurjen e zhvillimit me sigurinë. Komuniteti i zhvillimit kanë parë një mundësi të

¹⁸ Lester Brown, *Redefining National Security*, WorldWatch Institute #14 (Washington, DC: WorldWatch, 1977).

¹⁹ Richard Ullman, “Redefining Security,” *International Security* 8 (1993): 123-29.

²⁰ M. Jessica Tuchman Mathews, “Redefining Security,” *Foreign Affairs* 68 (Spring 1989): 162-77; Zbigniew Brzezinski, “The Cold War and its Aftermath,” *Foreign Affairs* 71 (Fall 1992): 31-49; Theodore C. Sorenson. “Rethinking National Security,” *Foreign Affairs* (Summer 1990); Michael T. Klare, ed., *World Security: Challenges for a New Century* (New York: St. Martins Press, 1992).

²¹ •” Palme Commission on Peace and Disarmament: Project on World Security—Series of Papers

(<http://www.rbf.org/pws/p ubi ic. html>).

²² “T. F. Dixon, “Environmental Change and Human Security,” *Behind the Headlines* 48 (Spring 1991): 1-17; Lincoln C. Chen, “Human Security; Concepts and Approaches” in *Common Security in Asia—New Concepts of Human Security*, Tatsuro Matsumae and Lincoln C. Chen, eds., (Tokai University Press, 1995), 137-147

mirë për të kapur disa nga interesat politike më substanciale dhe burimet kryesore financiare të lidhura me sigurinë ushtarake dhe politikën e jashtme duke lidhur sigurinë njerëzore me zhvillimin human.²³ Ata në komunitetin e sigurisë ishin të interesuar për të mbuluar gjithashtu edhe fusha të reja.²⁴ Suksesi i fushatave për ndalimin e minave të tokës gjithashtu ka rigjallëruar interesat në përpjekjet ndërkombëtare për të shtuar sigurinë njerëzore më shumë se atë territoriale duke reduktuar kështu dëmet njerëzore që sillnin luftërat.²⁵

Një ngjarje në vitin 1994 afroi këtë bashkim, në kohën kur UNDP-ja botoi *“Raportin e zhvillimit njerëzor”*, i cili ishte i fokusuar në mënyrë shumë të qartë në çështjet e sigurisë njerëzore. Aty sillleshin argumentet se “siguria njerëzore nuk është një çështje që ka të bëjë me armët - por është një çështje që ka të bëjë me jetën dhe dinjitetin e njerëzve”.²⁶ Siguria njerëzore ka katër karakteristika esenciale: është universale, komponentët e saj janë të ndërvarura, sigurohet më mirë përmes parandalimit dhe vë në qendër njerëzit. Raporti gjithashtu propozoi që kërcënimet e sigurisë njerëzore mund të grupoheshin në shtatë kategori: ekonomike, ushqimore, shëndetësore, mjedisore, personale, komunitare dhe politike. Sigurisht, këto kategori nuk janë as përgjithësuese e as nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, dhe ato nuk përfaqësojnë në mënyrë complete aspekte baze apo thelbësore të kësaj ideje. Gjithsesi, objektivat kryesorë të UNDP-së ishin të përdornin sigurinë njerëzore si një koncept organizues për Konferencën e OKB-së së vitit 1995 në Kopenhagen mbi Zhvillimin Social. Për sa kohë që nuk u përdor si bazë për këtë samit social, çështja e sigurisë njerëzore (siç u propozua nga UNDP-ja) ka vazhduar

²³ Ul-Haq, Reflections Human Development

²⁴ Chen, “Human Security.”

²⁵ The International Campaign to Ban Landmines calls for: An International ban on the use, production, stockpiling, and sale, transfer, or export of antipersonnel landmines. The signing, ratification, implementation, and monitoring of the mine ban treaty. Increased resources for humanitarian denouncing and mine awareness programs. Increased resources for landmine victim rehabilitation and assistance” (<http://www.icbl.org/framcs/main.html>), 10 March 2001.

²⁶ UNDP, 1994

të funksionojë si një koncept organizativ për zhvillimin ekonomik, publik, shëndetësor, dhe të fushës së sigurisë.

Politikat e Jashtme bazuar në Sigurinë Njerëzore

Kanadaja, Norvegjia dhe Japonia kanë ecur përpara duke inkorporuar në mënyrë zyrtare konceptet e sigurisë njerëzore në politikat e tyre të jashtme. Politikanët dhe politikëbërës të tjerë në shumë prej vendeve të tjera janë duke marrë në konsideratë hapa të ngjashme. Kjo përpjekje, gjithsesi ka çuar në një përkufizim jo të qëndrueshëm dhe të paqartë, në njëfarë mënyre i lidhur me perspektivën. Për shembull, Kanadaja e ka përkufizuar sigurinë njerëzore si një “siguri dhe mbrojtje për njerëzit si nga kërcënimet e dhunshme ashtu edhe nga ato të padhunshme”,²⁷ një fokus pak më konservator dhe më i ngushtë sesa ai i dhënë nga UNDP-ja. Po të mbështetemi te koncepti i Departamentit të Punëve të Jashtme dhe Tregtisë Ndërkombëtare të Kanadasë, siguria njerëzore nuk mund ta zëvendësojë sigurinë kombëtare. Megjithatë, siguria kombëtare dhe siguria njerëzore mbështesin njëra-tjetrën. Mbështetur te ky konceptim i limituar, siguria njerëzore është liri nga frika dhe zhvillimi human është liri nga dëshira. Këto janë dy koncepte që megjithëse të ndryshme përforcojnë njëra-tjetrën.

Në një nivel praktik politik, aktivistët e politikave të jashtme të Kanadasë promovojnë forcimin e normave ligjore për ndërtimin e kapaciteteve për të përforcuar ato përmes përpjekjeve të tilla si Konventa e Otavës mbi minat kundër njeriut dhe Traktati i Romës që krijoi një Gjykatë Ndërkombëtare për Krimet e Rënda. Austria, Kanada, Kili, Irlanda, Jordania, Holanda, Sllovenia, Zvicra, Tailanda, dhe Norvegjia, gjithashtu kanë promovuar një agjendë pak më të limituar të sigurisë njerëzore. Këto vende janë fokusuar më shumë te minat antiinjuri, armët e lehta, fëmijët në konfliktet e armatosura, dhe misionet humanitare ndërkombëtare bashkë me ligjet për të drejtat e njeriut.²⁸

²⁷ Axworthy, “Address on Human Security.”

²⁸ Deklarata e Lysoen: Canada-Norway. Në një takim oficerësh të vjetër në Otava (7-8 Dhjetor 1998), Kanada dhe Norvegjia ranë dakort përtë ndërmarrë një sërë çështiesh për sigurinë njerëzore në një axhendë

Zyrtarët japonezë kanë formuluar gjithashtu një agjendë të politikës së jashtme në të cilën siguria njerëzore luan një rol qendror,²⁹ por përkufizimi i tyre për sigurinë njerëzore është më përfshirës se ai i Kanadasë. Gjithashtu ai ndryshon në disa pika edhe nga përkufizimi i UNDP-së. Mbështetur te koncepti i politikave të jashtme të Japonisë, “siguria njerëzore në mënyrë të përgjithshme përfshin të gjitha rreziqet që kërcënojnë mbijetesën e njerëzve, jetën e tyre të përditshme dhe dinjitetin e tyre - për shembull, degradimi mjedisor, dhunimi i të drejtave të njeriut, krimi i organizuar ndërkombëtarë, drogat e paligjshme, refugjatët, varfëria, minat antinjeri si dhe sëmundjet e tjera vdekjeprurëse si AIDS - dhe shtimi i përpjekjeve për të krahasuar këto kërcënime”.³⁰ Siguria njerëzore e ka depërtuar në agjendat e takimeve të G7/G8. Takimi i ministrave të Jashtëm në Këln, në qershor 1999 nxori një komunikatë në të cilën nënvizon çështjen e sigurinë njerëzore si një pikë qendrore të agjendës së tyre. Mbështetja politike dhe vizibiliteti i politikave të jashtme të bazuara në çështjet e sigurisë njerëzore gjithashtu është pasqyruar edhe diskutimet në Këshillin e Sigurisë së OKB-së; çështja e sëmundjes AIDS në Afrikë është marrë në shqyrtim e para në diskutimet e bëra në lidhje me çështjet e shëndetit publik.³¹

bashkëpunimi që përfshinë çështien e përfshirjes së fëmijëve në konfliktet e armatosura. Ato janë gjithashtu të angazhuara të ndiekin rekomandimet e bëra në Studimin e Graca Macfael për të lehtësuar përmirësimin e situatës për ndikimet e luftës tek fëmijët, dhe për të intensifikuar përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve përfshi këtu fundin e rekrutimeve të fëmijëve ushtarë, dhe të asistojnë në rehabilitimin dhe rintegrimin në shoqëri të fëmijëve të prekur nga luftë, Departmenti i Punëve të Jashtëme dhe Tregtisë i Kanadasë, (<http://www.dfait-maeci.gc.ca/menu-e.asp>), 10 March 2001.

²⁹ Keizo Obuchi, Prime Ministerial Address, “In Quest of Human Security,” Japan Institute for International Affairs 40th Anniversary Symposium, United Nations University, Tokyo, 11 December 1999,

³⁰ Ministry of Foreign Affairs of Japan, Diplomatic Bluebook 1999: Japan’s Diplomacy with Leadership Toward a New Century (Tokyo: Urban Connections Inc., 1999).

³¹ <http://www.in.ori/Nt-,ws/Press/docs/2WO/2IX300110.sc6781.doc.html>, 10 March 2001.

Problemet me përkufizimet ekzistuese

Lëvizja që zëvendëson idetë tradicionale të sigurisë kombëtare dhe zhvillimit human me një pikëpamje të re paradigmatiche, atë të sigurisë njerëzore, akoma vazhdon. Tashmë edhe disa nga mbështetësit më të fuqishëm të sigurisë njerëzore e pranojnë që përgjithësisht ky koncept është i përkufizuar dobët dhe i pamatshëm, dhe në rastin më të keq mund të konsiderohet edhe një slogan i mjegullt dhe jo shumë i qëndrueshëm logjikisht. Siguria njerëzore e formuluar nga UNDP-ja është kritikuar si shumë e zgjeruar për t'u përdorur si një mjet për sigurinë apo për politikat e jashtme. Studiuesit e politikave dhe të tjerë janë shqetësuar për faktin që nëse të gjitha komponentët e mirëqenies do të jenë të përfshira në konceptin e sigurisë njerëzore, ajo rrezikon të humbasë kuptimin e saj fillestar. Një ballafaqim i përbashkët i përkufizimit të sigurisë njerëzore duke analizuar një listë të krizave humanitare dhe kërcënimeve të kaluara është një hap i parë shumë i vlefshëm me karakter përshkrues, por nuk jep për këtë koncept një përkufizim të qartë të perspektivës dhe as një metodë të përshtatshme që buron nga elementët e listës apo që mund të përdoret për të vlerësuar këta elementë.

Për shembull, shtatë dimensionet e UNDP-së për sigurinë njerëzore përfshijnë një numër dimensionesh potenciale të ndërlidhura dhe të mbivendosura të përqendruara kryesisht në dinjitetin njerëzor, por që nuk mundën të siguronin një plan pune koherent për t'i integruar ato në një koncept të vetëm.³² Në mënyrë të ngjashme, Jorge Nef ka grumbulluar disa dimensione të sigurisë njerëzore dhe ka propozuar një alternativë me pesë klasifikimet e bazuar në sistem dhe mbi analizat e tij për elementët e sistemit botëror: ekologji/mjedisi, ekonomi, çështjet sociale, politike, dhe kulturore.³³ Mbështetur te Nef, këto nënsisteme janë të ndërlidhura nga një numër i madh fijesh me njëra-tjetrën: mjedisi dhe ekonomia janë të

³² UNDP, 1994

³³ Jorge Nef, *Human Security and Mutual Vulnerability: The Global Political Economy of Development and Underdevelopment*, 2nd ed. (Ottawa: International Development Center, 1999).

lidhura nga burimet, ekonomia dhe çështjet sociale nga forcat e shoqërisë sociale, çështjet sociale dhe politika nga negociatat dhe aleancat, dhe politika dhe kultura nga ideologjia.

Një shembull final i qasjes së listës deskriptive për të përkufizuar sigurinë njerëzore është edhe skema e një klasifikimi me bazë të gjerë i George MacLean.³⁴ Në këtë formulim, siguria njerëzore përfshin sigurinë e individit në rrethin, komunitetin dhe në mjedisin e tij/saj personal. Kjo përfshin mbrojtjen personale të individit nga çdo lloj violence apo sulmi, mundësi për gjërat më themelore për njeriun: mbrojtjen nga kriminaliteti apo terrorizmi, endemitë, korrupsioni politik, migrimi me forcë dhe mosrespektimi i të drejtave të njeriut, liria nga dhuna gjinore, të drejtat e minoriteteve politike apo kulturore, zhvillimi politik, ekonomik, dhe demokratik, parandalimi i abuzimeve me përdorimin e burimeve natyrore, mbrojtja e mjedisit, dhe përpjekjet për të zvogëluar ndotjen e ajrit.

Ne kemi bërë shumë intervista jo zyrtare me politikanët dhe me përgjegjësit e politikave të jashtme që përshkruajnë politikat e tyre në disa vende të ndryshme të botës që i përshkruajnë politikat e tyre në një mënyrë ose në një tjetër të lidhura gjithnjë me sigurinë njerëzore. Gati çdo person me të cilin ne biseduam ishte i shqetësuar në lidhje me faktin që nuk ekzistonte një përkufizim i pranuar gjerësisht dhe koherent mbi sigurinë njerëzore dhe nga fakti që kishte disa probleme të konsiderueshme konceptuale në lidhje me sigurinë njerëzore, zhvillimin njerëzor, dhe zhvillimin e fokusuar te varfëria, të bashkuara këto në formulime të caktuara në lidhje me politikat e jashtme.

Pa pasur një konsensus mbi përkufizimin teorik, arritja e objektivit në lidhje me matjen dhe përmirësimi i sigurisë njerëzore mbetet ende larg. Si rezultat, ne akoma nuk mund të shpresojmë të përdorim këtë koncept për të fokusuar

¹ George MacLean, "The Changing Perception of Human Security: Coordinating National and Multilateral Responses: The United Nations and the New Security Agenda," United Nations Association in Canada, 1998, (<http://www.iinac.org>)/canad<Vsecurity/maclean.hlnil), 10 March 2001.

politikat e agjencisë së OKB-së, UN-së dhe agjencisë për ndihmën bilaterale për të gjetur zgjidhje në njëfarë mënyre për çdo problem të njerëzimit në përgjithësi. Gjendja aktuale e paqëndrueshme në lidhje me diskutimet mbi sigurinë njerëzore gjithashtu kanë nxjerrë në pah faktin që aktualisht energjia e depozituar në literaturën akademike ende nuk mund të përdoret me produktivitet apo efikasitet të plotë për të përforcuar këto degë të rëndësishme të zhvillimit të politikave.

Përkufizimi i sigurisë njerëzore

Në përdorimin e përditshëm fjala “siguri” tregon liri nga rreziqe të ndryshme. *Oxford English Dictionary* e përcakton fjalën si: “Gjendje e të qenurit i mbrojtur nga... ose jo i kanosur nga rreziku, siguria e jetës... i lirë nga shqetësimet, ankthi dhe frika për të ardhmen; një ndjenjë sigurie, ose i lirë nga... apo mungesë rreziku”. Në një linjë të ngjashme, Siguracioni Shoqëror në Amerikë është një institucion i krijuar për të garantuar që individët të mos bien nën nivelin minimum të të ardhurave gjatë pensionit.

Ideja e sigurisë përmban kështu dy elemente kyçe; një orientim drejt rreziqeve në të ardhmen dhe një fokusim në risqet e rënies nën një prag kritik të gjendjes së të qenurit i privuar. Siguria ime sot nuk është vetëm një funksion e mirëqenies time sot. Siguria nuk është sinonim me nivelin mesatar të mirëqenies në të ardhmen, por në vend të kësaj ajo fokusohet në risqet e të qenurit tejmasë i privuar. Ajo gjithashtu është dhe parashikim për të shmangur gjendje të të qenurit shumë i privuar në të ardhmen.

Kriteri ynë për një përkufizim optimal është ai që zyrtarizon atë që paraqitet të jetë konsensusi ndërkombëtar në evoluim mbi sigurinë e të drejtave njerëzore, rigoroz, i saktë, logjikisht i qëndrueshëm, dhe i vlefshëm për të bërë politika publike. Për të hedhur bazat për këtë definicion ne shkurtimisht i hedhim një sy konceptit të mirëqenies. Pastaj propozojmë një koncept të përgjithësuar të varfërisë bazuar në rënie nën pragun kritik në çdo fushë të mirëqenies. Ne e përcaktojmë

sigurinë e një individi si moshë mesatare e pritshme e jetës pa kaluar gjendjen e një varfërie të përgjithshme. Siguria njerëzore e gjithë popullsisë është shuma e sigurisë njerëzore për çdo individ.

Fushat që përcaktojnë mirëqenien

Kuptimi i mirëqenies njerëzore ka qenë në debat për më tepër se 2.500 vite dhe është pasqyruar në mënyrë ekstensive në literaturën akademike³⁵. Formulimet e ndryshme të konceptit përfshijnë ato që mund të kategorizohen si gjendje mendore subjektive (të tilla si kënaqësia dhe rehatia) ose shkalla e kënaqësive objektive të dëshirave subjektive dhe gjendjeve objektive.³⁶ Një aspekt i rëndësishëm i këtyre teorive është parimi i përdorur për të vendosur se cilët komponentë të gjendjeve subjektive dhe objektive duhet të përfshihen në një konceptim të përgjithshëm të mirëqenies.³⁷ Për shembull, disa fusha duket se konsiderohen në mënyrë të qenësishme të vlerësuara të tilla si shëndeti, liria apo dija; ndërsa të tjerat janë mjete të rëndësishme për të arritur mirëqenien, p. sh. pasuria, ose derivate, si mungesa e krimit apo fatkeqësitë natyrore.

Përkufizimet e propozuara në kohë të hershme për sigurinë njerëzore nganjëherë kritikoheshin se ishin tej mase të zgjeruara: duke u përpjekur të përfshijnë gjithçka ato përfunduan pa asnjë kuptim. Për përkufizimin tonë, ne përfshijmë në sigurinë njerëzore vetëm ato fusha të mirëqenies

³⁵ Për shembull, Thomas Scanlon, *What We Owe Each Other*, (Cambridge, MA; Belknap Press of Harvard University Press, 1995); James Griffin, *Well-Being* (Oxford, UK: Oxford University Press, 1986); Amartya K. Sen and Bernard Williams, eds., *Utilitarianism and Beyond* (Cambridge, UK; Cambridge University Press, 1982); Sen, *Inequality Reexamined*; Tibor Scitovsky, *The Joyless Economy* (New York: Oxford University Press, 1982), 103-28; Thomas Scanlon, "Preference and Urgency," *Journal of Philosophy*!! (November 1975); 655-69; Jon Elster and John E. Roemer, eds., *Interpersonal Comparisons of Well-Being*; (Cambridge, UK: Cambridge University Press, 1991).

³⁶ Elster and John E. Roemer *Interpersonal Comparison*

³⁷ Robert E. Goodin, "Laundering Preferences" in Jon Elster and Aarund Hyland, eds., *Foundations of Social Choice Theory* (Cambridge, UK: Cambridge University Press, 1986), 75-101.

që janë thelbësore apo tej mase të rëndësishme. Ne nuk pretendojmë të kemi një mënyrë të vetme për ta vendosur këtë koncept normativ në veprim. Megjithatë, ne mendojmë që një metodë e vlefshme mund të jetë përfshirja e vetëm atyre fushave të mirëqenies që kanë qenë me rëndësi të mjaftueshme për qeniet njerëzore për të luftuar ose për ta vendosur jetën dhe pasurinë e tyre përballë një rreziku të madh. Komponentë të tjerë të mirëqenies mund të jenë të rëndësishëm, të vlefshëm e të dëshirueshëm e si pasojë duhet të përfshihen në njësitë përbërëse të matjes të mirëqenies të tilla si përpjekjet e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor dhe PNUD. Por këto të fundit do të përjashtohen nga përkufizimi ynë mbi sigurinë njerëzore.

Sapo këto elemente thelbësore të mirëqenies të identifikohen, korniza jonë na jep një atitute të konsiderueshme mbi mënyrën e operimit me secilën. Madje ne nuk kërkojmë që fushat e mirëqenies të jenë të pavarura dhe nga ana logjike shumë të dukshëm. Ato mund të jenë derivate, të qenësishme ose vetëm të matura në mënyrë indirekte. Përkufizimi përfundimtar dhe matja e sigurisë njerëzore mundet të jenë gjithashtu të njëjta. Për shembull, edhe një rast ekstrem të dy fushave plotësisht të ngjashme do të paraqisnin disavantazh të vogël konceptual për sa kohë që të dy janë të matshëm. Duke marrë parasysh sesi kategoritë janë kombinuar në ndërtimin e matjes së një varfërie të përgjithshme, asnjë ndryshim numerik nuk do të shfaqet në indeksin tonë të sigurisë njerëzore. Gjithçka që ne kërkojmë është një listë e komponentëve të matshëm dhe mundësisht të mbivendosur për mirëqenien aq sa kur merren së bashku përbëjnë atë që shumica e njerëzve e konsiderojnë mirëqenie.

Edhe pse përkufizimi përjashtues dhe njëkohësisht i lodhshëm i mirëqenies, bazuar në fusha të pavarura dhe të qenësishme që janë të gjitha thelbësore, do të ishin të preferueshme në të drejtën e vet, (dhe ne përsëritim studiuesit, të cilët vazhdojnë kërkimet e tyre të gjata drejt qëllimit të tyre) propozimi ynë për përkufizimin e sigurisë njerëzore nuk ndikohet shumë nga këto çështje të pazgjidhura.

Varfëria e përgjithësuar

Për arsyen se siguria bazohet në riskun e një privimi të fortë, ai varet shumë nga koncepti i varfërisë. Megjithatë varfëria shpesh përcaktohet si e lidhur me një faktor instrumental të vetëm - të ardhurat.³⁸ Për qëllimet tona, ne përfitojmë nga literatura që përcakton varfërinë më gjerësisht për të përfshirë privimin nga çdo mundësi thelbësore.³⁹ Ky konceptim më i zgjeruar ka shumë avantazhe, për më tepër i përshtatet mirë definicionit tonë. Për shembull: në rast se një person do të futej në burg, ushqimi dhe strehimi duhet të garantohen, por humbja e lirisë do ta çonte atë njeri në gjendje të varfër. Për të dalluar këtë nga të gjendja e të qenurit nën një nivel të caktuar të të ardhurave, ne i referohemi këtij koncepti me të gjerë si një varfëri në konceptin e përgjithshëm.

Sipas përkufizimit tonë, një person është në një gjendje varfërie të përgjithësuar kurdoherë që ai ose ajo është zhytur nën pragun e paracaktuar në çfarëdo qoftë komponenti të fushës së mirëqenies. Ndarja në dy anë për çdo komponent të mirëqenies bazohet në besimin se ka një diferencë cilësore në eksperiencën jetësore mbi dhe nën prag. Për shembull, diferenca midis të mos paturit ushqim të mjaftueshëm dhe të ushqyerit për të mbijetuar dhe nga ana tjetër të paturit ushqim të mjaftueshëm është plotësisht ndryshe nga diferenca ndërmjet të paturit ushqim të mjaftueshëm për të mbijetuar dhe të paturit ushqim që gjithashtu shijon veçanërisht mirë.

Për disa fusha të mirëqenies pragu mund të vendoset nën minimumin e një vlere të observuar me qëllim që individët të mos jenë në një gjendje të varfërisë së përgjithshme për shkak të nivelit të tyre në atë fushë. Për shembull, të kesh si pasuri sa më tepër makina normalisht që do të përmirësonte mirëqenien e dikujt, ndërkohë të mos paturit e asnjë makine nuk do të vendoste dikë në një gjendje të varfërisë së

³⁸ Shih, për shembull. World Bank relative and absolute poverty estimates, 1999..

³⁹ Sudhir Ahnand & Amartya K. Sen, "Concepts of Human Development and Poverty: A Multidimensional Perspective," Human Development Papers (New York: UNDP, 1997); Sen, Inequality Reexamined.

përgjithësuar. Për këto arsye, një numër fushash të mirëqenies, të tilla si fushat e krijimit, mund të përjashtohen në këtë mënyrë.

Një avantazh kyç i përkufizimit tonë të varfërisë së përgjithësuar është se ai nuk kërkon një sasi njësi matjeje për t'u zhvilluar për të "barazuar" fushat e ndryshme të mirëqenies. Për sa kohë që një personi i mungon një nga këto elemente thelbësore, në pjesë të caktuara të vitit do të quhej i varfëruar; i vetmi element i vendosur në mënyrë arbitrare në përkufizim është pragu për çdo fushë të mirëqenies. Për më tepër, politika botërore ka shumë eksperiencë me përzgjedhjen e vlerave të pragut për të ardhurat dhe për fusha të tjera (të tilla si për të vendosur nëse individët shpallen fitues për programe të caktuara). Edhe pse këto pragje janë arbitrare dhe mund të përmirësohen në teori në njëfarë mënyre (me kosto të vogël) ato përdoren shpesh pasi ato janë pasqyrime tepër të sakta të eksperiencave të jetës së njerëzve dhe janë të thjeshta për t'u përdorur. Për më tepër ndryshimet e vogla në këto pragje nuk japin gjithmonë aq ndryshime të mëdha sa japin indekset bazuar në ndryshimet e popullatës krahasuar me indeksin e përbashkët të mirëqenies.

Për shembull, ne trajtojmë të dy këto elemente: (1) të qenurit nën torturë, (2) të qenurit nën torturë dhe në prag vdekje nga uria, si gjendje të mjeruara dhe të papranueshme. Kushti numër 2 mund të jetë më i vështirë për t'u rikuperuar sesa numri 1, por nuk duhet të vendosim ne që sa më keq të jetë numri 2 krahasuar me numrin 1, personi po kalon një gjendje të një varfërie të përgjithësuar. Në mënyrë të njëjtë, një pakicë mund të debatojnë që personat që torturohen katër herë në ditë në vitin tjetër janë të sigurtë pavarësisht nga të ardhurat e tyre. Më tepër ka mundësi që torturimi në vitin tjetër t'i vendosë ata në një gjendje privimi të varfërisë së përgjithësuar. Pamja e përgjithshme e rezultatit i bën ata të pasigurt sot. Sigurisht, për qëllime analitike, përveç përkufizimit të sigurisë njerëzore, përcaktimet e një varfërie të përgjithësuar që përfshijnë shkëmbimet ndërmjet nivelit të arritjes në një fushë të mirëqenies përkundrejt një tjetre mund të jenë të sakta, veçanërisht kur individët lirshëm zgjedhin të balancojnë disa fusha të mirëqenies ndaj të tjerave.

Për sa kohë që ne nuk kemi nevojë të krijojmë dhe justifikojmë njësi matëse në kombinimin e fushave, ne mund të përfshijmë aq shumë fusha të tjera sa komuniteti ndërkombëtar bie dakord. Për shembull, ne mund të përfshijmë shkollimin si një fushë të mirëqenies, edhe pse nuk ishte quajtur më parë një element thelbësor për të patur një nivel minimum të mirëqenies.

Në pikëpamjen tonë, vendosja e pragjeve që përdoren për të përkufizuar varfërinë e përgjithësuar për qëllime të matjes së sigurisë njerëzore duhet të jetë e përgjithshme dhe jo me specifike kontekstuale apo rajonale. Siguria njerëzore është një çështje problematike dhe një sfidë në të gjithë botën. Për shembull, nëse të ardhurat përdoren si një instrument i përafërt për një numër fushash të qenësishëm të mirëqenies, atëherë një prag i vetëm i të ardhurave duhet të përdoret në të gjithë popujt e tjerë.

Pikëpamja alternative se varfëria është një koncept relativ, dhe prej kësaj del se pragu i varfërisë duhet të jetë më specifik nga pikëpamja kontekstuale, është një mënyrë të menduari e arsyeshme dhe praktike në botë, me nivele të ardhurash tej mase të shumëllojshme. Megjithatë, qëllimi ynë, (dhe ne besojmë se është dhe qëllimi i shumicës), është të konsiderojmë të gjithë njerëzit, pavarësisht nga vendndodhja, si përkatësi të të njëjtit komunitet global, dhe prej kësaj del se kërkohet një prag i përbashkët. Koncepti përfundimtar më pas duhet të jetë i krahasueshëm me individë dhe me popuj të ndryshëm.

(vijon në numrin e ardhshëm)

GARY KING është profesori i qeverisjes dhe drejtor i Qendrës së të Dhënave Harvard-MIT pranë Universitetit të Harvardit dhe këshilltar i vjetër shkencor pranë Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

CHRISTOPHER J. L. MURRAY është drejtor ekzekutiv i Njësisë për Evidencat dhe Informacionin për Politikën e Përbashkëta, pranë Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Puna e tij është e përqendruar në matjen e shëndetit dhe performancën e sistemit shëndetësor në të gjitha vendet e botës.

Zana Xhuka, Zv/Ministre e Mbrojtjes

STRUKTURAT E SIGURISË DHE TË MBROJTJES NË EPOKËN E INFORMACIONIT

Revolucioni i informacionit, që po ushtron një ndikim të fuqishëm në çdo aspekt të fushës civile, parashikohet se do të transformojë në mënyrë thelbësore, edhe operacionet e Forcave të Armatosura të së ardhmes, si në kohë paqe ashtu dhe në luftë.⁴ Në fakt, në realitetin e sotëm të formësimit të strukturave ushtarake dhe mënyrës së luftimit, vala e tretë, apo revolucioni i informacionit ka ndikuar në: zmadhimin e kapacitetit strategjik ushtarak, transformimin e strukturave ushtarake, fushën e luftimit. Për sa i përket kapacitetit strategjik ushtarak, revolucioni i informacionit po zgjeron kapacitetin tradicional strategjik me një dimension tjetër, atë të zbulimit. Kështu, dimensioneve tradicionalisht të njohura të strategjisë: dimensionit tokësor të luftimit, atij detar dhe ajror, i shtohet një dimension i katërt, ai i hapësirës kibernetike (*cyberspace*).

Transformimi i strukturave ushtarake po ndodh nga struktura tërësisht hierarkike në ato në formë “rrjetesh”. Është i mirënjohur fakti se strukturat ushtarake janë struktura tipike të organizimit vertikal me një formë të pastër hierarkike, sepse objektivi i tyre është përqendrimi i forcës ushtarake si në hapësirë ashtu dhe në kohë. Sot, teoritë e organizimit strukturor të organizatave të mëdha mbështesin transformimin e tyre drejt strukturave më të sheshta, me pak nivele hierarkike dhe me një sistem vendimmarrës të integruar. Kjo tendencë synon shndërrimin e tyre nga format klasike të organizimit në ato në formë rrjetesh, për shkak të nevojës së përpunimit të informacionit super të shpejtë në kohë, si dhe të përballjes me nevojën e transformimeve të përhershme strukturore. Megjithëse organizimet strukturore ushtarake janë mjaft

konservatore dhe pak reaguese ndaj ndryshimeve, efektet e zhvillimit të teknologjive të informacionit po i modifikojnë ato duke i transformuar në formë “rrjeti” (*network*). I njëjti fenomen vihet re edhe në transformimin e strukturave organizative të bizneseve të mëdha, duke konfirmuar rishtas tezën e ngjashmërisë ndërmjet modaliteteve të prodhimit të pasurisë dhe atyre të prodhimit të forcës ushtarake. Një strukturë ushtarake në formë rrjeti ka avantazhe të shumta në ambientin e sotëm të sigurisë. Struktura të tilla janë më fleksibël, më të adaptueshme, me veprueshmëri të madhe në kushtet e realizimit të operacioneve ushtarake të tipit jokonvencional, kundër rreziqeve asimetrike si p.sh lufta kundër terrorizmit, ose në përballjen me konfliktet etnike, fetare, etj. Meqenëse po flasim për luftën e informacionit, ato zvogëlojnë ndjeshëm dobësitë e sistemeve ushtarake, pra goditjen e tyre në pikat më kritike.

Revolucioni i informacionit ka filluar të ndikojë në modifikimin tërësor të fushëbetejës, si dhe të mënyrës së të luftuarit. Disa nga pikat kyçe, që mendohet se do të pësojnë ndryshime radikale janë:

- Komandim – Kontrolli (*Command and Control*) i instrumentit ushtarak
- marrja dhe administrimi i informacionit
- metodologjia dhe instrumentet goditëse të sistemeve informative të kundërshtarëve, në të njëjtën kohë mbrojtja e sistemeve të veta.

Në këtë kontekst, nga analistët e çështjeve të sigurisë e të mbrojtjes vlerësohet si kritik fakti që ky transformim i mënyrës së luftimit dhe fushë-betejës po i bën gjithnjë e më të pavlefshme konceptet tradicionale që ne kemi për kohën, forcën dhe hapësirën. Revolucioni në fushën e teknologjive të informacionit mendohet se do të ndikojë fuqishëm mbi konceptet e kohës, forcës dhe të hapësirës, të cilat do të ndryshohen tërësisht. Koha vazhdon të “kompresohet” dhe gjithnjë e më shumë po flitet për “real time”. Hapësira nuk do të jetë më me natyrë kompakte, por jouniforme dhe e zgjeruar

në të tre dimensionet e saj. Edhe për forcën ushtarake analistët po përpunojnë dhe përdorin konceptin “force multiplier” (i elementeve tradicionale), si dhe, nën ndikimin e teknologjive të reja të informacionit, forca po rritet në mënyrë eksponenciale.

Për sa i përket vetë fushës së luftimit, pala në luftim, e cila do të ketë *domenin e informacionit* dhe do të zotërojë aftësitë e duhura për përdorimin e armëve inteligjente do të realizojnë objektivin/synimin strategjik ushtarak: *maksimizimin e forcës me një kosto minimale*.

Epoka industriale kundrejt epokës së informacionit

Meqenëse, analiza e deritashme është ngritur mbi bazën teknologjike si një nxitëse e proceseve transformuese, po paraqesim në mënyrë të sintetizuar krahasimin e strukturave ushtarake të epokës industriale me ato të informacionit. Tabela e mëposhtme paraqet transformimin e shoqërisë dhe ekonomisë së saj nga baza industriale në bazën informatike, duke analizuar disa parametra: organizimi strukturor, misioni dhe objektivat, tipi i arsimimit dhe kërcënimet dhe rreziqet me të cilat përballen.

Përdorimi i *makinës si model strukturor* nënkupton se kemi të bëjmë me një sistem mekanik të përbërë nga pjesë të standardizuara dhe të përkëmbyeshme, të cilat kanë secila një funksion të vetëm special, për të përmbushur. Sisteme të tilla, meqenëse bazohen në role dhe funksione të mirëpërcaktuara, i nënshtrohen një menaxhimi shumë të ngurtë. Si dhe në organizimet e biznesit dhe ushtritë që përdorin modele mekaniciste, prodhojnë si rrjedhojë një burokraci të madhe.

Në epokën kur është informacioni ai që dominon, sistemet e ngurta të organizimit dhe të menaxhimit e drejtimit janë disfunktionale. Prandaj ato i nënshtrohen transformimit të tyre në struktura organizative në formë “rrjeti” shumë më fleksibël, duke përdorur si model ato të sistemeve, *network*-ve kompjuterike.

Çdo sistem veçohet për tipin e produktin që ai sjell. Sistemi industrial i fabrikave dhe uzinave rezultonte në një produkt

afatgjatë, sekuencial, të vazhdueshëm dhe me një ritëm të mirëpërcaktuar. Luftërat industriale kishin po të njëjtat karakteristika, me karakter përsëritës si dhe zhvilloheshin për vite apo sezone të tëra.

Luftërat e sotme synojnë përmbushjen e objektivave të tyre strategjike brenda një kohe sa më të shkurtër. Ajo janë shumë specifike, të pangjashme me njëra-tjetrën, si dhe synojnë përdorimin e strategjive, mjeteve dhe taktikave të veçanta për realizimin e synimeve të mirëpërcaktuara ushtarake.

Outputi masiv/produkti masiv është tipari që karakterizon në veçanti epokën industriale. Të gjitha etiketoheshin si masive: prodhim masiv, media masive, reklamim masiv, komunikim masiv, edukim masiv, shpërndarje masive dhe të gjitha tipat e lëvizjeve të ndryshme politike dhe sociale, të cilat ishin po masive. Dhe, luftërat që kjo epokë prodhoi ishin ndoshta më të përgjakshmet e historisë, që sollën shkatërrim dhe vrasje masive.

Lufta e informacionit, siç do të shpjegojmë në vijim, synon uljen e ndjeshme të shkallës së letalitetit, duke goditur objektiva specifike, në veçanti sistemet e informacionit të armikut, për të realizuar përfundimin e luftës me sa më pak viktima. Që një luftë të kryhet duhet të përgatitet dhe aftësia përkatëse ushtarake, që realizohet përmes sistemeve të arsimit dhe trainimit, përgjegjës për krijimin e një ushtrie dhe ushtaraku me tipare të mirëpërcaktuara. Dhe ky dimension ka ndryshuar me kohë, nga ushtria e tipit agrar dhe deri në ushtrinë e tipit të informacionit.

Industrializimi e shndërroi shërbimin në ushtri në një *profesion*. Dhe meqenëse konteksti social i saj ishte, siç e përmendëm më lart, “*makina*”, në themel të së cilës qëndronte *specializimi*, tek ushtarakët duhet të zhvilloheshin dhe mishëroheshin ato aftësi konceptuale, teknike dhe organizative të nevojshme për të sinkronizuar përpjekjet individuale të pjesëve të veçanta të makinës së tyre ushtarake.

Në epokën e informacionit, strukturat ushtarake nuk janë më krejtësisht mekanike, por gjithnjë e më shumë funksionale. Sot, konceptet ushtarake përpunohen drejt konceptimit dhe ofrimit të “*niche capabilities*” - kapacitete thelbësore e të veçanta

të zhvilluara në një drejtim të caktuar për përmbushjen e një misioni specifik. Përpjekjet individuale nuk janë një shumatore mekanike e pjesëve të veçanta, por kombinimi i tyre sjell sinergji.

EPOKA INDUSTRIALE		EPOKA E INFORMACIONIT	
<i>Makina</i>	<i>Modeli i strukturimit të ushtrive, si dhe të strukturave të tjera, bazohej te “makina” – pjesë të ndërlidhura mekanikisht.</i>	<i>Rrjetet</i>	<i>Modeli i strukturimit të ushtrive, bazohet në rrjetet, role dhe përgjegjësi të ndërlidhura funksionalisht, si në rrjetet kompjuterike.</i>
<i>Prodhim afatgjatë</i>	<i>Luftërat, ashtu si dhe prodhimi në një ekonomi industriale ishin afatgjata, sekuenciale dhe të vazhdueshme.</i>	<i>Prodhim afatshkurtër</i>	<i>Luftërat, në epokën e informacionit do shkurtohen në kohë, duke synuar luftën “real time”</i>
<i>Outputi /produkti masiv</i>	<i>Tipat e operacioneve ushtarake synonin realizimin e objektivave masive: luftëra, armë, humbje dhe fitore të shkallës së gjerë.</i>	<i>Outputi /produkti sipas konsumatorit</i>	<i>Operacionet ushtarake të kohëve të sotme janë sipas tipit të krizave dhe konflikteve, duke realizuar dhe përdorur armë të precizionit të lartë.</i>
<i>Profesionalizmi</i>	<i>Oficeri si profesionist ishte produkt i një arsimimi të standardizuar dhe të specializuar, sipas armëve kryesore, etj.</i>	<i>Qytetar me uniformë</i>	<i>Oficeri si qytetar me uniformë është tipi i sotëm, në përputhje me operacionet shumë të individualizuara dhe përfshirjen sociale</i>
<i>Armiku i përcaktuar</i>	<i>Kërcënimet dhe rreziqet, armiku i epokës industriale ishte krejtësisht i përcaktuar.</i>	<i>Armiku i padukshëm</i>	<i>Kërcënimet dhe rreziqet e epokës së informacionit janë asimetrike, të padukshme dhe të paparashikuara.</i>
BAZA INDUSTRIALE		BAZA INFORMATIKE	

Strukturat ushtarake në “Shoqërinë e informacionit”

Ndryshimet janë të thella, por siç e thamë edhe në analizën e revolucionit industrial apo të tipit të shoqërive që ato prodhojnë, në asnjë rast ne nuk ndeshemi me një ushtri tipike industrialiste apo të informacionit. Pra, në realitet, nuk ekziston një model i pastër, por një përzierje modelesh, e thënë ndryshe një ushtri të strukturuar për luftën e informacionit, të cilës i duhet të ndeshet me një ushtri të tipit industrialist.

Epoka e Informacionit dhe vendimmarrja strategjike

Në fund të fundit, gjithçka do të varet nga marrja e vendimit. Këtu qëndron edhe çelësi i suksesit për çdo tip sipërmarrjeje biznesi apo ushtarake. Duhet të merret në konsideratë fakti se, informacioni sot është gjithnjë e më i gjatshëm për të gjithë dhe kostoja në ulje e *teknologjive të informacionit* (IT) bën të mundur që shumica e sistemeve, e mjeteve të reja teknologjike të jenë të gjatshme në tregun e lirë botëror. Pra, gjithçka që ne kemi në dispozicion mund të posedohet edhe nga kundërshtari ynë potencial, individë, grupe apo shtete.

Për të ruajtur domenin e pushtetit teknologjik, edhe në fushën ushtarake, duhet të bëhet një politikë vendimmarrëse shumë e zhdëryjellët. Siç e thamë më lart, forcat e armatosura do të veprojnë në një mjedis operacional tërësisht të transformuar, ku koha dhe hapësira nuk janë më ato që tradicionalisht kemi matur apo konceptuar.

Gjithçka do të zhvillohet më shpejt, apo në çast - "*real time*". Lufta do të zhvillohet gjithnjë e më shpejt, "*real time war*". Vendimet që lidhen me identifikimin, përcaktimin dhe marrjen e objektivit do të merren me një shpejtësi shumë më të madhe se sa e lejon vetë fiziologjia humane, apo "*real time decision*".

Teknologjia moderne e komunikimit dixhital dhe satelitor do ta zgjerojë më tej hapësirën e luftimit, në katër dimensionet e saj, dhe një komandanti do t'i duhet të komunikojë me forca gjithnjë e më të shpërndara e në distanca më të largëta, në një fushëbetejë ku gjithçka do të vendoset vetëm nga teknologjitë e komunikimit satelitor dhe menaxhimi i informacionit/inteligjencës.

Një tjetër parametër shumë i rëndësishëm i luftimit, që ndryshon totalisht në luftën e informacionit, është edhe *vrojtimi*, apo mbikëqyrja. Vrojtimi i fushëbetejës (potenciale) me ndihmën eurvejimit satelitor është "*vrojtim real time*" - në kohë reale, apo i pandërprerë. Në të ardhmen, përcaktuese do të jenë sistemet e informacionit. Dominimi i sistemit të informacionit të palës kundërshtare, si dhe përdorimi i armëve inteligjente do të jenë të një rëndësie vitale.

Vendimmarrja dhe aksioni përfundimtar varet nga aftësia që kanë për *feed-back* sistemet dhe strukturat që ne përdorim. Marrja e informacionit të duhur mbi rezultatet e vendimeve të marra konsiderohen si kritike për kryerjen në kohë të veprimeve të nevojshme korrektuese dhe të atyre përforcuese. Meqenëse dikur distancat e mëdha gjeografike e vononin me ditë, javë ose muaj realizimin e *feed-back*-ut mbi vendimet e marra apo luftërat në zhvillim, veprimet korrektuese ishin pothuajse të pamundura ose në rastin më të mirë joefektive. Ndërsa sot, në sja të komunikimit elektronik, si vendimmarrja ashtu edhe *feed-back*-u janë pothuajse “*real time*”, duke mundësuar edhe korrektimin “*real time*” të rrjedhës së vendimit apo të operacionit luftarak. Megjithëse mendimi i përgjithshëm është se *feed-back*-u informativ është i nevojshëm për marrjen e vendimeve në nivelin operativ dhe taktik, në realitet ai operon gjithnjë e më shumë në nivelin strategjik.


Cikli i vendimit

Deri më tani shpjeguar se fusha e luftimit do të karakterizohet nga procese transformuese në të gjithë parametrat e saj. Ndryshimet në tipin e bërjes së luftës në themel kanë një cikël të ndryshuar të vendimmarrjes. Cikli i mbyllur i vendimit **OODA**: **O**bservation, **O**rientation, **D**ecision, **A**ction (Observimi, Orientimi, Vendimi, Veprimi) ka ndryshuar esencialisht që nga koha e luftërave klasike dhe sot askush nuk mund të parashikojë sesi do të zhvillohen luftërat e së ardhmes. Në skemën e mëposhtme shikohet qartë sesi ka ndryshuar me kohë cikli OODA i vendimmarrjes strategjike në luftërat e zhvilluara në Amerikë, nga Lufta Revolucionare deri te Lufta e Gjirit (1991).

Cikli i komandimit

Në përfundim, shumë e rëndësishme për vendimmarrjen strategjike edhe në sferën ushtarake, në shoqërinë e informacionit është edhe roli i madh që ka marrë media

Koha dhe Komanda



elektronike dhe ajo e shkruar. Sot asnjë vendim nuk mund të merret pa u kapur nga mjetet e komunikimit masiv, të cilat duke përcjellë dhe amplifikuar me shpejtësi të madhe të gjitha tipat e krizave, konflikteve dhe luftërave që ndodhin në botën e sotme kanë rolin e tyre absolut edhe në kohëzgjatjen e luftës apo konfliktit dhe më kritikja në përcaktimin e fundit të tyre. *Vendimarrja strategjike ushtarake dhe në veçanti paqebërja janë tërësisht të influencuara nga pushteti mediatik.*

Përpunimi i informacionit dhe vendimarrja

Përveç tipit të sistemit organizativ apo mënyrës së realizimit të ciklit të vendimit, për çdo drejtues të nivelit të lartë, civil apo ushtarak, suksesi në vendimarrje ka dhe një dimension tërësisht individual. Ky dimension lidhet me proceset njohëse që zhvillohen tek individi, pra aftësia e individit për të menduar dhe ajo problem-zgjidhëse. Zhvillimi i teknologjive të informacionit ka “zgjjeruar” kapacitetin biologjik të memories së njeriut, në saje të përdorimit të kompjuterëve. Epoka e

informacionit po zhvillon mjetet dhe instrumentet e duhura për fuqizimin dhe zgjerimin e procesit të të menduarit dhe të vendimmarrjes.

Por, më konkretisht, meqenëse vlera e liderëve dhe ekzekutivëve të nivelit të lartë matet me atë që ata dinë/njohin, si dhe me suksesin e vendimeve që ata marrin, rrugët dhe mjetet me anën e të cilave teknologjia e informacionit do të mund të zgjerojë aftësitë njohëse dhe vendimmarrëse janë me rëndësi imperative. Në këtë kontekst shtrohet për zgjidhje një pyetje me interes të jashtëzakonshëm: Çfarë do të mund t'ju ofrojë liderëve të nivelit strategjik menaxhimi i përllogaritjes dhe i informacionit? Një përgjigje e mundshme përfshin:

Aksesin e menjëhershëm, të drejtpërdrejtë dhe të fokusuar te miliona ide, publikime dhe dokumente nga e gjithë bota. (WWW ka më shumë se 160.000 servera apo network-e në të gjithë botën)

Krijimin i një *kapaciteti* pothuajse të pakufizuar për ruajtjen e gjithçkaje që njohim/dimë, si dhe mundësimin e aksesit për te kjo dije, në përputhje me dëshirat individuale. Kapaciteti ruajtës është rritur me një ritëm të paimagjinueshëm.

Mundësimin e komunikimit me network-et lokalë dhe network-et globale.

Eksplorimin e ideve të shumëllojshme dhe manipulimin e lirë të tyre. (Forumet e *e-mail-eve*, *chatroom-at*, bordet e buletineve, si pajisje të fuqishme kërkimi në *web - search tools* - të cilat realizojnë ekspozimin e lirë të ideve nga i gjithë globi)

Me ardhjen e “*sistemeve ekspert*”, kompjuterat mund të ndërveprojnë ndërmjet tyre ashtu siç ndërveprojnë edhe njerëzit me njëri-tjetrin, p.sh. bashkëmoshatarët me njëri-tjetrin apo me mësuesin, duke përhapur ide dhe zgjidhje më krijuese, më efektive, më eficiente dhe më domethënëse të problemeve. “*Wizard-et*” dhe sistemet e mbështetjes së vendimeve influencojnë mbi të gjitha aspektet e jetës sonë.

Bibliografia:

- Beniger, James R. 1990. *The Control Revolution, Technology and the Future*.
- Brikerhoff, David B. 1998. *Sociology*.
- Carter, Ashton B. and Perry, William J. 1999. *Preventive Defense: A new Security Strategy for America*.
- Henri, Ryan & Peartree Edward C. 1998. *Military Theory and Information Warfare*. Center for Strategic & International Studies.
- Information Warfare : A two edged Sword*. Available: <<http://www.rand.org/publicatios/randreview/issues>>
- Jensen, Owen E. 1994. "Information Warfare: Principles of Third-Wave War". *Airpower Journal*, Winter 1994
- MISS. 1999. *Impakti i evolucionit në informacion në të ardhmen e fushës së luftimit*.
- National Defence University. *Strategic Leadership and decision Making, Information age and strategic decision making*.
- Nye, Joseph S. Jr. 1999. "Redefining NATO's mission in the Information Age". *NATO Review*, no. 4.
- Samiti i NATO-s në Uashington, 23-25 prill 1999.
- Schwartz Peter, *Shock Wave (Anti) Warrior*. Conversation with Alvin Toffler.
- Selections from C. Clausewitz's On War*.
- Sullivan, Gordon R. & Dubik, James M. 1994. *War in the Information Age*.
- Toffler, Alvin & Toffler Heidi. 1993. *War and Anti-War: Survival at the Dawn of the 21st Century*. New York: Little, Brown and Co.
- Wheatley, Gary F. and Hayes, Richard E. 1996. *Information Warfare and Deterrence*. NDU Press Book.
- Wilson, Peter Lamborn. 1995. *The Information war*. Speech given on the 17th of March 1995.

Jeffrey Winbourne
dr. Velizar Shalamanov

MENAXHIMI I URGJENCAVE SI SHTYLLË E SIGURISË CIVILE: NJË QASJE PRAKTIKE

Hyrje: Koncepti në evoluim i sigurisë civile në Evropë

Sigurimi dhe siguria janë elemente kyçe të cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët e Bashkimit Evropian (BE) dhe pas zgjerimit të fundit shpenzimet për to po i afrohen 500 milionë euro në 27 vende të ndryshme evropiane. Kjo është një çështje për të gjitha vendet e Stabilizim-Asociimit si edhe për bashkësinë e re të vendeve të Politikës së Fqinjësisë së BE-së (PFE). Duke e njohur faktin se siguria në ditët tona ka në qendër qytetarin, shqetësimi i parë duhet të jetë sigurimi i çdo qytetari të BE/PFE-së dhe shoqëria si e tërë¹. Kërcënimi më i zakonshëm është i lidhur me tipat e ndryshëm të ngjarjeve të rrezikshme – që nga incidentet e përditshme deri tek urgjencat e mëdha, përfshirë pasojat e aksidenteve teknologjike të krijuara nga njeriu dhe madje veprimet terroriste.

Ka shumë aspekte të sigurisë, kur përfshihen menaxhimi i krizave, menaxhimi i urgjencave/mbrojtja civile, menaxhimi i fondeve të solidaritetit, rendi publik, përgjigjja në Numrin Evropian të Thirrjeve të Urgjencave (112). Çështja e fundit nuk është e vlefshme në territorin BE-së, por kur qytetarët e BE-së ndodhen jashtë federatës, si edhe është prioritet i rëndësishëm për vendet fqinje të BE-së.

Veçanërisht kur bëhet fjalë për Menaxhimin e Krizave ka një mbivendosje midis BE-së dhe NATO-s (le të përmendim vetëm serinë e stërvitjeve të CMX të NATO-s dhe seritë e stërvitjeve CME të BE-së) që në disa aspekte zgjatohet te

¹ Bengt Sundelius, A brief of Embedded Societal Security, "Information and Security" International Journal, Vol. 17, 2005, pp. 23-40.

menaxhimi i urgjencave, duke patur ndër mend përgjegjësitë e Qendrës Evropo-atlantike të Bashkërendimit të Operacioneve të Shpëtimit në Rastet e Katastrofave (**EADRCC**) në NATO dhe Qendrën për Monitorim dhe Informim (**MIC**) në BE. Duket sheshit që është nevoja për qartësim në fushën e menaxhimit të krizave, menaxhimit të urgjencave dhe menaxhimit të incidenteve në BE, shtetet anëtare/shtetet fqinje deri poshtë në nivelin vendor në çdo vend si edhe për një fokus të veçantë mbi bashkëpunimin ndërkuftar.

Faza e parë në këto zhvillimeve do të ishte themelimi i Shtyllës së Menaxhimit të Urgjencave në Sigurinë Civile Evropiane, duke adresuar çështje si:

1. Menaxhimi i Krizave – Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Krizave (**CM**) dhe ndërveprimi midis BE-së dhe NATO-s në fushën e menaxhimit të krizave.
2. Evoluimi i konceptit të sigurisë civile në Evropë dhe marrëdhëniet e tij me konceptin e Sigurisë së Atdheut në SHBA.²
3. Menaxhimi i Urgjencave – Sistemi i Integruar për Menaxhimin e Urgjencave, përfshirë Paralajmërimin e Hershëm (**EW**) dhe Njoftimin.
4. Menaxhimi i incidenteve – Sistemi i Komunikimeve të Urgjencave 112 (**ECS**).
5. 112-IEMS si një shtytës i teknologjisë – teknologjitë kryesore në këtë fushë janë vërtet një sfidë e teknologjisë së lartë dhe integrimi, edukimi/trajnimi, mirëmbajtja, operacionaliteti i tyre janë madje një sfidë akoma më e madhe në kuptimin e qeverisjes dhe menaxhimit.

BE-ja e miratoi Sigurinë Civile me anë të Temës 9 “Siguria” në Programin e 7-të Kuadër të BE-së (7FP 2007-2013) që do të japë shtysë për më shumë kërkime dhe përpjekje zhvillimi nga niveli konceptual në atë të zbatimit teknik. Qëllimi është

² Peter Faber, Homeland Security: General Templates and Options for the Future, “Information and Security” International Journal, Vol. 17, 2005, pp. 9-22.

të themelohet në BE një model dhe standarde për përbashkëta për incidente dhe menaxhimin e urgjencave që do të ofrojë për një nivel të përmirësuar të sigurisë për qytetarët dhe bashkëpunim më të ngushtë ndërkuftar, si edhe solidaritet të shprehur më efektivisht midis shteteve anëtare dhe fqinjëve. Sistemet e menaxhimit të incidenteve dhe urgjencave do t'i japë më shumë pushtet autoriteteve vendore dhe zotërim rajoneve.

Siguria Civile dhe Menaxhimi i Urgjencave / Sistemi i Komunikimit të Urgjencave të Numrit të Njësuar. Për të ofruar siguri civil për të gjithë qytetarët e Zonës Evropiane – nga SHBA-ja dhe Kanadaja, përmes BE-së në vendet e fqinjësisë së afërt dhe të atyre të Dialogut Mesdhetar dhe të Nismës së Bashkëpunimit të Stambollit, është e nevojshme të ketë politika të pjekura, të ndjekura nga struktura organizative efikase, sisteme të integruar me personel të mirëtrajnuar dhe menaxhim efektiv të burimeve.

Në përkufizimin e Politikës së Sigurisë Civile të BE-së është i nevojshëm adresimi i çështjeve të tjera të menaxhimit të urgjencave (Siguria Civile), si:

1. Përkufizimi i fushave të menaxhimit të krizave, menaxhimit të urgjencave, përgjigjes ndaj urgjencave (incidenteve) dhe të konsiderohet menaxhimi i urgjencave si një element kryesor madje për çështjet e menaxhimit të pasojave të sulmeve terroriste dhe si rezultat lidhja midis Sistemit të Menaxhimit të Krizave, Sistemit të Menaxhimit të Urgjencave, Sistemit të Përgjigjes ndaj Incidenteve 112.
2. Arritja e një niveli më të lartë të sinkronizimit të menaxhimit të krizave/aktivitetet e menaxhimit të krizave në BE/ Komisionit Evropian – Çështjet e Drejtësisë dhe të Brendshme, Mjedisi (Mbrojtja Civile), **ESDP** si edhe përpjekjet kërkimore në Kuadër të Programit të 7-të Kuadër (Tema “Siguria”) dhe përpjekjet e Agjencisë së Mbrojtjes Evropiane në fushën e menaxhimit të krizave/menaxhimit të urgjencave.

3. Përmirësimi i organizimit të bashkëpunimit ndërmjet agjencive – në nivelin shtetëror veçanërisht midis Ministrive të Brendshme, të Shëndetësisë, të Shërbimit të Mbrojtjes Civile (në Bullgari Ministria për Katastrofat dhe Aksidentet - **MoSPDA**) – roli i Komisionit Evropian është në vendosjen e një baze më të mirë për këtë bashkëpunim në nivelin shtetëror – veçanërisht në shtetet e reja anëtare.
4. Përmirësimi i bashkëpunimit midis Qeverisë Qendrore dhe autoriteteve vendore (rajonet, qarqet, bashkitë).
5. Fuqizimi i ndëroperacionalitetit në fushat menaxhimit të krizave/menaxhimit të urgjencave, në nivelet e proceseve dhe procedurave, të dhënave, komunikimeve
6. Plotësimi në një nivel më të lartë i kërkesave për transparencë dhe llogaridhënie të shërbimeve/përgjigjeve të urgjencave, bazuar mbi statistikat e gjeneruara të operacioneve të zbatuara/kryera ose përgjigjeve ndaj thirrjeve të urgjencave nga shërbimet e sigurisë civile.
7. Përkufizimi i kërkesave të qarta për transparencën dhe llogaridhënien e veprimtarive të rigjenerimit/zbutjes së shërbimeve përkatëse.
8. Përmirësimi i nivelit të përdorimit të Teknologjive të Informacionit në menaxhimin e urgjencave si një mjet për të ulur korrupsionin dhe përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm në përgjigjet ndaj urgjencave.
9. Kërkesat dhe standardet e zhvillimit të ndarjes së informacionit të paralajmërimit të hershëm midis shteteve anëtare të BE-së dhe me shtete të tjera – SHBA, Kanada, Rusi, etj.
10. Plotësimi i kërkesave dhe i standardeve për harmonizimin e organizimit dhe qeverisjes së sistemeve të menaxhimit të urgjencave në shtetet anëtare të BE-së si edhe në nivelin e Komisionit Evropian, në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i klauzolës së solidaritetit në rrethana të menaxhimit të urgjencave/krizave
11. Futja në përdorim e standardeve të BE-së për menaxhimin e urgjencave dhe Sistemin e Komunikimit të Urgjencës me numrin 112 – veçanërisht performanca për marrësit e telefonatave, shpërndarësit dhe respondentët e parë.

12. Futja në përdorim e kërkesave dhe standardeve në trajnimin dhe certifikimin e personelit të menaxhimit të urgjencave, duke filluar me respondentët e telefonatave, shpërndarësit, respondentët e parë, planifikuesit, etj.
13. Përfshirja e Sigurisë Civile dhe veçanërisht e menaxhimit të urgjencave/Sistemit 112 si një element në Politikën e Fqinjësisë së BE-së, për të ofruar një mjedis të përshtatshëm për sipërmarrjen, qytetarët e atyre vendeve dhe vizitorët nga BE-ja.
14. Bashkëpunimi midis BE-së dhe SHBA-së/Kanada mbi menaxhimin e urgjencave dhe Sistemet e Komunikimit të Urgjencës 112/911.
15. Përkufizimi i Nismës së Sigurisë Civile të BE-së me fokus mbi Planin e Veprimit të BE-së mbi Menaxhimin e Urgjencave.

A mund të jetë Standardi Evropian për sigurinë i frytshëm në shndërrimin e sistemeve të menaxhimit të urgjencave të shteteve të reja të BE-së (12 pas zgjerimit të fundit) dhe futja në përdorim e praktikave më të mira, me anë të Politikës Evropiane të Fqinjësisë, zonën e madhe rreth Bashkimit – sidomos në Ballkanin Perëndimor, si vendet më pranë anëtarësisë së plotë? Madje kemi nevojë për më shumë kur flitet për cilësinë e jetës dhe veçanërisht sigurinë që të harmonizojmë përpjekjet tona me ato të SHBA-së dhe Kanadasë – partnerët tanë më të mëdhenj në tregti dhe shkëmbime qytetarëve.

Zhvillimi i një sistemi të maturuar të menaxhimit të urgjencave, që fillojnë prej incidenteve të përditshme deri te katastrofat e mëdha e madje menaxhimi i pasojave të sulmeve terroriste, është një mundësi e madhe për të futur në përdorim modelet e qeverisjes së mirë të bazuara në transparencë, llogaridhënie dhe matjen e rezultateve me pjesëmarrjen e autoriteteve vendore dhe qytetarëve.

Kultura e bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërmjet agjencive me anë të formës moderne të Memorandumit të Mirëkuptimit mund të përmirësojë më tutje cilësinë e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve. Adresimi prej nivelit të

BE-së në këtë fushë do të ndihmojë thellimin e arsimit publik mbi çështjet e menaxhimit të urgjencave dhe përmirësimin e nivelit të përgatitjes.

Duke mbajtur ndër mend se menaxhimi i urgjencave në të shkuarën varej nga Ministritë e Mbrojtjes, tashmë kanë kaluar në Ministritë e Brendshme në shumicën e vendeve, por me rolin serioz të Ministrive të Shëndetësisë, Mjedisit, Bujqësisë, Transportit dhe shumë të tjera – përfshirë zhvillimin rajonal, është e rëndësishme të përfytyrohet se çfarë lloji janë sfidat ndaj menaxhimit në këtë proces. Përveç tendencës për decentralizimin e menaxhimit të urgjencave dhe përgjegjësitë më të mëdha të autoriteteve vendore (rajone, qarqe, bashki) së bashku me mbajtjen e burimeve kryesore nën kontrollin e pushtetit qendror krijon tensione në hapat transformues. Madje situata bëhet më e ndërlikuar nëse shtojmë nevojën për bashkëpunimin ndërkuftar.

BE-ja mund të jetë shumë e efektshme nëse politikat në drejtësi, liri dhe siguri, nga mjedisi, shëndetësia së bashku me sipërmarrjen dhe industrinë, shkencën dhe kërkimin, si edhe marrëdhëniet e jashtme dhe politika e fqinjësisë evropiane, integrohen në **një politikë për hapësirën e përbashkët të sigurisë së qytetarëve evropianë**, në territorin e bashkimit si edhe në SHBA, Kanada, territorin e fqinjëve me të cilët BE-ja është e angazhuar seriozisht. Zgjerimi i mëtejshëm i kësaj hapësire për evropianët mund të jetë një nga qëllimet e **CFSP** dhe **ESDP**.

Kjo përpjekje në BE dhe veçanërisht në vendet e reja anëtare të BE-së me angazhime me SHBA mund të zhvillojë një instrument të ri për bashkimin për të promovuar stabilitetin dhe mirëqenien ekonomike.

Procesi i përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet agjencive, fuqizimi i rolit të autoriteteve vendore në marrëdhënie me Qeverinë Qendrore, futja në përdorim e teknologjive të reja, përfshirja më e madhe e qytetarëve dhe rritja e përgjithshme e vetëdijes publike në këtë fushë mund të përforcohet me anë të aksionit të BE-së në menaxhimin e urgjencave.

Gjatë viteve të fundit janë kryer shumë studime dhe projekte të sponsorizuara nga BE-ja, NATO, Banka Botërore,

Agjencia për Tregti dhe Zhvillim e SHBA-së dhe qeveritë e vendeve të ndryshme të BE-së, përfshirë anëtarët e rinj nga viti 2004-2007. Ndërtimi i IEMS-112 ECS është një çështje brezore (sistemet kanë një cikël jete prej 30-40 vjetësh) dhe është koha për të vendosur standardet, në mënyrë që të ketë ndëroperacionalitet dhe bashkëpunim më të lehtë. Për më tepër çështja e sigurisë civile është e përbashkët për të tërë bashkësinë evro-atlantike dhe fqinjësinë e BE-së, kështu që çështja është për t'u adresuar në dialogun BE-SHBA dhe në Politikën e Fqinjësisë së BE-së. **(ENP)**. IEMS-112 ECS është gjithashtu një temë e industrisë, për shkak të tregut të ri të sigurisë publike si edhe një sfidë teknologjike për nivelin e ri të maturimit të Sistemeve të Informimit dhe Komunikimit **(ICS)** të përdorura për sigurinë publike. Së fundi, por jo nga rëndësia, ajo është një çështje e zhvillimit ekonomik dhe cilësisë së jetës për rajonet, veçanërisht ato fshatare dhe më pak të zhvilluara.

Arkitektura e Përgjithshme e Sistemit të Menaxhimit të Urgjencave. Kur politikat përkufizohet, për ta zbatuar kemi nevojë për një arkitekturë të përbashkët të sistemit.³ Në Fig. 1 paraqitet përbërja e Sistemit të Integruar të Urgjencave **(IEMS)**, ku 112 Sistemi i Komunikimeve të Urgjencave **(ECS)** konsiderohet edhe si një sistem i Paralajmërimit të Hershëm **(EW)** prej qytetarëve, edhe si sistem komandimi dhe kontrolli **(C2)** (marrja e telefonatave, dërgimi e tyre, kontrollin në vend) për respondentët e parë në tipat e incidenteve të jetës së përditshme që kërkojnë skuadra të Mjekësisë së Urgjencës, skuadra të policisë, skuadra të zjarrfikësve, skuadra **CP** që veprojnë vetëm në incidente të veçuara.

³ George HANDY, John KIMBALL, and Jeffrey WINBOURNE, **BUILDING A SOUND AND FLEXIBLE EMERGENCY RESPONSE SYSTEM: HARD WON LESSONS IN DISASTER MANAGEMENT**, "Information and Security" International Journal, Vol. 19, 2006, pp. 31-38.

Përbërësit e Sistemit EM




Fig. 1. Përbërja IEMS (DMS – sistemi i vendimmarrjes, EOC – qendra e operacioneve të urgjencave, CIC – qendra e komunikimit dhe e informimit, CPX – Ushtrimi i Postës së Komandës, CAX – Ushtrim me ndihmën e kompjuterit, FX – Ushtrim në terren, JTSAC – Qendra e përbashkët e simulimit dhe e analizës.

Për **IEMS**, infrastruktura kyçe bazohet mbi rrjetin e qendrave **C2** – nga ato të lëvizshme në vendngjarje deri tek ato ndërkombëtare në BE, NATO, OKB, apo rajonale. Këto qendra në vendet e veçanta ndërtohen rreth qendrave Operacionale, Komunikimit dhe Informimit të ministrisë përgjegjëse për menaxhimin e urgjencave (në rastin e Bullgarisë është Ministria për Katastrofat dhe Aksidentet – **MoSPDA**). Rreth këtyre qendrave, përfshirë qendrën e lëvizshme në vendngjarje, është i integruar i gjithë sistemi **EM**, përfshirë Paralajmërimin e Hershëm dhe Njoftimin (**EW**). Rrjeti i qendrave **EM** tregohet në Fig. 2.

Qendrat EM




Fig. 2. Rrjetet e Qendrave EM

Një vend si Bullgaria vlerësohet të ketë 6 qendra rajonale, secila me qendër të lëvizshme dhe 30-40 qendra të bashkive/qarqeve si edhe së paku 30-40 qendra për kompanitë e mëdha. Qendrat kombëtare janë në ministri, kështu që ka 10-15 qendra të tilla në Sofje. Kjo do të thotë se ka 100 qendra **EM** nëpër tërë vendin. Në çdo vend numri i përgjithshëm i këtyre qendrave varet nga gjeografia, organizimi administrativ i territorit, numri i popullsisë dhe shumë faktorë të tjerë që vlerësohen në studime të realizueshmërisë, si parakusht për hartimin zyrtar.

Fig. 3. tregon strukturën e përgjithshme për qendrat e thirrjes dhe shpërndarjes dhe qendrat e bashkërendimit kombëtar (që mund të jenë të njëjta me qendrat **EM** për ministritë). Disa nga qendrat e dërgimit mund të operohen prej qendrave **EM** në nivelin rajonal/qarku, kur flitet për skuadrat e mbrojtjes civile. Për një vend si Bullgaria vlerësohet të ketë 5-6 qendra të thirrjeve dhe afro 100 qendra të dërgimit në nivelin të qarkut. Kjo do të thotë se gjithsej do të ketë më shumë se 200 qendra në rastin e Bullgarisë që duhen lidhur dhe të ndajnë informacionin duke përdorur lidhjet e të dhënave me anë të Dërgimit Kompjuterik/Sistemit Informacionit

Gjeografik/Sistemit të Pozicionimit Global (**CAD/GIS/GPS**) dhe bazat e të dhënave të lidhura me to, si edhe të kenë komunikime me zë/video – si linja të fiksuara telefonike po ashtu edhe të lëvizshme/radio.

112 ECS kërkon renduditet për të qenë operacionale gjatë incidenteve, por **IEMS** ka nevojë për më shumë renduditet dhe jetëgjatësi gjatë urgjencave në shkallë të gjerë – përfshirë, tërmete, stuhi, përmbytje, apo zjarr.

Qendrat e thirrjeve dhe të dërgimit




Fig. 3. Rrjeti i Qendrave të Thirrjes/Dërgimit

Përveç këtyre rrjeteve të qendrave, ne kemi praktikisht pjesën tjetër të 112 ECS të bazuar mbi telefonat e qytetarëve, rrjetin e operatorit të telekomit me një rol të veçantë të telekomit kombëtar (operatori i rrjetit të telefonisë fikse). Një sfidë serioze janë operatorët që u ofrojnë tip të ri shërbimeve telefonike, si p.sh. **VoIP** (zë në IP), **SMS** (sistemi i mesazheve të shkurtër), **IMS** (sistemi i mesazheve të çastit), video. Një aspekt tjetër i integritimit të qytetarëve në sistem është i lidhur me njerëzit me aftësi të kufizuar - veçanërisht ata që nuk

dëgjojnë. Me rritjen e larmisë së popullsisë bullgare dhe numrin e lartë të vizitorëve, çështja e shumëgjuhësisë duhet adresuar të paktën te qendrat e thirrjeve.

Analiza e të gjithë këtyre aspekteve të sistemit është një parakusht për të zhvilluar një arkitekturë gjithëpërfshirëse, procedura operationale (Protokolli Kombëtar i Operacioneve - **NOP**), Plan Kombëtar të Zhvillimit 112. Në nivelin e ulët dokumentacioni i plotë i sistemit do të ofrojë specifikime jo vetëm për pajisjen dhe mirëmbajtjen e saj, por edhe për pozicionet e stafit dhe trajnimet e specializuara si edhe menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit.

Vetëdija publike (trajnimi i popullatës dhe komunikimi me të në raste urgjencash). IEMS - 112 ECS e re ka si përdorues kryesor qytetarin e thjeshtë, kështu që është e një rëndësie të madhe të futet në përdorim ky sistem me të gjitha shërbimet e disponueshme ndaj shoqërisë dhe të qartësohen kufijtë si edhe rregullat e përdorimit të këtij numri të njësuar thirrjesh për urgjencat. Duke patur parasysh planin e tranzicionit prej numrave të tanishëm të thirrjeve urgjente – normalisht të ndryshëm për policinë, zjarrfikësit, urgjencat mjekësore (për shembull në Bullgari – 166, 160, 150) dhe numri për Mbrojtjen Civile, duhet t’u bëhet e qartë popullatës kur sistemi 112 të bëhet operacional në të gjithë vendin. Nevojitet të:

- Përgatitet një program i komunikimeve me publikun duke filluar nga projekti pilot;
- Zbatohet një fushatë kombëtare e rritjes së vetëdijesimit për sistemin 112;
- Bashkërendimi i një programi të komunikimit të brendshëm për stafin e agjencive përkatëse;
- Zhvillimi i procedurave të komunikimeve publike në raste urgjencash.

Ky proces do të përkufizojë planifikimin dhe financimin e mirë si pjesë të projektit të 112 ECS në bashkërendim me trajnimin e stafit. Partnerët vendorë të rajoneve janë një instrument i mirë për hartimin e fushatës, veçanërisht OJF-të. Operatorë të telefonisë fikse dhe kompanitë e siguracioneve

mund të marrin pjesë në këtë fushatë të vetëdijesimit të publikut.

Menaxhimi i Ciklit të Jetës. Përkufizimi i ciklit të jetës është i rëndësishëm për të kuptuar aspektin gjeneracional të ndërtimit të **112 – IEMS** në vitet e fundit.

Fazat e zhvillimit të ciklit të jetës për **112 ECS / IEMS** mund të përcaktohen si më poshtë:

1. Zhvillimi dhe eksperimentimi i konceptit - 2 vjet
2. Dizenjimi dhe ngritja e projektit pilot - ½ viti
3. Testimi dhe integrimi, trajnimi i personelit - ½ viti
4. Shtrirja kombëtare (*tranzicioni në më shumë se 100 qendra*) - 3-5 vjet
5. Operacionet dhe mirëmbajtja / vazhdimi i trajnimit - 30 vjet
6. Përmirësimi dhe modernizimi - 20 vitet e fundit
7. Përdorimi dhe tranzicioni në një sistem të ri - 3 vjet

Parimet e zhvillimit të ciklit të jetës:

- Hartimi i përgjithshëm dhe arkitektura e integruar për sistemin kombëtar, me marrëveshjen e palëve të interesuara.
- Qasje evolucionare për operacionet dhe teknologjinë për të parandaluar ndonjë ndryshim radikal që do ta ulte nivelin e shërbimeve të ofruara.
- Zbatimi fillestar pilot dhe hapja kombëtare
- Plani pesëvjeçar i hapjes

Projekti pilot për 1-3 qendra në vitin e parë

- Rajonet e tjera / Qarqet në 4-5 vitet e ardhshme
- Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese, menaxhimi i garancive dhe mbajtja e kontratave.
- Integrimi dhe Testimi
- **Cut Over**
- Konsolidimi i mirëmbajtjes dhe përmirësimi i mëtejshëm në një organizatë për efikasitet më të lartë dhe nivelin e përshtatshëm profesional
- Përdorimi i organizatës së mirëmbajtjes/përmirësimit si njësi integrimi për shitësit e ndryshëm

- Vendosija e standarteve të performancës dhe rezultati i financieve të orientuara
- Konsiderimi i modeleve të ndryshme për Partneritetin Publik-Privat (PPP) me telekomin dhe kompanitë e siguracioneve.

Mirëmbajtja, modernizimi dhe përmirësimi janë fazat më të gjata dhe më të standartizuara të mbështetjes së ciklit të jetës, që përfshin:

- Mirëmbajtje e vazhdueshme e sistemeve për të gjithë periudhën e operimit të sistemit
- Përmirësimet e sistemeve dhe rifreskimi i teknologjik pas 10 vitesh dhe për t'u përsëritur çdo pesë vite deri në zëvendësimin e sistemit me një të ri.

Modeli i ciklit të jetës është një bazë për llogaritjen gjithëpërfshirëse të kostos së sistemit dhe përdoret për të bërë ndryshimin midis shpenzimeve të ndryshme. Mund të ndihmojë në identifikimin e burimeve të ndryshme të financimit, përfshirë buxhetin e jashtëm shtetëror.

Menaxhimi i ciklit për **112 ECS** me të gjitha aspektet e zhvillimit, trajnimit, operacionit, mirëmbajtjes, do të kërkojë një zyrë të përhershme Programi për bashkërendim dhe menaxhimin e buxhetit. Për shkakun se do të jetë një sistem ndërministror, organizmi që do të luajë rolin e zyrës së programit, do të kërkojë mbikëqyrje dhe udhëzim nga këshilli ku janë të përfaqësuar të interesuarit kyç dhe që kryesohet nga një ministri/agjenci e specializuar si buxhetuese për sistemin.

Menaxhimi i ciklit të jetës do të kërkojë legjislacion të veçantë (si ai për menaxhimin e krizave dhe mbrojtjen e popullsisë), Plan/Program Kombëtar për **112 ECS**, sistem të zhvilluar të protokolleve dypalëshe dhe shumëpalëshe midis palëve të interesuara dhe në të ardhmen operatorë 112 në vende të tjera (për telefonat celularë dhe ata **VoIP**, si teknologji të tjera që po shfaqen).

Cikli i jetës i **112-ECS** duhet të sinkronizohet me ciklet e jetës së dy sistemeve të lidhura me të - **IEMS** (rrjeti i qendrave

të Operacioneve të Urgjencave /**EOC**/ me qendrat e lëvizshme përkatëse, Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm /**EW**/ dhe Njoftimit – nën autoritetin e ministrisë/agjencisë përgjegjëse për menaxhimin e urgjencave) dhe sistemi i menaxhimit të Krizave/Periudhës së Luftës (nën autoritetin e Ministrisë së Mbrojtjes).

Përvoja e WCI në Bullgari dhe Evropën Qendrore.

Bullgaria filloi ndryshimet në sistemin e menaxhimit të urgjencave në vitin 1989. Hapi i parë më i dukshëm ishte formimi i Agjencisë Shtetërore të “Mbrojtjes Civile”, e cila pas disa vitesh në qeverisjen e tanishme u integrua në Ministrinë e re të Politikave Shtetërore për Katastrofat dhe Aksidentet. Sigurisht që ky vendim ishte politik, por ishte i “parashikuar” si rezultat i një studimi të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë⁴ – po ai i cili nisi Studimin e Realizueshmërisë në Bullgari të Sistemit të Integruar për Menaxhimin e Urgjencave (**IEMS**), i financuar nga Marrëveshja e Grantit të Agjencisë të Shteteve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (USTDA) me Ministrinë e Politikave Shtetërore për Katastrofat dhe Aksidentet (**MoSPDA**) dhe zbatuar nga Winbourne & Costas Inc., në vitin 2006. Objektivi ishte të mbështesë zhvillimin e mjedisit të komunikimeve **IEMS** dhe 112 të urgjencave që mund të përmbushin në mënyrë efektive qëllimet operationale të **MoSPDA** operational goals dhe kërkesave të kërcënimeve. Qasja fokusohej mbi objektivat e mëposhtme të **MoSPDA**:


- Themelimi i arkitekturës kombëtare për **IEMS**
- Përmirësimi i aftësive komunikuese midis Ministrive dhe respondentëve të parë, për të ofruar “kudo-kurdoherë” zë ndërveprues dhe komunikim të dhënash
- Themelimi i një rrjeti të Qendrave Rajonale të Operacioneve të Urgjencave (**REOC**) të integruar me

⁴ Velizar Shalamanov, Stefan Hadjitodorov, Todor tagarev, Stoyan Avramov, Valentin Stoyanov, Pencho Geneshky, Nikolay Pavlov, “Civil Security: Architectural Approach in Emergency Management Transformation”, “Information and Security” International Journal, Vol. 17, 2005, pp. 75-104.

një Qendër Kombëtare të Operacioneve të Urgjencave (**NEOC**) në Sofje

- Ndërthurja e **REOC**-ve me qendrat e lëvizshme të komandimit për të ofruar komandim në vendngjarje, kontroll dhe komunikime nëpër rajonet
- Lehtësimi i mundësive komanduese dhe kontrolluese në secilën prej roleve të Menaxhimit Rajonal dhe Kombëtar të Urgjencave (**EOC**)
- Lidhja e **REOC**-ve me qendrat e komunikimit dhe dërgimit 112, duke i ofruar publikut mbrojtje të policisë, zjarrfikësve, shërbimeve mjekësore të urgjencës dhe mbrojtje civile, në mënyrë që t'i ofrohen **EOC**-ve të dhëna të dërguara me kompjuter (**CAD**)
- Themelimi i qendrës kombëtare të trajnimit dhe simulimit si një qendër/laborator të zhvillimit të sistemit

National IEMS Architecture



E rëndësishme për strategjinë e projektit është zbatimi i një qendre kombëtare të komandimit dhe të gjashtë qendrave rajonale të komandimit, duke filluar me një projekt pilot në Plovdiv më 2007. Ky projekt pilot do të testojë këtë arkitekturë midis qendrës kombëtare të komandimit dhe Plovdivit, një nga rajonet e propozuara. Është e rëndësishme të shënohet se duke patur parasysh statusin e zhvillimit të politikave në Bullgari, vetëm përpjekjet për vendosjen e **EM** bashkërendohen nga qendra kombëtare e komandimit të urgjencave.

Veprimtaritë dhe përfundimet e pritshme nga ky projekt ndahen në dy faza zbatimi. Faza e parë përfshinte:

1. Zhvillimin e një Studimi Faciliteti për të Rekomanduar një Arkitekturë Kombëtare **IEMS**
2. Vlerësimin e Analizës së Tanishme Teknologjike të infrastrukturës së tanishme teknike të **IEMS**
3. Rekomandimin e Arkitekturës Kombëtare të Komunikimeve **IEMS**
4. Rekomandimin e Planit Kombëtar të Zbatimit të **IEMS**
5. Përgatitjen e Buxhetit të Parashikuar për Zbatimin
6. Përgatitjen e Specifikimeve Teknike për Dokumentet e Ofertës
7. Përgatitjen e draftit të Termave të Referencës për Projektin Pilot të Plovdivit
8. Dorëzimin e Raportit Përfundimtar

Metoda e zbatuar në Fazën I u bazua mbi:

1. Takime dhe mbledhje të dhënash nga palët e interesuara të Ministrive, Agjencive Shtetërore dhe Komisioneve, ku përfshiheshin:
 - a. Ministria e Politikave Shtetërore për Katastrofa dhe Aksidente
 - b. Ministria e Brendshme
 - c. Ministria e Shëndetësisë
 - d. Agjencia Shtetërore për Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimet
 - e. Komisioni Rregullues i Komunikimeve
 - f. Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe e Punëve Publike
 - g. Ministria e Mjedisit dhe Ujërave
 - h. Zyra e Gubernatorit të Plovdivit
 - i. Ministria e Financave
 - j. Ministria e Administratës Shtetërore
2. Ndjekjen e stërvitjes EU TACOM SEE, 2006
3. Mbajtjen e Seminarit të Shitësve në korrik 2006
4. Prezantimin e Konkluzioneve Paraprake në shtator 2006
5. Mbajtjen e Demonstrimit Teknologjik në Plovdiv në tetor 2006

Në vitin 2007 një Amendament u firmos për Studimin e Realizueshmërisë së Sistemit të Thirrjeve të Urgjencave 112, që kishte të bënte me detyrat e mëposhtme:

Kryerja e një Studimi Fillestar të të Dhënave, Përgatitja e një Plani Pune dhe Vlerësimi i Teknologjive të Komunikimit të Urgjencave të lidhura me shërbimin 112, përfshirë telekomunikimet, regjistrimet dhe përcjelljen, dërgimet e thirrjeve me anë të kompjuterit (CAD), komunikimet me radio dhe sistemet e lidhura me këto.

- **Përgatitja e Analizës Teknike** dhe e raportit paraprak që paraqet konkluzionet e infrastrukturës ekzistuese kombëtare dhe në rajonin e Plovdivit dhe e fushave të mundshme për zgjerimin e tyre.
- **Kryerja e Inspektimit Rregullues dhe Mjedisor** dhe vlerësimi i zbatueshmërisë së arkitekturës së propozuar në udhëzimet e shpallura në ligjin e ri bullgar dhe rregulloret e BE-së në lidhje me shërbimin 112, si edhe identifikimi i ligjeve dhe rregulloreve që duhet të modifikohen për të lejuar zbatimin e efektshëm vendor dhe kombëtar.
- **Zhvillimi i një Plani Konceptual** për të adresuar ndryshimet ose zgjerimet e politikave, procedurave dhe teknologjive që ndikojnë arkitekturën teknike.
- **Themelimi i një Protokollit Kombëtar të Operacioneve** midis MoSPDA, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë për të krijuar procedura të reja të marrjes së thirrjes për të proceduar thirrjet për zjarrfikësit, policinë, urgjencën mjekësore dhe mbrojtjen civile, në qendrat e thirrjes 112 dhe Zhvillimi i një Memorandumi të Mirëkuptimit midis ministrive të interesuara për menaxhimin e REOC-ve qendrave të thirrjeve 112.
- **Përgatitja e një Analize Buxhetore** të bazuar mbi planet e miratuara konceptuale kombëtare dhe të Plovdivit. Kjo punë do të përfshijë opsionet për (1) financimin me anë të buxhetit bullgar dhe (2) identifikimin e burimeve financiare ndërkombëtare, si p.sh. Banka Eksport- Import e SHBA-së, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Korporata e SHBA-së për Investimet Private në Vendet e Huaja (OPIC), Banka Evropiane e Investimeve, BE, organizata të tjera të zhvillimit dhe burime private.

- **Përgatitja e Planit të Zbatimit** për një projekt pilot në Qarkun e Plovdivit që dëshmon integrimin konceptual të komunikimeve të urgjencave 112 me planin **IEMS** dhe arkitekturën 112 të propozuar.
- **Përgatitja e Specifikimeve Teknike** të bazuara në planin final pilot të zbatimit për përdorim në procesin e ofertës në përbërësit e ndryshëm të komunikimeve dhe teknologjive të urgjencës.
- **Përgatitja e Raportit Përfundimtar** në formatin që kërkohet në pajtim me Klauzolën 1 të Aneksit II të Marrëveshjes së Grantit, që gjithashtu përfshin një Term Reference specifik për Projektin Pilot **112-IEMS** të Plovdivit, bazuar mbi kriteret për një grant nga Agjencia e SHBA-së për Tregti dhe Zhvillim.

Faza e dytë e tërë projektit lidhet me ndihmën teknike për Qendrën Pilot të Operacioneve të Urgjencave në Plovdiv me Qendrën e Trajnimit/Zhvillimit të Sistemit në Sofje. Agjencia bashkërenduese e projektit është Ministria e Politikave Shtetërore për Katastrofa dhe Aksidente (**MoSPDA**), që është edhe përfituesja kryesore e projektit. Nga ana amerikane agjencia bashkërenduese është Agjencia e SHBA-së për Tregti dhe Zhvillim (**USTDA**) dhe të dyja kontraktuan për zbatimin e projektit Winbourne & Costas Inc.

Faza I është zbatuar plotësisht dhe amendimi i sistemit të thirrjeve urgjente 112 është në proces. Po zhvillohet përgatitja për Fazën II. Ky projekt është sinkronizuar me projektet e **MoSPDA** për sistemet e paralajmërimit të hershëm, qendrat e thirrjeve 112, dhe projekte që kanë të bëjnë me rritjen e kapacitetit dhe trajnime në administratën publike.

Paralel me Fazën II të projektit Bullgar **WCI** nën kontratën me **USTDA** të nisur nga qytetet e Varshavës dhe Gdanskut po punon për hartimin dhe zbatimin e **EOC** për zonën Gdansk-Gdinja-Sopot si edhe **EOC** rezervë në Varshavë. Negociatat janë në proces për zbatimin e **EOC** në Pardubice dhe Hradec Kralov në Çeki si edhe studimi i realizueshmërisë së **IEMS** në Rumani.

Përfundim: Dimensioni 112-IEMS i Integritit të Ballkanit Perëndimor në NATO dhe BE. Ndërsa fokusi për rajonin është infrastruktura - çështja e mbrojtjes së infrastrukturës kritike si disiplinë e menaxhimit të urgjencave (vazhdim i menaxhimit të sipërmarrjes, menaxhimit të sigurisë së informacionit, menaxhim i sigurisë së përgjithshme) është e rëndësishme të veçantë dhe kërkon bashkëpunim rajonal ndërkufitar midis vendeve me afilim të ndryshëm - NATO, BE, SEECL, BSEC, etj. Një rast i veçantë është infrastruktura rreth naftës-jellësit AMBO nga Burgas (Bullgari) deri në Vlorë (Shqipëri) që kërkon sistem të integruar të menaxhimit të urgjencave.

Risqet dhe kërcënimet e përbashkëta të lidhura me tërmetet, zjarret në pyje, përmytjet, aksidentet teknologjike dhe madje veprimet terroriste kërkojnë sistem të njëzuar të menaxhimit të urgjencave në Ballkanin Perëndimor dhe për shkak se rajoni është i rrethuar nga vendet e BE-së, do të thotë që ai duhet të ketë një sistem të njëzuar kompatibël me BE-në. Në të njëjtën kohë, projekti AMBO, forcat e SHBA-së në Bullgari dhe pjesa më e madhe e mbështetjes së SHBA-së për rajonin (përfshirë bashkëpunimin e Kartës së Adriatikut) ofron mundësi për të zbatuar një projekt me rezonancë amerikane me transferim të teknologjisë prej **911 / EMS** më të avancuara.

IEMS i përmirësuar dhe veçanërisht **112 ECS** efektiv janë hapa natyrorë në integrimin në BE të çdo vendi. Përvoja në Bullgari e ndërthurjes së projekteve të NATO-s, BE-së dhe SHBA-së me përpjekjet kombëtare për të themeluar **IEMS** dhe për të zhvilluar **112 ECS** moderne është një shembull që mund të ndiqet nga shumë vende të tjera të Ballkanit Perëndimor dhe të zonës së Detit të Zi.

Përveç dimensionit të sigurisë, **112-IEMS** konsiderohet si një shtytës teknologjik. Ajo është një mjet për integrimin e Ministrive të Brendshme, Mbrojtjes, Shëndetësisë, Administratës Qendrore dhe Vendore, bazuar mbi teknologjitë e reja të informacionit, si CAD, GIS, GPS, DB, DSS, komunikimet ndëroperative në radio, rrjetin numerik të telefonit dhe të informacionit ANI/ALI, rrjetet e përmirësuara të telefonisë celulare.

Në Shqipëri qasja ndaj **IEMS / 112 ECS** mund të ketë një tjetër rezonancë krahasuar me Bullgarinë ose Evropën Qendrore – çka është e qartë – vendi ka nevojë për një sistem të tillë dhe SHBA mund të ofrojë mbështetje fillestare për projekte kombëtare në këtë fushë. Një tjetër çështje e dukshme është lidhja midis **IEMS / 112 ECS** efektive dhe anëtarësisë në NATO/BE, që është e një rëndësie të madhe për Ballkanin Perëndimor. Ekziston një mundësi e mirë për të filluar me studime mbi baza dypalëshe me SHBA-në prej prospekteve të ndryshme në mënyrë që të përkufizohen në Kuadrin e **PfP** (që do t'i jepte shansin e përfshirjes Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Serbisë, madje edhe Kosovës, mbi baza të pavarura si pjesë e misionit të NATO-s dhe më pas Kaukazit dhe Azisë Qendrore) si edhe si në planin afatgjatë të zbatimit të IEMS / 112 ECS në politikën e fqinjësisë së BE-së. Është e sigurt që Shqipëria, Bullgaria dhe Maqedonia janë testi më i mirë i mundshëm dhe mund të jenë kontribute të mira për sigurinë dhe mirëqenien e Ballkanit Perëndimor me përkrahjen e SHBA-së, NATO-s dhe BE-së.

*Jeffrey Winbourne është president i Winbourne & Costas Inc.,
kurse dr. Velizar Shalamanov është Këshilltar i Përgjithshëm në
Winbourne & Costas Inc., kryetar i Shoqatës "George C. Marshall"
të Bullgarisë dhe ish-zv/ministër i Mbrojtjes i Bullgarisë.*

Theodosis Georgiu
Matheu Vaikuisis

MUNDËSI REALE PËR INTEGRIMIN NË NATO PËR SHQIPËRINË DHE PËR VENDE TË TJERA TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Ka patur dy modele që kërkonin të shpjegonin situatën në rajonin e Ballkanit qysh prej fillimit të shekullit të mëparshëm. Modeli i parë i përmbahet idesë se vendet e Ballkanit janë të destinuara drejt një lufte përherë prezente. Në mbarim të shekullit të kaluar në mënyrë të veçantë pesëmbëdhjetë vitet e fundit ka patur shenja të dukshme në favor të këtij argumenti. Modeli i dytë është i fokusuar në periudhën e tranzicionit pas Luftës së Ftohtë ku të dhënat tregojnë dinamizëm të fuqishëm nga ana e shteteve të rajonit për të përforcuar lidhjet shumëpalëshe. Duke u mbështetur në këtë pikëpamje, vendet e Evropës Juglindore kanë mundësi të kapërcejnë këto rivalitete dhe probleme, duke marrë parasysht që aspirata e tyre kryesore është integrimi i tyre në strukturat evro-atlantike.

Integrimi në kontekstin evro-atlantik për vendet e Ballkanit Perëndimor është me rëndësi të madhe për stabilitetin, bashkëpunimin, zhvillimin politik dhe ekonomik, shkatërrimin e krimit dhe të terrorizmit, transparencën politike dhe progresin e përgjithshëm të rajonit. Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Kroacia, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM), Serbia, Mali i Zi, të gjitha kërkojnë reforma, ndryshime dhe zhvillime të domosdoshme për të zvogëluar distancën ndërmjet tyre dhe fqinjëve evropianë me qëllim që të bëhen anëtarë të strukturave evro-atlantike dhe të përfitojnë prej tyre. Teza e NATO-s për mundësitë reale të integritit të vendeve të Ballkanit Perëndimor ka qenë gjithmonë pozitive dhe mbështetëse, megjithëse dhe në situata kritike. Kërkesat janë të larta, por përfitimet janë të tilla. Ashtu si vuri në dukje

dhe zv/ministri grek i Punëve të Jashtme, z. Y. Valinakis në Asamblenë e Përgjithshme Nr. 52 të Shoqatës së Paktit të Atlantikut në Athinë në dhjetor 2006: “Është e një rëndësie të madhe të mbajmë dyert e Aleancës të hapura në një kohë kur puna e madhe dhe e lodhshme e zgjerimit në Evropë duket se është në rritje dhe dera e BE-së mund të jetë në rrezik mbylljeje”. Politika e NATO-s për zgjerimin ka shërbyer për të hedhur në baza solide stabilitetin dhe sigurinë. Perspektiva evro-atlantike e vendeve të Ballkanit është provuar se vepron si një katalizator për pozicionimin e pranueshëm të përbashkët të çështjeve rajonale. Rruga për anëtarësim ka qenë forca shtytëse për demokraci, marrëdhënie të mira të fqinjësisë dhe për reforma në secilin vend të Ballkanit Perëndimor. Kjo dinamikë për nivel performance do të reduktojë efektet destabilizuese në Ballkan dhe do të minimizojë radikalizmin. Ne e kemi lavdëruar progresin e arritur deri në këtë pikë nga tre vende të Planit të Veprimit për Anëtarësim (Shqipëria, Kroacia, IRJM) në përmbushjen e objektivave politike dhe ushtarake të NATO-s. Ne gjithashtu i kemi inkurajuar ato për të vazhduar përpjekjet që po bëjnë për t’u zgjedhur për anëtarësim dhe kemi shprehur qëllimin për të zgjeruar në Samitin e ardhshëm për ftesa të tjera në 2008. Në të njëjtën kohë i kemi shprehur aspiruesve që çfarëdolloj zgjerimi i Aleancës mbetet i bazuar mbi performancën në kriteret kyçe, si zhvillimi i institucioneve demokratike, kontrolli demokratik mbi forcat e armatosura, respekti për liritë themelore dhe të drejtat njerëzore, promovimi i marrëdhënieve të mira të fqinjësisë, etj.

Përputhja e plotë e kriterëve të përmendura më sipër është parësore në renditje për opinionin tonë publik dhe për parlamentet tanë (të cilët do të thirren për të ratifikuar Traktatin e Pranimit), që të jenë të bindur për nevojën dhe për vlerën që shtohet për secilin zgjerim.

Marrëdhëniet e NATO-s me Shqipërinë janë zgjeruar dhe thelluar në vitet e fundit. Një arsye ka qenë interesi i Aleancës që të punojë me Shqipërinë për të ndihmuar për të stabilizuar rajonin e trazuar të Ballkanit. Po kaq të barabarta në forcimin e marrëdhënieve kanë qenë përpjekjet e fuqishme të bëra nga Shqipëria për të bashkëpunuar, për të ardhur më afër dhe në

fund, për t'u bashkuar me Aleancën. Është pikërisht në këto dy dimensione të marrëdhënieve që bëhen gjithmonë e më të afërta, mbi të cilat ne dëshirojmë të fokusohemi. Ne mendojmë se në përgjithësi, pavarësisht nga disa probleme të mbetura të varura dhe disa rasteve serioze të tërheqjeve pas, ne po shikojmë progres të rëndësishëm në drejtimin e duhur.

Ne po shikojmë shembuj shumë të qartë të ndryshimit pozitiv në të gjithë Evropën Juglindore. Megjithatë, në të njëjtën kohë, është evidente që ka shumë punë për t'u bërë. Sigurisht që kjo është mbi të gjitha përgjegjësi për vetë vendet e rajonit për qeveritë e çdonjërit vend, të cilave u kërkohet të implementojnë reforma të brendshme dhe të punojnë së bashku me vendet e tjera fqinje. Po kaq evidente është që komuniteti ndërkombëtar duhet me çdo kusht të inkurajojë dhe të mbështesë përpjekje të tilla dhe të ndihmojë të krijojë një ambient të favorshëm për ata, për të qenë të suksesshëm.

Shqipëria ka qenë e prirur të luajë rolin e saj në rrjetin e sigurisë dhe ka përdorur shanset e dhëna të ofruara nga Partneriteti për paqe (PfP) dhe Këshilli i Atlantikut për Partneritet (EAPC) në ecjen përpara të interesit të vet të sigurisë. Por ajo gjithashtu ka qenë e prirur të japë një kontribut aktiv për sigurinë në Evropë ku ka mundësi të bëjë një gjë të tillë, si për shembull në SFOR dhe në KFOR duke mbështetur veprimtari nën iniciativat e NATO-s në Evropën Juglindore dhe sigurisht duke vepruar si vend pritës për zonën komunikuese të KFOR-it (perëndim), një pjesë vitale e mbështetjes logjistike për KFOR-in.

Aleatët pa dyshim janë të vetëdijshëm se përfitimi i anëtarësimit në NATO është objektivi strategjik i qeverisë shqiptare, një objektivi i mbështetur nga të gjitha partitë politike të vendit dhe pjesa mbizotëruese e popullsisë. NATO-ja do që të ndihmojë Shqipërinë sa më tepër të jetë e mundur. Në të vërtetë në vitet e fundit në kontekstin e PfP-së dhe së fundmi në Planin e Veprimit për Anëtarësim, NATO-ja ka bërë përpjekje të konsiderueshme të ndihmojë Shqipërinë në përballimin e disa sfidave të vështira që ajo ka përpara.

Ne duam të vëmë në dukje tre nga këto sfida. E para është reforma ekonomike. Është një fushë ku NATO-ja mund të

japë kontribut të kufizuar. Në mënyrë absolute është një fushë e rëndësisë së lartë për përfitimin nga puna me NATO-n dhe që të bashkohesh përfundimisht me atë. Ka shumë për të bërë në këtë drejtim. Megjithatë, aleatët janë të kënaqur kur shikojnë se themelet për funksionimin e ekonomisë së tregut janë pozicionuar në vendin e duhur dhe se Shqipëria ka arritur disa rezultate pozitive në stabilizimin makro-ekonomik, të tilla si rritja e prodhimit dhe kufizimi i inflacionit, edhe pse me probleme të vazhdueshme serioze buxhetore.

E lidhur ngushtë me reformën ekonomike është nevoja kritike për të filluar seriozisht me luftën kundër krimit dhe korrupsionit. NATO-ja e vlerëson këmbënguljen e madhe të treguar nga qeveria shqiptare. Një numër iniciativash tepër inkurajuese janë ndërmarrë, por ajo që është më e rëndësishmja në fund është implementimi i suksesshëm. Aleanca ka mundur të japë kontributin në këtë fushë së bashku me autoritetet shqiptare, duke riparë strategjinë e tyre të përgjithshme në sigurinë e kufijve dhe kontrollin e tyre.

Fusha e tretë, atje ku aleanca me sa duket ka shumë për të ofruar, është reforma në fushën e mbrojtjes. Gjatë viteve të fundit NATO-ja ka punuar nga afër dhe me shumë sukses me autoritetet përkatëse shqiptare në aspekte të ndryshme të kësaj sfide tej mase madhore. Një progres për t'u përshëndetur është bërë tashmë në drejtim të vendosjes së një komande të re dhe strukturës së forcës, përmirësim në kushtet e jetës së ushtarakëve, shkollim dhe trajnim më i mirë për ata dhe ndëroperativitet në rritje me forcat e NATO-s. NATO-ja ka tendencë të vazhdojë të punojë me Shqipërinë për këto dhe të tjera prioritete.

Por në fund të fundit është implementimi i reformave të mbrojtjes që do të merret për vlerësim. Shumica e gjërave do të varen nga vlefshmëria e burimeve të mjaftueshme. Megjithëse është e qartë që në rastin e Shqipërisë, jo vetëm reforma e mbrojtjes, por gjithashtu edhe reforma të tjera kritike, dhe në fakt transformimi i gjithë shoqërisë, janë të gjitha të varura nga sukcesi i procesit të reformave ekonomike të Shqipërisë.

Kriteret mund të arrihen me promovimin e bashkëpunimit rajonal, sepse kjo hap derën e stabilitetit dhe prosperitetit

rajonat dhe vepron si një mjet shtytës për t'u përjasur dhe në planin afatgjatë për ndërthurjen e vendeve të rajonit në institucionet evro-atlantike.

Iniciativat kryesore të bashkëpunimit rajonal ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore janë:

- 1- Iniciativa e bashkëpunimit të vendeve të Evropës Juglindore
- 2- Procesi i bashkëpunimit të vendeve të Evropës Juglindore.
- 3- Pakti i stabilitetit për Evropën Juglindore
- 4- Iniciativa adriatiko-joniane

Format e iniciativës rajonale që janë vënë në veprim në rajon duke kombinuar me Paktin e Stabilitetit, veprojnë në favor të intensifikimit të kohezionit rajonal.

Shqipëria zë vend si një partner i rëndësishëm për Greqinë në rajon dhe marrëdhëniet e dy vendeve janë të karakterizuara nga bashkëpunimi i ngushtë në shumë sektorë.

Greqia mbështet fuqishëm përpjekjet e Shqipërisë për integrimin në BE dhe NATO dhe për këtë arsye ndihmon ku është e mundur në reformat e nevojshme me qëllim që të procedohet për realizimin e këtij objekti. Firmosja e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (12.06.2006) përbën kornizën më praktike për të konkretizuar reformat dhe një përjasje thelbësore pranë institucioneve evro-atlantike.

Me nocionin se afrimi i shteteve të Ballkanit në familjen evro-atlantike minimizon rrezikun e krijimit të “mungesës së sigurisë” dhe dhunës ndëretnike në rajon, Greqia mbështeti fuqishëm nga 29.03.2004 integrimin e Bullgarisë dhe të Rumanisë në NATO (kështu ka bërë dhe më parë me integrimin e Hungarisë, Polonisë, Republikës Çeke, Sllovakisë, Sllovenisë dhe shteteve baltike). Ajo inkurajon gjithashtu Kroacinë, Shqipërinë dhe IRJM për të përshpejtuar reformat politike dhe ato të mbrojtjes me qëllim që ato të përmbushin kriteret që janë parashtruar për integrimin e shpejtë në aleancë.

Në bazë të pikëpamjeve të Greqisë, zgjerimi i NATO-s në Ballkan do të krijojë mundësi të lidhjeve direkte gjeografike të Greqisë me hapësirën evro-atlantike për herë të parë qysh prej integrimin të saj në NATO dhe në BE. Integrimi i

ardhshëm i pjesës tjetër të vendeve të Ballkanit në BE dhe në NATO zgjeron dhe forcon perimetrin e zonës së stabilitetit në rajon. Është e natyrshme që këto vende tani të bëhen më tërheqëse për investime direkte dhe të japin kontributin e tyre në përmirësimin e infrastrukturës rajonale (transporti, energjia) dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës.

Rruga për në BE kalon përmes përshtatjes me moralin dhe vlerat që në mënyrë universale pranohen nga familja evropiane, e cila përbën themelet e demokracisë evropiane, shtetin e së drejtës, respektin për të drejtat njerëzore të minoriteteve, respekt për të drejtat internacionale, mosshkeljen e kufijve ndërkombëtarë, zgjidhjen paqësore të konflikteve dhe bashkëpunimin rajonal.

OJF-të mund të luajnë një rol katalizatori në mënyrë të veçantë në vënien në jetë të programeve që shqetësojnë brezat më të rinj. Kontributi i qytetarëve mund të provohet për të qenë një mjet i suksesshëm me qëllim afrimin për bashkëjetesë. Greqia ka ndërmarrë iniciativa të suksesshme për bashkëjetesë, demokraci dhe për të drejtat e njeriut gjatë kohës së presidencës në BE. Në të njëjtin dimension Shoqata Greke Për Bashkëpunim Evro-Atlantik vazhdon përpjekjet dhe bashkëpunimin e saj me OJF-në shqiptare ekuivalente, që është Këshilli Shqiptar i Atlantikut (KSHA), për të promovuar integrimin e Shqipërisë në NATO. Bashkëpunimi ynë me presidentin e KSHA, z. Arian Starova si dhe me presidentin e mëparshëm, Shkëlqesinë e Tij Presidentin e Shqipërisë, z. Alfred Moisiu, ka dhënë prova për një rol dinamik të OJF-ve në këto procese.

Një pamje e aleancës së NATO-s, e përkushtuar fuqishëm për rivendosjen e paqes dhe stabilitetit në këtë pjesë kritike të Evropës, këmbëngulëse për të ndihmuar Evropën Juglindore, e lë si hije nga pas Ballkanin e së shkuarës dhe përqafton të ardhmen e saj evropiane.

Shqipëria është pjesë integrale e këtij objekti. Është një vend që ka qenë i prirur fort për të marrë vendin e duhur si një komb evropian. Duke angazhuar forca në operacionet e drejtuar nga NATO-ja në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë dhe duke ofruar mbështetje politike për qëllime të komunitetit

ndërkombëtar, koha më e afërt është përballja me krizën në IRJM. Shqipëria ka treguar se ajo nuk do që të jetë vetëm konsumatore e sigurisë, por në të vërtetë një furnizuese e saj.

Partneriteti aktiv dhe më tej anëtarësimi në Aleancë janë konsideruar gjithmonë si prioritete të politikës së jashtme të qeverisë shqiptare gjatë viteve '90 e më pas. Integrimi në NATO është konsideruar nga Shqipëria jo thjesht si një mjet për të përmirësuar çështje të sigurisë sot, por si një investim i rëndësishëm afatgjatë që përfundimisht do të sjellë shoqërinë shqiptare drejt proceseve të integrimit evro-atlantik.

Partitë politike të Shqipërisë e kanë parasysh se anëtarësimi i Shqipërisë në NATO do të përfaqësojë një zgjerim natyral në krahun e saj juglindor. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë është i favorshëm për implementimin e konceptit të ri strategjik të NATO-s për t'u aprovuar në Samitin e Uashingtonit. Vendosja gjeografike e Shqipërisë do të krijonte gjithashtu për Aleancën një mundësi për një kontroll të plotë mbi aksesibilitetin përgjatë gjithë Adriatikut dhe në të dy anët e kanalit të Otrantos. Shqipëria e ka plotësuar ciklin e mëparshëm të Planit të Veprimit të Anëtarësimit dhe po përgatit veten për tjetrin. Si kanë cituar dhe ekspertë të tjerë të NATO-s, Shqipëria është në rrugën e arritjes së një progresi të dukshëm në fusha të ndryshme të procesit të Planit të Veprimit për Anëtarësim.

Tentativat e Shqipërisë në përpjekje të përbashkëta për t'iu referuar sfidave të shekullit të ri janë të përfshirë në të gjithë aktivitetet e politikës së brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë dhe këto përmbledhin forcimin e institucioneve demokratike brenda vendit, reformën gjyqësore, luftën kundër korrupsionit, si dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimin e afërt rajonal me vendet e Evropës Juglindore në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikut ilegal të njerëzve, armëve dhe drogës dhe në sigurinë e kufijve, etj.

Ndërkohë që Aleanca e pozicionon veten drejt përballjes me kërcënime të reja dhe drejt marrjes përsipër të misioneve të reja më të vështira që kërkojnë mundësi të reja, roli i vendeve partnere do të jetë i rëndësishëm. Me një mbështetje shumë të fortë të opinionit publik dhe politik, Shqipëria do të vazhdojë

të japë kontributin e saj në veprimet e NATO-s dhe kështu vendi ecën përpara duke merituar anëtarësimin e plotë në Aleancë.

Theodosios Georgiu është Kryetar i Shoqatës Greke për Bashkëpunim Evropo-Atlantik (GAAEC) dhe Matheu Vaïkousis (Master në marrëdhënie ndërkombëtare) është praktikant pranë kësaj organizate.

Ivo Daalder & James Goldgeier

NATO-JA GLOBALE

Zgjatimi

Pa shumë bujë - dhe pa rënë në sy - NATO-ja po shndërrohet në një aleancë globale. E krijuar për të mbrojtur Evropën Perëndimore të pasluftës nga Bashkimi Sovjetik, aleanca tashmë po kërkon të sjellë stabilitet në pjesë të tjera të botës.¹

Gjatë këtij procesi, ajo është duke zgjeruar si shtrirjen e saj gjeografike, ashtu edhe diapazonin e operacioneve. Në vitet e fundit NATO-ja ka qenë paqeruajtëse në Afganistan, ka trajnuar forcat e sigurisë në Irak, dhe i ka dhënë mbështetje logjistike misionit të Bashkimit Afrikan në Darfur. Ajo i ndihmoi operacionit e shpëtimit pas cunamit në Indonezi dhe i ka dërguar furnizime viktimave të uraganit Katrina në SHBA dhe atyre të një tërmeti të rëndë në Pakistan.

Caku i zgjeruar i NATO-s ka ardhur si rezultat i politikave të reja globale që u shfaqën mbas Luftës së Ftohtë. Sot, terroristë të lindur në Rijad dhe të trajnuar në Kandahar kurdisin komplete vrasare në Hamburg për të goditur me avionë ndërtesat në Nju-Jork. Një ndërlidhje e tillë do të thotë që zhvillimet në një vend ndikojnë sigurinë, prosperitetin dhe mirëqenien e qytetarëve kudo. NATO-ja e ka pranuar tashmë që mënyra më e mirë (dhe ndonjëherë e vetmja) e mbrojtjes nga rreziqet e largëta është ndalimi i tyre aty ku e kanë burimin. Kjo mbrojtje e avancuar shpesh kërkon një shtrirje ushtarake globale: helikopterë për të dërguar ndihma dhe për të shpërngulur të plagosurit në zonat e fatkeqësisë natyrore,

¹ Varianti original i këtij artikulli: Ivo Daalder and James Goldgeier, "Global NATO", *Foreign Affairs*, 105, 2006 (shën. i red.).

kapacitete komanduese, kontrolluese dhe zbuluese për të mbështetur misionet paqeruajtëse dhe oficerë ushtarakë me përvojë për të trajnuar forcat lokale të sigurisë. Si organizata kryesore ushtarake ndërkombëtare, që përfshin shumë vende të zhvilluara të interesuara për të ruajtur qëndrueshmërinë globale, NATO-ja është e vetmja organizatë që plotëson këto kërkesa.

Në të njëjtën kohë, me forcat amerikane tejet të tendosura në Irak dhe me shtetet evropiane që nuk investojnë mjaftueshëm për të marrë pjesë në operacione larg vendeve të tyre, NATO-ja po stërmundohet edhe për të plotësuar angazhimet e saj aktuale. Ndërkohë që aleanca së fundmi po e pranon gjithnjë e më shumë domosdoshmërinë për të vepruar larg Evropës - ose, në mënyrën e të folurit të NATO-s, “jashtë zonës” - ajo ka qenë e kufizuar prej detyrimit që vendet anëtare të saj të jenë vetëm të Amerikës Veriore ose Evropa.

Udhëheqësit e NATO-s pritet ta diskutojnë këtë problem në Samitin e Rigës, Lituani, në nëntor 2006. Ata do të diskutojnë propozimin për ta ripërkufizuar rolin e aleancës duke thelluar marrëdhëniet me vendet përtej komunitetit transatlantik, duke filluar me partnerë si Australia, Japonia dhe Zelanda e Re. Një pikë kyçe në këtë përpjekje është propozimi i SHBA-së dhe Mbretërisë së Bashkuar për të formuar një “partneritet global” mes NATO-s dhe vendeve jo-evropiane që do të mundësojë një forum për një dialog të zgjeruar me shtete të tjera të rëndësishme demokratike.

Megjithëse kjo nismë është një hap i parë i mirë, ajo nuk shkon aq larg sa duhet. Lëvizja e radhës e NATO-s duhet të jetë hapja e anëtarësisë ndaj çdo vendi demokratik në botë që ka vullnetin dëshirën e mirë dhe që është në gjendje të kontribuojë në përmbushjen e përgjegjësisë të reja të NATO-s. Vetëm një aleancë vërtet globale mund t’u përgjigjet sfidave të sigurisë globale në ditët e sotme.

Vetëm për sytë e Evropës

Objektivi qendror strategjik i politikës së jashtme të SHBA-së gjatë shekullit XX ishte të parandalonte çdo fuqi të

dominonte Evropën. Kjo ishte dhe arsyeja pse Amerika ndërmoi dy luftëra botërore në kontinent dhe qëndroi e angazhuar gjatë gjithë Luftës së Ftohtë.

NATO-ja, e krijuar pikërisht më 1949, në kohën që komunistët kërcënonin sigurinë dhe stabilitetin në Evropë, ishte pjesë thelbësore i asaj përpjekjeje. Firmosja e paktit të Atlantikut të Veriut përfaqësonte edhe një angazhim direkt të SHBA-së për të ardhur në mbrojtje të Evropës, nëse Bashkimi Sovjetik do të sulmonte edhe një mënyrë për të bindur qeveritë e botës evropiane për t'i qëndruar përhapjes së ideologjisë komuniste në vendet e tyre. Fokusi evropian nënvizohet në Nenin 10, i cili i hapi dyert e anëtarësimit të ardhshëm vetëm për vendet evropiane dhe në Nenin 6, i cili e kufizoi shtrirjen gjeografike të aleancës vetëm në "territorin e çdonjërit prej anëtarëve në Evropë apo Amerikën e Veriut, në departamentet algjeriane të Francës, në territorin apo në ishujt nën juridiksionin e çdonjërit prej anëtarëve në zonën e Atlantikut të Veriut, që ndodhet në veri të Tropikut të Gaforres," dhe "në forcat, anijet dhe avionët" e shteteve anëtare që veprojnë brenda këtyre parametrave. Traktati formoi një komunitet saktësisht transatlantik, angazhimet e përbashkëta mbrojtëse nuk duhej të shtriheshin në asnjë nga zotërimet koloniale ose territoret e lidhura me shtetet anëtare, por që shtriheshin përtej zonës së Atlantikut të Veriut. Gjatë Luftës së Ftohtë, aleanca u zgjerua nga 12 në 16 anëtarë - me pranimin e Greqisë, Turqisë dhe Gjermanisë Perëndimore më 1950 dhe të Spanjës më 1982.

Rreth 40 vjet mbas themelimit të NATO-s, bie Perdja e Hekurt që e kishte ndarë Evropën dhe kontinenti filloi të ribashkohet. NATO-ja luajti një rol thelbësor gjatë këtij konsolidimi. Ajo pranoi në radhët e saj Gjermaninë e njësuar, ndihmoi në përfundimin e luftës brutale në Ballkan dhe ua hapi dyert ish-armiqve të saj të Traktatit të Varshavës. Numri i anëtarëve të aleancës u bë 19 kur Republika Çeke, Hungaria dhe Polonia u pranuan në vitin 1999 dhe pesë vjet më vonë u bë 26 me futjen e shtatë vendeve të reja demokratike nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Përmes zgjerimit të saj NATO-ja ndihmoi një Evropë historikisht të pjesëzuar që të bëhej një kontinent paqësor, i bashkuar dhe demokratik.

Misioni i përfunduar

Me shfaqjen e një Evrope të lirë e të bashkuar në vitet 1990, qëllimi strategjik i angazhimit të SHBA-së në Evropë u përmbush. Për këtë arsye SHBA-të e kaluan një pjesë të mirë të dhjetëvjeçarit duke u përpjekur të përkufizonin se si do ta përdornin fuqinë e tyre. Uashingtoni debatonte rolin e tij në parandalimin e konflikteve etnike dhe gjenocidit dhe pyeste veten nëse ushtria amerikane në të ardhmen do të përdorej kryesisht për ndërhyrje humanitare dhe për të stabilizuar gjendjet paskonfliktuale. Sulmet e 11 Shtatorit 2001, i vunë kapak të befte këtyre diskutimeve, natyra globale e sfidave me të cilat u përball SHBA-ja u bë shumë e qartë si për udhëheqësit ashtu edhe për publikun.

Ky realitet i ri shndërroi jo vetëm politikën e jashtme amerikane, por gjithashtu edhe rolin e aleancës më të suksesshme në histori. Më 12 shtator 2001, vendet anëtare të NATO-s ndërmorën hapin e paprecedent të evokimit të neneve të mbrojtjes kolektive të parashikuar në Traktatin e Atlantikut, sipas së cilave një sulm kundër një shteti anëtar të Aleancës do të konsiderohet si sulm ndaj të gjithë Aleancës. Në fillim, administrata e Bushit refuzoi çdo përfshirje direkt të NATO-s në operacionet ushtarake në Afganistan. Por më vonë ajo kuptoi që një përfshirje e tillë ishte e domosdoshme për të ndihmuar përballimin e sfidave të epokës globale, në veçanti sepse vendosja e trupave në Irak shkaktoi që Amerika të kishte më shumë nevojë për ndihmë për të siguruar dhe rindërtuar Afganistanin.

Në gusht 2003, **NATO-ja zyrtarisht përsipër Forcën Ndërkombëtare të Ndihmës** së Sigurisë (International Security Assistance Force-ISAF), e cila ka për detyrë të garantojë sigurinë në Afganistanin pastaleban. Megjithëse ISAF fillimisht veprroi në zonën relativisht të kryeqytetit dhe rrethinave, forca e ka shtrirë pa u ndalur fushën e veprimit dhe përgjegjësisë në të gjithë Afganistanin, përfshirë edhe zonat e rrezikshme në jug të vendit. Prania e NATO-s në vend është rritur, nga 5.000 trupa në fillim të operacioneve në 9.000 trupa sot dhe planifikohet për një zgjerim të mëtjetshëm deri në 15.000 trupa në fund të 2006-ës.

Komanda e NATO-s e operacionit në Afganistan nuk është aspak i vetmi shembull i përfshirjes jashtë Evropës. Me gjithë çarjet brenda aleancës në lidhje me luftën në Irak, forcat e NATO-s kanë trajnuar 1.500 oficerë ushtarakë dhe kanë bashkërenduar dërgimin e pajisjeve shumë të nevojshme forcave të sigurisë irakene. NATO-ja transportoi me avionë rreth 5.000 trupa të Bashkimit Afrikan (BA) në Darfur dhe ndihmoi në ndërrimin e forcave që ishin vendosur atje. Ka organizuar gjithashtu trajnime për oficerët e BA-së dhe ka kontribuar me ndihmë për bazën e misionit të BA-së në Adis Abeba, Etiopi. SHBA-ja dhe aleatët e saj evropianë “tashmë po shohin se e gjithë agjenda jonë po rrotullohet nga një fokus përbrenda në një fokus përjashta”, tha dhjetorin e kaluar [2005] Nicholas Burns, nënsekretari amerikan i shtetit për çështjet politike. “Marrëdhëniet SHBA-Evropë janë gjithmonë e më shumë një funksion i ngjarjeve në Lindjen e Mesme, Azi dhe Afrikë”.

Ndërsa hapësira gjeografike e shtrirjes së NATO-s është zgjeruar, po kështu ka ndodhur edhe me sferën e operacioneve të saj; aleanca tashmë merr përsipër detyra që nuk janë më të lidhura ngushtësisht me sigurinë dhe integritetin territorial, por që i përkasin stabilitetit ndërkombëtar në një plan më të gjerë. Vitin e kaluar, për shembull, NATO-ja shpërndau 3.500 ton furnizime të dhuruara nga vendet anëtare dhe të tjerë në rajonin e goditur nga tërmeti të Kashmirit dhe siguroi ndihma mjekësore e të tjera. Ajo gjithashtu iu përgjigj cunamit në Indonezi duke dhuruar materiale që u përdorën për ndërtimin e katër urave të reja dhe dërgoi ndihma për viktimat e uraganit Katrina në Shtetet e Bashkuara, si ushqime, pajisje për pastrimin e ujit, gjeneratorë dhe helikopterë.

Mundime në rritje

Duket qartë që NATO-ja po ndryshon. Por a po ndryshon mjaftueshëm? Nëse qëllimi i aleancës nuk është më mbrojtja territoriale, por afrimi me njëri-tjetrin i vendeve me vlera dhe interesa të ngjashme për të luftuar problemet globale, atëherë NATO-ja nuk ka më nevojë të ketë një tipar ekskluzivisht

transatlantike. Vende të tjera demokratike ndajnë vlerat e NATO-s dhe shumë interesa të përbashkëta - përfshirë Australinë, Brazilin, Japoninë, Indinë, Zelandën e Re, Afrikën e Jugut dhe Korenë e Jugut - dhe të gjitha ato mund të japin një kontribut të madh në përpjekjet e NATO-s, duke shtuar si forcat ushtarake ashtu edhe mbështetjen logjistike për t'iu përgjigjur kërcënimeve dhe nevojave globale. Operacionet e NATO-s në Ballkan dhe Afganistan kanë përfituar shumë prej ndihmesës së vendeve jo anëtare të NATO-s. Australia, Japonia dhe Korea e Jugut kanë dërguar një numër të konsiderueshëm trupash në Irak në mbështetje të përpjekjeve të NATO-s. Bashkë me shtete të tjera demokratike, jo anëtare të NATO-s, si Brazili, India dhe Afrika e Jugut, ato kanë kontribuar në mënyrë domethënëse në operacione paqeruajtëse anembanë globit.

NATO-ja ka filluar ta pranojë nevojën për të forcuar dhe zyrtarizuar marrëdhëniet e saj edhe me vendet përtej bashkësisë transatlantike. Udhëheqësit e NATO-s në takimin e ministrave të Jashtëm të aleancës në prill [2006] filluan diskutimin për mënyrën sesi mund t'i afrojnë vendet joanëtare. Sekretari-Gjeneral i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer deklaroi: “përderisa NATO-ja po zhvillon operacione në një distancë strategjike, kjo do të thotë që ka lindur gjithashtu nevoja për dialog edhe me vende të tjera të interesuara”. Ai sugjeroi që NATO-ja të bëhet “një aleancë me partnerë globalë”.

Këto thënie janë një shenjë e mirëpritur që NATO-ja e pohoi nevojën për t'u bërë globale. Por partnerët nuk janë njëlloj me aleatët dhe dialogu nuk është i njëjtë me planifikime, stërvitje, apo operacione shumëkombëshe. NATO-ja duhet t'i konsiderojë këto partneritete globale jo si objektiva finale, por si një hap i parë drejt anëtarësimit zyrtar. Aleanca adoptoi edhe më parë një strategji të ngjashme në mes të viteve 1990, në kohën që ajo filloi të punonte me ish-vendet e paktit të Varshavës përmes programit Partneritet për Paqe, i cili filloi duke i lejuar ushtritë e atyre vendeve të merrnin pjesë në ushtrime stërvitore dhe në disa operacione paqeruajtëse të përbashkëta me anëtarët e aleancës. **Megjithëse në fillim disa e panë këtë partneritet si një alternativë për anëtarësimin në**

NATO, ai shumë shpejt u shndërrua në një anëtarësimi në NATO. Partneriteti i ri global i NATO-s duhet të luajë një rol të ngjashëm duke e përgatitur aleancën për t'u shndërruar nga një organizatë me karakter ngushtësisht transatlantik në një organizatë globale. NATO-ja nuk ka nevojë të vendosë paraprakisht se cilat vende do të ftojë për t'u bashkuar në radhët e saj, ajo në fillim duhet të vendosë se në parim anëtarësia e saj është e hapur ndaj vendeve jo evropiane.

Anëtarësia në zgjerim e sipër është më e pëlqyeshme sesa koalicionet *ad hoc*. Një arsye është se ushtritë evropiane janë shpërndarë shumë nëpër misionet e shumta, si në Afganistan dhe Sudan, Kongo dhe pjesë të tjera të Afrikës. Ato do të përfitonin prej të pasurit aleatë më të shumtë dhe më të aftë për të ndarë kërkesën në rritje për fuqi ushtarake. Një arsye tjetër është se anëtarësimi zyrtar do ta forconte aftësinë e vendeve për të punuar së bashku në operacione ushtarake. Është pikërisht ndëroperacionaliteti i NATO-s - rezultati i planifikimit, trajnimit dhe luftimit së bashku - që i lejon anëtarëve të tij të ndërveprojnë pa fërkime dhe me efikasitet atëherë kur shpërthen ndonjë krizë. SHBA-të kanë një avantazh teknologjik ndaj aleatëve të tyre, por potenciali i trupave amerikane maksimalizohet kur ata janë në operacione me trupa të tjera me të cilat janë trajnuar rregullisht.

Në një NATO të zgjeruar, një gjeneral amerikan do të vazhdojë të shërbejë si një komandant suprem i forcave aleate dhe një tjetër joamerikan dhe, ndoshta në të ardhmen edhe joevropian, do të mund të mbajë vendin e sekretarit të përgjithshëm. Për të mundësuar zgjerimin e ardhshëm, NATO-ja duhet të marrë hapa ndërmjetëse, të ngjashme me ato që ka marrë përpara se të pranonte anëtarët e rinj nga Evropa Lindore. Kjo mund të përfshijë partneritetin global të propozuar; vendosja e ndërlidhësve zyrtarë ushtarakë midis shteteve partnere Shtabi i Përgjithshëm i Fuqive Aleate në Evropë në Mons, të Belgjikës dhe krijimi i Këshillit të Partneritetit Global të NATO-s, i cili do të ishte i ngjashëm me Këshillin e Partneritetit Evro-Atlantik, si një forum për të mundësuar dialogun e rregullt mes anëtarëve të NATO-s dhe 20 shteteve partnere nga Evropa dhe Azia Qendrore.

Për ta shndërruar NATO-n në organizatë globale, nuk është nevoja për të ndryshuar parametrat bazë të strukturës që i ka shërbyer më së miri aleatëve në gjithë këto vite. Por Traktatit të Atlantikut të Veriut i duhet bërë ndryshime, në veçanti Neni 10, i cili aktualisht e kufizon mundësinë për anëtarësime të reja në NATO vetëm për vendet evropiane. Në rrethanat e tanishme, një numër shtetesh me një përkushtim të dyshimtë për demokracinë dhe të drejtat e njeriut, si p.sh. Bjellorusia, përfshihen në Nenin 10, ndërkohë që demokraci të fuqishme, si Australia dhe Japonia, nuk janë. Por një përkushtim ndaj vlerave të përbashkëta duhet të jetë faktori më domethënës i anëtarësimit në NATO sesa gjeografia. Çdo vend me mendësi të njëjtë që synon qëllimet e NATO-s duhet të jetë në gjendje të aplikojë për anëtarësi në aleancë - ashtu si po bëjnë vendet e Evropës Qendrore dhe Lindorejugore që nga rënia e komunizmit.

Disa kanë frikë se një NATO e zgjeruar me një shtrirje të gjerë do ta ketë të vështirë të arrijë bashkëpëlqimin se kur dhe si të veprojë. Mund të ketë një të vërtetë në të, por vështirësia nuk duhet të ekzagjerohet. Shtimi i dhjetë vendeve të reja anëtare në dekadën e fundit nuk e ka prekur aftësinë e NATO-s për të vepruar, megjithëse skeptikët mendonin ndryshe. Një pjesë e arsyes pse zgjerimi nuk ka prodhuar pavendosmëri, është fakti që NATO-ja ka zhvilluar një proces vendimmarrës që lejon për arritjen e bashkëpëlqimit pa marrëveshje: në vend që të bllokojnë një vendim, anëtarët që nuk bien dakord mund t'i shtojnë një poshtëshënim atij ose të abstenojnë prej dhënies së kontributit në çdo lloj operacioni vijues. Praktika të tilla do të vazhdonin dhe do të zgjeroheshin nëse numri i vendeve anëtare të aleancës do të rritet dhe do të bëhej më global. Kërkimi për bashkëpëlqim mund të thellohet nëse vendet kryesore, duke filluar me SHBA-në, do të investojnë kohën dhe energjinë e nevojshme për të arritur një marrëveshje. Udhëheqësit duhet të përpiqen sërish për t'i bashkuar anëtarët në vend që të braktisin procesin dhe të vazhdojnë vetëm.

Kompetencat kryesore

Përveç ngritjes së pyetjeve mbi efikasitetin, ndryshimet në përbërjen dhe objektivat e NATO-s gjithashtu do të ngrenë pyetje mbi qëllimin thelbësor të aleancës. Ashtu sikurse ishte e vërtetë në kohën kur NATO u shtri në lindje në vitet 1990, aspekti më kundërthënës i çdo përpjekje për rritjen e numrit e anëtarëve të aleancës do të ishte mënyra sesi një zgjerim i tillë mund të ndikojë garancitë e sigurisë në Nenin 5 të Traktatit.

Disa nga anëtarët e tanishëm të NATO-s, në veçanti disa nga anëtarët më të rinj, mund të shqetësohen që një zgjerim gjeografik do të dobësojë angazhimet e përbashkëta mbrojtëse ekzistuese të aleancës. Gjithsesi, asnjë anëtar i NATO-s aktualisht nuk po përballet me një kërcënim ushtarak nga ndonjë vend tjetër, aq më pak ai lloj kërcënimi që çoi në formimin e NATO-s në vitin 1949. Në një skenar me shumë pak gjasa që një kërcënim i tillë të sendërtohet, asgjë te një NATO e zgjeruar nuk mund të dobësojë përkushtimin e mbrojtjes së përbashkët.

Parimi në Nenin 5, që një sulm ndaj njërit prej anëtarëve është një sulm ndaj të gjithëve, duhet të mbetet në thelb të aleancës. Për SHBA-në, kjo mund të mos përbëjë një çështje të rëndësishme, ndoshta më pak sesa orvatja për të mbrojtur Letoninë dhe Poloninë, vende që përpara se të hynin në NATO nuk mbuloheshin nga çadra amerikane e sigurisë. Në fund të fundit, zyrtarisht ose jo, SHBA-të tashmë garantojnë sigurinë e vendeve si Australia, Izraeli, Japonia, Zelande e Re, dhe Korea e Jugut. Por a do ta mund Spanja ose Estonia të ndërmarrin një angazhim të tillë, le të themi për Australinë apo Japoninë? Ndoshta jo, por ndoshta edhe po. Megjithëse Neni 5 e konsideron sulmin ndaj një vendi anëtar si një sulm ndaj gjithë vendeve të tjera, secili anëtar kërkohet vetëm të “ndërmarrë ato veprime të cilat ai i konsideron të domosdoshme” - një shtesë që mundëson efektivisht që përdorimi i forcës të mos jetë kurrë automatik. Në fakt, Neni 5 është evokuar vetëm një herë - mbas 11 Shtatorit - dhe vetëm një nga vendet anëtare të NATO-s mori pjesë në veprimin (i cili u udhëhoq nga

SHBA-ja në vend të komandës së NATO-s). Neni 5 është krijuar për t'u përdorur vetëm në rrethana të jashtëzakonshme - kur një aleat sulmohet ushtarakisht - dhe shpresohet se që çdo anëtar i NATO-s, pa marrë parasysh nëse është aleat zyrtar apo jozyrtar, do të vijë në ndihmë të vendit partner që ka pësuar sulmin. Në fund të fundit në gusht 1990 të gjitha vendet anëtare të NATO-s dhanë kontributin e tyre në koalicionin e madh që iu kundërvu pushtimit të Kuvajtit nga Iraku, një shtet që madje nuk ishte demokratik.

Një NATO e zgjeruar nuk do ta dobësonte OKB-në, apo BE-në, asnjë prej të cilave nuk e ka atë lloj kapaciteti ushtarak që ka NATO. Sepse NATO në thelb është një aleancë ushtarake - megjithëse ka një themel politik demokratik - edhe një aleancë e zgjeruar nuk mund të bëhej një OKB e dytë. Më shumë NATO-ja do të bëhej një ndihmëse më e aftë dhe legjitime e OKB-së që do ta ndihmonte për të zbatuar vendimet. Nëse, siç ndodhi në Kosovë më 1999, OKB-ja nuk dëshiron të autorizojë veprimin kundër një kërcënimi ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, gjithsesi NATO-s mund t'i duhet të veprojë. Në një rast të tillë, një NATO më globale, e mbështetur prej vendeve demokratike kryesore të botës, do të ketë një legjitimitet më të madh dhe duhet të qetësojë frikërat e atyre që janë duan një rend më të fuqishëm ndërkombëtar. Gjithashtu nuk ka arsye për t'u shqetësuar se zgjerimi i operacioneve dhe anëtarësisë së NATO-s do ta dobësojë angazhimin global në BE. Jo vetëm që BE-së i mungon kapaciteti ushtarak i nevojshëm për të vepruar larg prej Evropës, por edhe pjesa dërrmuese e punës së saj në rindërtimin dhe policimin paskonfliktual do ta plotësonte në vend që ta konkurronte NATO-n globale.

Krijimi i një NATO-je globale nuk bëhet për ta shpëtuar aleancën nga vjetërimi. Çështja nuk është se nëse NATO nuk del nga zona del nga puna. Çështja është sesi organizata ushtarake kryesore ndërkombëtare duhet të përshtatet me kërkesat e kohës, në mënyrë të atillë që të përparojë jo vetëm interesat e komunitetit transatlantik, por edhe të bashkësisë globale të demokracive, që janë të varuara nga qëndrueshmëria globale. Kërcënimet globale nuk mund të përballohen prej

organizatave rajonale. NATO-ja ka funksionuar mirë në të shkuarën pasi traktati themelues kërkon që vendet anëtare të përkushtohen si për parimet politike dhe ekonomike që përforcojnë demokracinë, si për sfidat e përbashkëta të sigurisë. Do të ishte një gabim i madh të mos pranoheshin brenda kësaj aleance vende të tjera që mund të marrin përsipër të njëjtin përkushtim dhe të ndihmojnë për përballimin e sfidave të reja globale.

Ivo Daadler është bashkëpunëtor i vjetër në Brookings Institution.

James Goldgeier është profesor i shkencave politike në Universitetin George Washington dhe ndihmësbashkëpunëtor i vjetër në Këshillin për Marrëdhënie të Jashtme.

Paul Savereux

ABC-JA E DIREKTIVËS GJITHËPËRFSHIRËSE POLITIKE

Midis fanfarës së Samitit të Rigës erdhi lajmi që kryetarët e shteteve dhe të qeverisë së NATO-s kanë miratuar një dokument të quajtur “Direktiva gjithëpërfshirëse politike” (DGJP) dhe kanë rënë dakord ta bëjnë publik.¹ Por çfarë është DGJP-ja? Si u bë e mundur ekzistenca e saj dhe, më e rëndësishmja, cilat janë pikat kyçe dhe domethënia e saj për Aleancën sot dhe në të ardhmen?²

Përmbledhje e DGJP-së

DGJP-ja është një dokument orientues i nivelit të lartë që siguron një kuadër dhe drejtim politik për shndërrimin e NATO-s, duke shpallur, për 10-15 vitet e ardhshme, prioritetet për të gjitha çështjet e mundshme të Aleancës, disiplinat planifikuese dhe informacionin. Me fjalë të tjera dokumenti paraqet vizionin e rënë dakord dhe prioritetet për transformimin e vazhdueshëm të NATO-s. Synimi themelor është që zbatimi i DGJP-së duhet të çojë në zhvillimin e më shumë potencialeve të përdorshme për operacione dhe misione të ardhshme dhe në këtë mënyrë të bëjë të mundur që Aleanca të mbetet e efektive, e besueshme dhe e përshtatshme për kushtet e shek. XXI.

Në thelb, DGJP-ja analizon të ardhmen e mundshme të mjedisit të sigurisë, por njeh mundësinë e ngjarjeve të

¹ Varianti original i këtij artikulli: Paul Savereux, “The Comprehensive Political Guidance: A Primer”, *NATO Review*, Spring 2007 (shën. i red.).

² Varianti i plotë i shqipëruar i “Direktivës Gjithëpërfshirëse Politike” është botuar në “Çështje të Sigurisë”, nr. 2, 2006 (shën. i red.).

paparashikuara. Përkundër kësaj analize, ajo shtjellon llojet e operacioneve që Aleanca duhet të jetë e aftë të përmbushë në të ardhmen, në kuadër të Konceptit Strategjik të vitit 1999 dhe, si rrjedhë llogjike e këtij vizioni, llojet e aftësive që do t'i nevojiten. Kjo është në vija të përgjithshme: sesi këto aftësi do të përmbushen është lënë e hapur, meqë u takon kombeve ta përcaktojnë individualisht dhe kolektivisht, nëpërmjet proceseve planifikuese të NATO-s.

Si erdhi në ekzistencë DGJP-ja?

Për të vlerësuar rëndësinë dhe domethënien e DGJP-së nevojitet të kuptohet konteksi që solli zhvillimin e saj, që do të thotë përpjekjet për të rishikuar procedurat planifikuese të mbrojtjes së NATO-s në periudhën e fundvitit 2003-fillim i 2004-ës. Qëllimi i planifikimit të mbrojtjes është të sigurojë kuadrin brenda të cilit të harmonizohen planifikimet kombëtare dhe ato të NATO-s, për të arritur në mënyrën më efektive kërkesat e rena dakord nga Aleanca. Në terma të thjeshtë, planifikimi i mbrojtjes kërkon sigurimin që NATO-ja do të ketë të gjitha forcat, asetet dhe aftësitë që nevojiten për përmbushjen e spektrit të plotë të misioneve të saj në të ardhmen.

Ndërsa qëllimi i saj është i drejtpërdrejtë, është provuar që zbatimi i planifikimit të mbrojtjes është një marrëveshje komplekse në vite dhe i kryer në radhë të parë nga shtatë disiplina "tradicionale" të planifikimit: armatimi, urgjenca civile, konsultimet, komanda dhe kontrolli, fuqia, logjistika, fuqia bërthamore dhe planifikimi i burimeve. Sidoqoftë, secila nga këto disiplina, ka qenë deri tani e menaxhuar nga komitete të ndryshme të NATO-s, është udhëhequr nga direktiva të ndryshme, ka kontribuar në qëllimin kryesor me mënyra të ndryshme dhe ka ndjekur procedura të ndryshme. Veç kësaj, disiplina/aktivitete të tjera - si inteligjenca, standardizimi, mbrojtja ajrore dhe planifikimi operacional - gjithashtu mbështesin planifikimin e mbrojtjes, duke e ndërlikuar edhe më shumë çështjen.

Garantimi që përpjekjet e kombinuara të gjithë këtyre aktorëve të jenë koherente dhe të harmonizuara është një sfidë

e konsiderueshme, veçanërisht kur nuk ka një organizëm të vetëm përgjegjës për të gjitha këto. Këshilli i Atlantikut të Veriut është përgjegjës për shumicën e këtyre, por fuqitë dhe planifikimi bërthamor si edhe disa aspekte të logjistikës dhe të planifikimit të burimeve janë kryer në emër të Komitetit të Planifikimit të Mbrojtjes ose Grupit të Planifikimit Bërthamor, të dyja që mbledhin 25 anëtarë (të gjithë anëtarët e NATO-s, me përjashtim të Francës, e cila nuk bën pjesë në strukturat ushtarake të integruara).

Përpyqje të mëparshme për përmirësimin dhe harmonizimin e procedurave planifikuese të mbrojtjes së NATO-s kanë pasur sukses të kufizuar, sepse përpjekjet kishin prirje të fokusoheshin në disiplina planifikuese individuale. Kështu, në Samitin e Stambollit në qershor 2004 dhe në një përpjekje për një qasje më holistike në kontekst të rishikimit të procedurave planifikuese të mbrojtjes, kishte një dëshirë që Kryetarët e Shteteve dhe të Qeverive të miratonin nivel ekzistues të ambicies të NATO-s dhe ta botonin. Besimi ishte që marrëveshja e nivelit të lartë do të ishte e dobishme duke i dhënë një qasje të njëjtë të gjithë Aleatëve, dhe duke mbledhur së bashku disiplinat e ndryshme planifikuese, drejt arritjes që qëllimit të njëjtë, dhe duke siguruar mbështetje financiare.

Ndërsa nuk kishte konsensus në lidhje me menaxhimin e nivelit ekzistues të ambicies, u vlerësuan avantazhet e zhvillimit të një qasjeje të përbashkët për të gjithë aleatët në të ardhmen. Duke njohur mundësinë e hedhjes së një hapi madhor përpara në Stamboll, Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive drejtuan Këshillin në një Seancë të Përhershme për të hartuar një udhëzues gjithëpërfshirës politik në mbështetje të Konceptit Strategjik për të gjithë disiplinat planifikuese dhe çështjet e aftësive të Aleancës.

Vetë DGJP-ja u miratua në dhjetor 2005 dhe qysh atëherë ka shërbyer si lëndë bazë për shumë punë të brendshme të NATO-s. Megjithatë, ajo u bë publike vetëm në nëntor 2006 në Samitin e Rigës, pasi Kryetarët e Shteteve dhe të Qeverive që e porositën hartimin e dokumentit, e miratuan atë.

Pikat Kryesore të DGJP-së

Pavarësisht se është koncize, DGJP-ja përmban gjëra substanciale dhe të vlefshme. Ndër të tjera, përfshihen masat e mëposhtme.

Së pari, DGJP-ja identifikon veçanërisht terrorizmin dhe shpërndarjen e armëve të shkatërrimit në masë, kërcënime të mundshme ndaj Aleancës në 10-15 vitet e ardhshme. Në të gjitha skenarët e mundshëm, Aleanca duhet të ruajë aftësinë për t'u përgjigjur në mënyrë efektive ndaj të gjithë spektrit të kërcënimeve, risqeve dhe sfidave të shek. XXI, ngado që mund të vijnë.

DGJP-ja gjithashtu nënvizon kërkesën që forcat e NATO-s të qëndrojnë të balancuara, fleksible dhe të zhdërvjellëta, dhe të jenë të afta të kryejnë gamën e plotë të misioneve të Aleancës, nga ato me intensitet të lartë deri në ato me intensitet të ulët. Ajo fokusohet veçanërisht mbi misionet që kanë më shumë gjasa për t'u kryer, ndërsa shënon nevojën për të qenë në gjendje për t'u përgjigjur atyre më të ngutshme.

DGJP-ja nënvizon mundësinë që NATO-ja do të ketë nevojë të zbatojë një numër operacionesh të ndryshme, të vogla, por që janë të ngutshme. Në këtë kontekst, ajo njih rëndësinë në rritje të operacioneve të stabilizimit dhe të mbështetjes ushtarake për përpjekjet e rindërtimit.

Ajo thekson nevojën për një qasje të gjerë ndaj sigurisë, jo vetëm në lidhje me instrumentet menaxhuese të krizave të NATO-s, por gjithashtu për përmirësimin e bashkëpunimit të saj me kombet, institucionet dhe organizatat jashtë NATO-s, që të bashkëpunojë në mënyrë më efikase në planifikimin dhe kryerjen e operacioneve.

Direktiva vendos një numër të kërkesave më të detajuara të aftësive që Aleatët, në mënyrë individuale dhe kolektive, kanë nevojë të adresojnë më tutje, si p.sh.:

- aftësia për të realizuar dhe mbështetur operacione larg bazës së tyre pak ose aspak mbështetje nga vendi ku veprojnë;
- aftësia për të përmbajtur, përçarë dhe mbrojtur kundër terrorizmit, dhe për të mbrojtur sistemet e informacionit të një rëndësie kritike për Aleancën kundër sulmeve

kibernetike;

- aftësia në identifikimin e elementeve armiqësorë, përfshirë edhe në mjedisin urban, që të kryhen operacione në atë mënyrë që minimizon dëmtimet anësore dhe riskun e trupave;
- aftësia për të siguruar trupa midis Aleatëve dhe partnerëve me ndëroperacionalitetin më të madh praktik dhe standardizim.

Kjo përcakton prioritetet kryesore të NATO-s ndërmjet këtyre kërkesave, duke filluar me forcat e ekspeditës së përbashkët dhe aftësisë për t'i pozicionuar dhe mbështetur ata.

Së fundmi, DGJP-ja shtron themelet e një mekanizmi menaxhues për të siguruar zbatimin e DGJP-së brenda aleancës. Mekanizmi, në fakt, ishte krijuar në shkurt 2006.

DGJP-ja si ndikon tek Aleanca?

E vendosur poshtë Konceptit Strategjik të vitit 1999, por sipër dokumenteve udhëzuese të lidhura me aftësitë, udhëzuesi ministror për planifikimin e forcës, DGJP-ja siguron deklaratë të vetme të udhëzimit që zbatohet në Aleancë për të gjitha planifikimet e lidhura me kapacitetet, pavarësisht nga organizmi apo konfiguracioni në të cilën kryhet.

DGJP-ja është gjithashtu unike në atë që i përgjigjet një pyetjeje themelore të lidhur ngushtë me të gjitha disiplinat e planifikimit të kapaciteteve: çfarë kërkojnë Aleatët të jetë në gjendje të bëjë NATO në terma cilësore. Për këtë qëllim, Direktiva siguron një strukturë të përbashkët kërkesash si edhe prioritetesh.

Vërtet, Direktiva ka filluar të ndihmojë disiplinat e ndryshme planifikuese të Aleancës, të tjera agjenci dhe organizma të lidhura me kapacitetet, si edhe shtetet që të ndjekin prioritetet koherente. Vetë shtetet ndjekin prioritetet koherente. Për shembull, Direktiva Ekzekutive e vitit 2006, e miratuar nga Komiteti i Planifikimit të Mbrojtjes në qershor 2006, mori në konsideratë DGJP-në, siç bëri Direktiva Ekzekutive për Planifikimin e Urgjencave Civile në janar 2007.

Veç kësaj MC 550, Direktiva e Komitetit Ushtarak për Zbatimin Ushtarak të DGJP-së dhe dokumentet dytësorë të saj gjithashtu pasqyrojnë në terma praktike DGJP-në. Gjenden edhe indikatorë të shumtë që dokumenti po ndihmon përprojekjet e transformimit të Aleatëve të veçantë.

Direktiva nga vetë natyra e saj është një dokument i fokusuar te kapacitetet. Ajo nuk rreket të përcaktojë kërkesat në terma të pajisjeve apo platformave specifike, si llojet e anijeve apo avionët që kërkohen, por më tepër në terma se çfarë tipa kapacitetesh kërkohen dhe efekti që duhet të kenë në veprim. Të para në këtë kontekst, kapacitetet janë më të gjera se sa thjesht konsideratat e pajisjeve dhe përfshijnë shumë të tjera, si p.sh. doktrinën, procedurat, organizatat, trajnimet, mbështetjet dhe ndërveprimshmërinë.

DGJP-ja vetëm siguron një vizion të kapaciteteve që kërkon në të ardhmen, por është e fokusuar në mbështetjen e operacioneve. Kështu që dokumenti është praktik dhe realist dhe udhëzimi që ofron është i përshtatshëm në operacione. Për shembull, ai siguron një shtysë politike për zhvillimin e një qasjeje ndaj operacioneve që është e bazuar në efekte, qasje e cila kërkon të sigurojë që instrumentet e ndryshme të Aleancës të mblidhen së bashku për të siguruar efektin më të mirë si edhe të bashkërendohen me aktivitetet e aktorëve të tjerë. Dokumenti nënvizon kërkesën që kombet të zhvillojnë kontribute fleksibël dhe të qëndrueshme të fuqisë ushtarake dhe të ndajnë në mënyrë të ndershme peshën e mbrojtjes.

Direktiva gjithashtu vepron si katalizator për transformimin e proceseve të NATO-s. Për shembull, DGJP-ja nëpërmjet mekanizmave të saj menaxhues, ka nënvizuar dobinë e një liste të vetme dhe të konsoliduar të NATO-s për kërkesat e kapaciteteve dhe prioriteteve, si një mjet për të maksimizuar koherencën dhe harmonizimin nëpër të gjithë procesin e zhvillimit të kapaciteteve. Si rezultat, Transformimi i Komandës Aleate, me mbështetjen e agjencive dhe organizmave të tjera është tashmë i angazhuar në zhvillimin e një liste të tillë.

Në mënyrë të ngjashme dhe në një shkallë më të madhe, përprojekjet e nisura kohët e fundit për zmadhimin e procesit

planifikues të mbrojtjes dhe shqyrtimin e mundësive për harmonizimin e përgjegjësive, procedurave, afateve kohore dhe raportimit të disiplinave planifikuese të lidhura me kapacitetet, ishte gjithashtu shkaktuar nga DGJP-ja dhe mekanizmat e saj menaxhues.

Çfarë nuk bën DGJP-ja?

Pas përshkrimit të DGJP-së dhe asaj se çfarë rreket të bëjë brenda Aleancës, ndoshta është me dobi të adresojmë shkurtimisht se çfarë nuk bën DGJP-ja. DGJP-ja nuk e zëvendëson dot Konceptin Strategjik 1999, por ajo e mbështet dhe kompletton atë. Sidoqoftë Direktiva do të rishikohet periodikisht për ta ruajtur rëndësinë e saj. Bazuar në treguesit më të fundit, mund të pritët që dokumenti të rishikohet pasi NATO-ja të nxjerrë Konceptin e ri Strategjik, që mund ta bëjë më 2009. DGJP-ja nuk rrëmon në detaje të mjaftueshme për të dhënë udhëzime shteruese për secilën disiplinë specifike planifikuese dhe organizmat e tjerë të lidhur me kapacitetet, kështu që ka akoma kërkesë për udhëzime në nivel më të ulët.

DGJP-ja nuk përcakton në terma sasiorë se çfarë presin Aleatët të arrijë NATO-ja. Për forcat planifikuese, kjo është arritur në një dokument të klasifikuar (Direktiva Ministrore 2006), i cili është bazuar mbi DGJP-në dhe është rënë dakord nga shtetet e interesuar në qershor 2006. Së fundi, DGJP-ja nuk kërkon forca shtesë, thjesht kërkon forca që janë më të përdorshme, më të pozicionuara, më efektive, por jo domosdoshmërisht më të shumta në numër.

Një rrugë drejt transformimit

Direktiva Gjithëpërfshirëse Politike siguron një vizion të përmbledhur dhe thelbësor për transformimin e vazhdueshëm të NATO-s. Por në fund të fundit më i rëndësishëm është zbatimi i DGJP-së, si brenda Aleancës ashtu edhe brenda vetë shteteve, sepse zbatimi duhet të çojë drejt zhvillimit të më shumë kapaciteteve të përdorshme për aftësitë e përdorshme për operacione dhe misione në të ardhmen, dhe në këtë

mënyrë bën të mundur që Aleanca të mbetet efektive, e besueshme dhe e rëndësishme në shek. XXI. Siç u ilustrua në Samitin e Rigës dhe në të vërtetë edhe më përpara, shtetet Aleate e kanë përqafuar rrugën e transformimit të shtjelluar në DGJP. Kjo rrugë, sidoqoftë, mbetet e gjatë dhe e lodhshme. Sfida e vërtetë për Aleatët është të qëndrojnë në të njëjtën rrugë.

Paul Saverieux është oficer i politikave të mbrojtjes në Divizionin e Politikave Planifikuese dhe të Mbrojtjes në NATO.

Friedrich Steinhäusler

KËRCËNIMET TERRORISTE NDAJ VENDEVE TË NATO-S

Vendet anëtare të NATO-s hasin kërcënime asimetrike të sigurisë nga terrorizmi kombëtar dhe ndërkombëtar, siç ishin sulmet ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës në 2001, ndaj Turqisë në 2003, Spanjës në 2004 dhe Anglisë në 2005.¹ Veç këtyre sulmeve, autoritetet në Evropë kanë bërë të dështojnë të paktën 19 sulme të rëndësishme qysh nga 11 Shtatori 2001.²

Në prill 1999, Aleanca në Konceptin Strategjik (KS) e identifikoi terrorizmin si një nga risqet që ndikon sigurinë e anëtarëve të saj dhe një koncept ushtarak për mbrojtjen kundër terrorizmit u miratua në Samitin e Pragës më 21 nëntor 2001. Shumë nga sfidat në fushën e sigurisë që has Aleanca, sidoqoftë, janë akoma duke u shfaqur dhe paraqesin risqe të mëdha. Mund të jetë e vlefshme ekzaminimi i tyre në detaje, së bashku me masat për t'u bërë ballë atyre që NATO ka ndërmarrë që nga Samiti i Pragës.

¹ Varianti origjinal i këtij artikulli: Friedrich Steinhäusler, "Terrorist Threats to NATO Countries: A Bestiary", *NATO Review*, Spring 2007.

² Një raport i botuar në shkurt 2005 nga Institucioni Norvegjez për Kërkime të Mbrojtjes, deklaronte që të paktën 15 sulme të mëdha terroriste janë parandaluar në Evropë qysh nga 11 Shtatori 2001. Në qershor 2005, Glenn Schoen, një ekspert mbi terrorizmin në Ernest & Young Security and Integrity Services, tha se 19 sulme të mëdha terroriste janë parandaluar. Numri me siguri është rritur që nga ajo kohë. Shih: *Strategic priorities for protecting Europe's infrastructure against terrorism*, Report New Defence Agenda Meeting, Bruksel, 27 Qershor 2005 (www.forum-europe.com/publication/NDA_SOD_27June2005FORPRINT.pdf)

Xhihadi global

Mesazhi i Osama Bin Laden në prill 2006 ripërsëriti strategjinë e tij të Xhihadit global, duke u bërë thirrje të gjithë burrave, grave dhe të rinjve për të marrë pjesë vullnetarisht në sulme vetëvrasëse dhe duke përmendur veçanërisht Afganistanin dhe Irakun.³ Xhihadi kundër qeverisë afgane dhe trupave të NATO-s nuk mund të përjashtohet nga konsiderata, në dritën e faktorëve të ndryshëm. Zotërit e luftës dhe udhëheqësit fisnorë vazhdojnë të kenë ndikim dhe besnikëria ndaj regjimit në Kabul është e paqartë. Për më shumë, paaftësia e qeverisë afgane për të parandaluar rishfaqjen e opiumit si një mall i rëndësishëm ka rezultuar në përmirësimin e burimeve financiare për terroristët me një prodhim të opiumit që arritur majën e 6.000 tonëve në vitin 2006, siç është dokumentuar nga Zyra e OKB-së mbi Drogën dhe Krimin. Mediat perëndimore vazhdimisht raportojnë se elementë batakçinj të Shërbimit Informativ të Pakistanit i sigurojnë mbështetje logjistike Talebanit, përfshirë trajnime në terrorizmin vetëvrasës. Shumë anëtarë të Al Kaedës besohet se janë në numër të madh në rajonin kufitar midis Pakistanit dhe Afganistanit ku nuk vepron ligji.

Ndërkaq, në Irak pushteti ka kaluar nga duart e synitëve në atë të shiitëve, për herë të parë në historinë arabe. Në librin e tij të botuar në vitin 2006, “Radikalizimi i ndarjes synit-shiit”, Ely Karmon dokumentoi sesi shiitët iranianë mbështesin agjendën e shiitëve në rajon, nëpërmjet grupeve politike vendore si lokale si Dava al-Islamija në Irak, Amal në Liban, Hizbadat në Afganistan dhe Tahrir Xhafaria në Pakistan. Vendet anëtare të NATO-s që dërgojnë forca në Irak janë në rrezik të tërhiqen brenda këtij polarizimi.

³ Al-Jazeera (Doha): *Bin Laden accuses West* (transcript), April 24, 2006; <http://english.aljazeera.net/NR/exeres/F9694745-060C-419C-8523-2E093B7B807D.htm>

Terrorizmi vetëvrasës

Sulmet vetëvrasëse janë forma më vdekjeprurëse e terrorizmit, duke përfaqësuar vetëm 3% të akteve terroriste, por duke shkaktuar 48% të gjithë viktimave të terrorizmit në periudhën 1980-2003. Këto sulme kanë shënuar rritje prej një mesatareje tre në vit në vitet 1980 në rreth 50 në vitin 2005. Mbi 300 sulme vetëvrasëse në 16 vende - Afganistan, Rusi, Kinë, Indonezi, Irak, Kashmir, Kenia, Marok, Pakistan, Palestinë/Izrael, Arabi Saudite, Sri Lanka, Tunizi, Turqi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Jemen - kanë rezultuar në më shumë se 5.300 persona të vrarë dhe mbi 10.000 të plagosur. Siç ka shkruar Scott Atran dhe shumë të tjerë, 75% të të gjitha bombardimeve vetëvrasëse në botë kanë ndodhur pas sulmeve terroriste të 11 Shtatorit në Shtetet e Bashkuara.⁴

Gjithashtu duhet të kujtojmë që këto sulme mund të kenë ndikim të fuqishëm ekonomik dhe pasoja ekologjike edhe kur ato ndodhin jashtë Evropës. Në tetor 2002, një varkë me sulmues ia arriti të godiste një supertanker, Limburg, në brigjet e Jemenit, duke shkaktuar një derdhje prej 90.000 fuçish naftë në Gjirin e Adenit dhe duke sjellë rritje për një kohë të shkurtër në çmimin e naftës.

Terrori Vendas

Në Evropë, terrorizmi vendas vazhdon të jetë një kërcënim për sigurinë e vendeve anëtare të NATO-s. Fatkeqësisht terrorizmi vetëvrasës tolerohet, madje adhurohet, në zonat e varfra dhe të painteguara të disa komuniteteve myslimane në

⁴ Për këtë dhe informacione të tjera mbi terrorizmin vetëvrasës, shih Atran, Scott, *Genesis and Future of Suicide Terrorism*, <http://www.interdisciplines.org/terrorism/papaers/1> (last visited: 19.01.2006); NATO, *Suicide Terrorism: The Strategic Threat and Countermeasures*, Report (August 2004); Speckhard, Anne, *Understanding Suicide Terrorism: Countering Human Bombs and Their Senders*, in *Topics in terrorism: toward a Transatlantic Consensus on the Nature of the Threat* (volume 1), Eds.: Jason S. Purcell & Joshua D. Weintraub, Atlantic Council Publication (2005); US Army Training and Doctrine Command, *Suicide Bombing in the COE*, DCSINCT Handbook No. 1.03 (15.08.2005).

Evropë. Qytetarë britanikë zbatuan sulme vetëvrasëse kundër sistemit të transportit publik në Londër në vitin 2005. Ndërkohë, forcat e sigurisë britanike sprapsën plane vrasëse për përdorimin e risinës⁵ (lëndë) si dhe për sulme terroriste kundër aviacionit civil. Në Gjermani në vitin 2006, policia parandaloi shpërthime bombash në disa trena.

Deri tani, ata që dëshironin të përfshiheshin në akte terroriste në vendet e tyre u duhej të udhëtonin në rajone malore gjatë kufirit ndërmjet Afganistanit dhe Pakistanit për të marrë trajnimin e nevojshme. Në të ardhmen, para tyre qëndron zgjedhja e një game më të gjerë të kampeve të trajnimit. Terroristët mund të mësojnë parimet bazë të bombardimeve në rrugë, makinat-bombë, dhe luftën guerile në Irak dhe pastaj të kthehen në vendet e tyre për ta përdorur përvojën e fituar për të sulmuar objektiva në vendet e NATO-s.

Sulmet radiologjike

Për më tepër, Përfundimet Paraprake dhe Rekomandimet e një Seminari të Avancuar Kërkimi NATO-Rusi në dhjetor 2006, nxorën që sulmet terroriste mund të përdorin materiale radioaktive për të shkaktuar një ekspozim të pakontrolluar të rrezatimit.⁶ Qëllimi është ndotja e njerëzve dhe e mjedisit, për të shkaktuar më shumë panik masiv sesa shkatërrim masiv. Mijëra burime radioaktive janë në përdorim në institute kërkimesh mjekësore, qendra industriale dhe ushtarake. Përshatshmëria e tyre për sulme terroriste ndryshon në varësi të llojit të burimit dhe izotopit radioaktiv. Çdo vit ka me qindra raste incidentesh të vjedhjeve, braktisjes apo humbjes së burimeve radioaktive në qendra mjekësore apo industriale. Duke patur parasysh lehtësinë e ndërtimit të mekanizmave shpërthyes radioaktivë, rritet probabiliteti që terroristët mund të rreken të realizojnë një sulm të tillë në një zonë të rëndësishë së lartë në një vend anëtar të NATO-s.

⁵ lëndë helmuese (shën. i red.).

⁶ Findings and Recommendations of the NATO-Russia Advanced Research Workshop “Social and Psychological Effects of Radiological Terrorism”, Bratislava, Slovak Republic, 20 December 2006.

Armët e shkatërrimit në masë

Terroristët kanë deklaruar në mënyrë të përsëritur si qëllimin, po ashtu edhe aftësitë e tyre për përdorimin e armëve të shkatërrimit në masë. Në Japoni, ndodhën dy incidente të lëshimit të gazit sarin në 1994 dhe 1995; në SHBA pati disa lëshime antraksi më 2001; dhe Al Kaeda e ka shpallur qëllimin e vet për sulmuar me armëve bërthamore. Në periudhën 1990-2004, të paktën 27 raste janë bërë të ditura, në të cilën materialeve të armëve bërthamore u është bllokuar dërgimi në destinacione që donin t'i përdornin për akte terroriste.⁷

I një rëndësie të madhe është mbrojtja fizike e afërsisht 450 ton plutoni i shpërndarë institucioneve ushtarake e civile. Nëse terroristët zgjedhin rrugën më të lehtë teknike për përdorimin e uraniumit të pasuruar për një mekanizëm bërthamor rudimentar, atyre u duhet vetëm të kenë në dorë rreth 25 kg nga më shumë se 1.700 ton uranium të pasuruar që ndodhet rezervë në mbarë botën. Ekspozimi që dr. Abdul Qadeer Khan i bëri një rrjeti të tregut të zi të materialeve bërthamore, tregoi dobësinë e programeve ndërkombëtare të kontrollit. Prandaj nuk mund të anashkalohet më gjatë mundësia e një katastrofe terroriste kundër një vendi anëtar të NATO-s.

Plani i veprimit të NATO-s

Aleanca ka dëshmuar vendosmërinë e saj për t'iu përgjigjur këtyre kërcënimeve në rrugë të ndryshme. Për shembull, në më pak se 24 orë mbas sulmeve të 11 Shtatorit, aleatët e NATO-s iu drejtuan Nenit 5, nenit të mbrojtjes së përbashkët të Traktatit të Uashingtonit. NATO-ja i vuri në përdorim SHBA-së alarmin ajror dhe avionët kontrollues në Operacionin Ndihma e Shqiponjës në 9 tetor 2001 dhe forcat detare në Mesdheun Lindor në 6 tetor 2001. Aleatët gjithashtu nënshkruan një koncept ushtarak për mbrojtjen kundër terrorizmit në Samitin e Pragës në 2002.

⁷ Zaitseva, L., Steinhäusler, F., *Illicit trafficking of weapons-usable nuclear material: facts and uncertainties*, Physics and Society Newsletter 33, 1, pp. 5-8 (2004)

Akoma nevojitet shumë progres për t'u bërë. Gjatë 10-15 viteve të ardhshme vendet anëtare të NATO-s do të përballen me këto kërcënime: rrjetet operacionale globale të terrorit të modeluara sipas Al Kaedës, një numër në rritje të shteteve të dështuara apo në dështim e sipër në Afrikë dhe Lindjen e Mesme, disponueshmëria e lehtë e armëve të sofistikuara konvencionale, si p.sh. raketat tokë-ajër, keqpërdorimi i teknologjive të reja si armë, si p.sh. nanoteknologjia, bllokimi i kalimit të burimeve jetësore me anë të sulmeve ndaj furnizimit të energjisë dhe përhapja e armëve radiologjike dhe ato të shkatërrimit në masë - të natyrës bërthamore, biologjike apo kimike.

E thënë shkurt, siguria e Aleatëve mund të vihet në rrezik nga krizat e shpeshta emergjente në vendet e largëta sepse shtetet e dështuara kanë provuar të jenë mjedise të përshtatshme për terroristët që na kërcënojnë në vendet tona. Prandaj, zgjidhjet e paraplanifikuara dhe tradicionale ushtarake të Luftës së Ftohtë, nuk janë më të përshtatshme. Fatmirësisht, Samitet e fundit të NATO-s kanë adoptuar masa në rritje për shtimin e aftësive të aleatëve në luftën kundër terroristëve. Qysh prej vitit 2004, një iniciativë e njohur si Programi i Punës së Mbrojtjes Kundër Terrorizmit, i lancuar sipas Konferencës së Drejtorëve të Armatimeve Kombëtare, ka si qëllim zhvillimin e koordinuar të teknologjive të avancuara për të kundërshtuar kërcënimet terroriste. Masat e ardhshme përfshijnë, ndërmjet të tjerave, përballimin e bombave me makina ose të vëna në rrugë, uljen e cenueshmërisë së avionëve prej raketave portative të mbrojtjes ajrore portative dhe uljen e cenueshmërisë së helikopterëve prej raketave dhe mbrojtja e porteve dhe anijeve prej varkave apo mjeteve të nënujshme të mbushura me eksplozivë.

Veç kësaj, aleatët tani kanë një Forcë të Kundërpërgjigjes (NRF) që është plotësisht operacionale. NRF-ja do të shërbejë si një katalizator për transformimin dhe ndërveprimin, dhe kjo gjë do të forcojë cilësinë e forcave të armatosura të Aleatëve qoftë të përdorura nga NATO-ja, po ashtu edhe nga BE-ja, OKB-ja ose në operacione kombëtare. Në Samitin e Rigës, vendet anëtare shprehën mbështetjen e tyre për mekanizma

që sigurojnë gjenerimin afatgjatë të forcave dhe lejimin për një qasje më të qëndrueshme dhe transparente për të mirëmbajtur kapacitetet e ardhshme të forcave. Ndërsa as NRF-ja, as Iniciativa e Transformimit të Forcave të Operacioneve Speciale, e aprovuar kohët e fundit, nuk janë menduar të përdoren ekskluzivisht për qëllime kundër terrorizmit, ato forcojnë aftësinë e Aleancës për të ndërmarrë operacione të ekspeditës. Kjo aftësi, nga ana e saj do të jetë e vlefshme në përbalimin e kërcënimeve që nisin brenda shteteve të dështuara.

Vendet e NATO-s janë përgjigjur edhe në mënyrë diplomatike. Plani i aksionit të vendeve partnere Euro-Atlantike kundër terrorizmit, i bërë i ditur në Pragë, është rifreskuar çdo vit. Aleanca vendosi një gur tjetër themeli në Samitin e Rigës, në nëntor 2006 me nënshkrimin e Direktivës Gjithpërfshirëse Politike, që e vë theksin, ndërmjet të tjerash, edhe në kërcënimet e terrorizmit dhe shpërndarjen e armëve të shkatërrimit në masë.

Konkluzione

Në Samitin e Rigës, vendet e NATO-s theksuan që mbrojtja kolektive vazhdon të jetë një qëllim kryesor për aleancën. Për të ardhmen e parashikueshme, terrorizmi global do të mbesë kërcënim i madh për mbrojtjen transatlantike. Anëtarët evropianë të Aleancës kanë provuar tashmë një spektër të gjerë të ngjarjeve të lidhura me sigurinë, shto edhe sulmet terroriste në Turqi, Spanjë, Angli dhe Gjermani.

Jashtë Evropës, arrestimet në Toronto, në 2006, mund të jenë tregues i koordinimit më të ngushtë dhe mundësisht bashkëpunimit midis bërthamave të fjetura terroriste në Amerikën e Veriut. Në Afganistan, sulmet me bombave vetëvrasëse dhe mekanizmat e improvizuar shpërthyesë janë bërë lloji i parapëlqyer i sulmit për rebelët e lidhur me Talebanin. Në qoftë se janë të suksesshme, këto sulme mund të lehtësojnë kthimin e Al Kaedës. Në Irak, terroristët janë gjithnjë e më shumë të angazhuar në sulme të shpeshta ndaj forcave të koalicionit të udhëhequr nga SHBA-ja, duke

përdorur një varietet të gjerë të mekanizmave të improvizuar shpërthyes, forca shkatërruese e të cilave mund të importohet në vetë vendet e NATO-s.

Sulmet e ardhshme terroriste mund të ndodhin brenda kufijve të shteteve anëtare të NATO-s, si pasojë e terrorizmit vendas ose të atij të ardhur nga jashtë zonës evro-atlantike. Këto sulme mund të ndodhin pa paralajmërim, të përfshijnë forma jokonvencionale të sulmit të armatosur dhe mjete asimetrike, madje edhe armë të shkatërrimit në masë. Për fat të mirë, forcimi i aftësisë së Aleancës për të përballuar sfidat e kërcënimeve asimetrike është një nga prioritetet kryesore të NATO-s.

Friedrich Steinhäusler është profesor i biofizikës dhe fizikës në Universitetin e Salzburgut. Ai është bashkautor me Frances Edwards i librit "NATO dhe Terrorizmi: Terrorizmi Katastrofik dhe Reaguesit e Parë".

Kol. (rez.) Selim Shiroka

LIDERSHIPI POLITIK E USHTARAK DHE ROLI I TIJ PËR SIGURIMIN KOMBËTAR

Ideja e sigurimit dhe e nevojës për të realizuar sigurimin ka lindur që në fillimet e civilizimit. Në periudha të ndryshme historike, konceptet e sigurimit kanë qenë të ndryshme në varësi të një sërë faktorësh e sidomos të mjedisit të sigurimit të çdo vendi.

Zhvillimet politike, ekonomike, sociale, teknologjike, kulturore e të tjera janë kusht i domosdoshëm për shoqërinë dhe jetesën. Por këto zhvillime mund të bëhen të pavlefshme dhe të asgjësohen brenda një kohe të shkurtër në qoftë se nuk do të parashikohen masa për sigurimin dhe mbrojtjen e tyre, si dhe për mbijetesën e shoqërisë. Për këtë arsye çdo entitet politik ndërton strategjinë e sigurimit kombëtar, e cila:

- a. Është një dokument politik, një pasqyrim i qëllimeve dhe objektivave kombëtare më të rëndësishme.
- b. Formulimi dhe zbatimi i saj është përgjegjësi e lidershit politik, të cilët, sipas kushtetutës, mishërojnë unitetin e shoqërisë dhe të kombit. Kështu evitohet rreziku që politikanët t'i llogarisin interesat kombëtare si pikëpamje të tyre personale.
- c. Është një dokument dinamik, sepse kushtet mund të ndryshojnë ose mund të lindin qëllime të reja dhe të zvogëlojnë vlerën e qëllimeve ekzistuese.

Strategjia e sigurimit kombëtar nuk duhet të bazohet te frika: frika nga terroristët, nga armët e dëmtimit në masë, nga eksplozivat në kutitë postare, sepse një strategji e tillë sjell më tepër frikë dhe jo sigurim real. Përdorimi i elementëve të fuqisë

kombëtare do të jetë më efektiv kur udhëhiqen nga një strategji që bazohet te shpresa dhe te një lidhshmëri të besueshëm. Përpilimi i strategjisë është në fakt një proces i zgjidhjes së problemeve: duhet të kuptohet natyra e problemit dhe të identifikohen zgjidhjet e mundshme. Kjo ndihmon në identifikimin e objektivave politike që duhet të arrihen. Këto objektiva çojnë në zhvillimin e strategjisë kombëtare për arritjen e tyre dhe më tej për formulimin e strategjisë ushtarake.

Ndërsa disa elementë të procesit të përpilimit të strategjisë mund të jenë të qartë, të specifikuar në kushtetutë dhe ligje, shumë aspekte të tjera janë të vështira për t'u kuptuar. Prandaj, është e pamundur të jepet një metodë universale e procesit të përpilimit të strategjisë, por mund të evidentohen elementë themelorë që duhet t'i kenë parasysh përpiluesit e strategjisë për të arritur në zgjidhje të përshtatshme të një problemi të caktuar.

1. Modeli i sigurisë

Sigurimi i vendeve të vogla, si Shqipëria, ka qenë një problem i vështirë që në kohët e lashta. Evropa pas Luftës së Ftohtë u siguron shteteve të vogla një mjedis të ri ndërkombëtar që ka njëkohësisht si avantazhe dhe disavantazhe. Avantazhet më të rëndësishme janë mungesa e kërcënimeve të drejtpërdrejta ushtarake, rritja e kundërshtimit për përdorimin e forcës ushtarake në zgjidhjen e konflikteve midis shteteve dhe mundësi të shumta në arenën ndërkombëtare për mbrojtjen e interesave të shteteve të vogla. Disavantazhet janë se disa shtete të vogla, përfshirë Shqipërinë, e ndiejnë veten më pak të sigurt se të tjerat; përpjekjet për integrimin evropian krijojnë shqetësime për sovranitetin kombëtar në ekonomi, si dhe në sferat sociale e kulturore.

Zakonisht, sigurimi ndahet në tre nivele: sigurimi individual, sigurimi shtetëror ose kombëtar dhe sigurimi ndërkombëtar. Sigurimi kombëtar përbën çështjen qendrore sepse ai ka një ndikim dominues ndaj kushteve që përcaktojnë sigurimin në dy nivelet e tjera. Sidoqoftë, udhëheqja politike nuk duhet të harrojë se ekzistenca e një

shteti vihet në rrezik në qoftë se nuk është në harmoni me dy nivelet e tjera.

Kuptimi dominues i sigurimit sot është pasuruar me elementë të tjerë përtej konceptit tradicional dhe themelor të sigurimit ushtarak. Mënyra e zhvillimeve të sotme bën që t'u kushtohet më shumë vëmendje burimeve të jetesës, ruajtjes së mjedisit, çështjeve demografike, faktorëve kriminalë dhe kulturorë për sigurimin. Megjithatë, vëmendja kryesore duhet të vazhdojë t'u kushtohet fushave kryesore të sigurimit kombëtar: ushtarake, politike, ekonomike, shoqërore dhe mjedisore.

Barry Buzan e përshkruan analizën e fushave të sigurimit si vijon: “Sigurimi ushtarak ka të bëjë me ndërveprimin me dy nivele të kapaciteteve të armatosura mësimëse dhe mbrojtëse sipas perceptimeve të shteteve për synimet e njëri-tjetrit. Sigurimi politik lidhet me stabilitetin organizativ të shtetit, sistemet e qeverisjes dhe ideologjive që u japin atyre legjitimitetin. Sigurimi ekonomik nënkupton aksesin ndaj resurseve, financave dhe tregjeve që janë të nevojshme për të mbajtur nivele të pranueshme të fuqisë shtetërore. Sigurimi shoqëror përfshin mundësitë për një zhvillim në rritje, për gjuhën, kulturën, fenë dhe identitetin kombëtar. Sigurimi i mjedisit trajton mbrojtjen e biosferës lokale dhe planetare si sistemi bazë mbështetës nga i cili varen ndërmarrjet e tjera njerëzore”.

Është e rëndësishme të theksohet se këto pesë fusha nuk mund të kuptohen krejtësisht të ndara nga njëra-tjetra. Ato, në fakt, duhet të shikohen si të ndërthurura dhe në ndërveprim e vartësi reciproke me njëra-tjetrën. Zhvillimi i veprimtarive në të pesë fushat përbën mjedisin e sigurimit të vendit. Shteti është i detyruar të përpunojë politika dhe strategji për të mbrojtur veten nga fenomenet negative, rreziqet dhe kërcënimet.

Duke folur për modelin e sigurisë së një vendi nuk mund të mos marrim në konsideratë:

Së pari, çdo model i ri sigurie i formuluar dhe i përligjur nga një vend në një stad të caktuar të zhvillimit të tij nuk mund të jetë absolutisht i ri, i palidhur me kontekstin gjeopolitik, ku

vendi ka ekzistuar për shekuj. Është e detyrueshme që në një model të tillë, elementët ekzistues të tij të lidhen me situatën gjeografike, madhësinë, fqinjët historikë dhe marrëdhëniet e përcaktuara gjeopolitike.

Së dyti, çdo model sigurie ka bazën e tij historike. Ai është rezultat i zhvillimeve historike, pozitive dhe negative, duke ruajtur elementët pozitivë të modeleve të mëparshme dhe duke përjashtuar ata elementë që nuk i kanë qëndruar vlerësimit praktik të historisë.

Shqipëria, si vend me komunikim të kufizuar me pjesën tjetër të botës deri në fillim të viteve 1990, pavarësisht nga dobësitë ekonomike, problemet e sigurisë i ka trajtuar me përparësi në kuadrin e vendit, ndryshe nga shtetet e tjera të Evropës Lindore, çështjet e sigurisë, të cilat trajtoheshin kryesisht në qendrën e ish-bllokut ushtarak lindor. Sidoqoftë, përvoja e Shqipërisë për ndërtimin e strategjive në kushtet e reja është akoma e kufizuar për arsye të ndryshme e në radhë të parë si rrjedhojë e aplikimit të një sistemi social, politik e ekonomik të ndryshëm nga ai i mëparshmi dhe që për vendin tonë është relativisht i ri për nga koha e ekzistencës së tij.

Nga këto pikëpamje, modeli dhe strategjia e sigurimit e Shqipërisë duhet të kenë specifikat e tyre që lidhen kryesisht me faktin se është një vend i vogël, i vendosur në një rajon specifik me karakteristika të përcaktuara gjeopolitike dhe gjeostrategjike.

Në botën e sotme, asnjë vend, i madh ose i vogël, nuk mund ta realizojë sigurimin kombëtar në mënyrë individuale. Për Fuqitë e Mëdha, sigurimi kombëtar varet shumë më tepër nga fuqitë e tyre kombëtare, ndërsa për vendet e vogla marrin një rëndësi të madhe faktorët e jashtëm. Fuqia kombëtare e Shqipërisë (politike, ekonomike, ushtarake dhe informative) nuk është e mjaftueshme për të përballuar një konflikt të mundshëm të armatosur në rajon. Kjo do të thotë se siguria kombëtare e Shqipërisë varet shumë nga faktorët e huaj dhe ndërkombëtar.

Për këtë arsye, për garantimin e sigurisë së vendit edhe Shqipëria, si vend i vogël, duhet të mbajë në vëmendje:

- Aleatë të fuqishëm
- Balancimin e interesave të vendit midis interesave të fuqive të huaja

Me fjalë të tjera, koncepti i sigurimit të vendit duhet të mbajë në konsideratë realizimin e sigurimit nëpërmjet bashkëpunimit dhe integritit në strukturat drejtuese dhe organizatat evropiane dhe evro-atlantike për sigurinë dhe bashkëpunimin, zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale mbi bazën e barazisë, të drejtave të barabarta dhe përfitimit reciprok në të gjitha fushat, sidomos në atë ekonomike, teknologjike, ekologjike dhe ushtarake.

Nga ana tjetër, sigurimi i vendit mund të arrihet duke krijuar stabilitetin politik, social dhe ekonomik, duke ndërtuar struktura efektive ushtarake, duke ndërtuar sisteme të menaxhimit të krizave dhe të mbrojtjes civile, duke krijuar struktura legjislative dhe ekzekutive mbi baza kushtetuese. Qëllimi i politikës së sigurimit të Shqipërisë duhet të jetë evitimi sa më shumë që të jetë i mundur i mungesës së qartësisë për sigurimin e vendit, duke u përgatitur për çdo eventualitet dhe duke eliminuar ose minimizuar ekzistencën e një vakuumi sigurie.

Formulimi dhe zbatimi i një strategjie të tillë reale kërkon:

a. Në fushën politiko-ekonomike

- politikë konsekuente për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga angazhimi për anëtarësim e Shqipërisë në NATO dhe Bashkimin Evropian;
- adaptimin sa më shpejtë të standardeve evropiane, harmonizimin e legjislacionit me atë të vendeve të Bashkimit Evropian, miratimin e ligjeve dhe rregullave të reja, përmirësimin e administrimit shtetëror, liberalizimin e tregtisë, sigurimin e kushteve për qarkullimin e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve, zbatimin e kërkesave që rrjedhin nga negociatat për pranimin në Bashkimin Evropian;
- pjesëmarrjen aktive të Shqipërisë në format ekzistuese të bashkëpunimit me këto organizata në kushtet e ndërtimit

- të një arkitekture të re dhe të gjerë të sigurimit evropian, bazuar në partneritet dhe bashkëpunim për rritjen e stabilitetit dhe sigurisë së të gjithë shteteve evropiane;
- thellimin e marrëdhënieve me shtetet anëtare dhe organizmat e OSBE-së dhe Këshillin e Evropës, të cilët janë aktorë të rëndësishëm të arkitekturës evropiane të sigurimit dhe bashkëpunimit;
 - përmirësimin rrënjësor të kushteve për tërheqjen e investimeve në vend dhe implementimin e formave të tjera të bashkëpunimit ekonomik, financiar, teknologjik dhe shkencor.

b. Në fushën e politikës së jashtme

Përmirësimin e veprimtarive të politikës së jashtme me synimin e realizimit të përpjekjeve të përbashkëta për arritjen e një stabiliteti afatgjatë të situatës në rajon, nëpërmjet:

- nxitjes së marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit me vendet ballkanike e më gjerë, duke ndihmuar proceset pozitive që zhvillohen në fushën e sigurisë;
- gjetjes së zgjidhjeve konstruktive për mosmarrëveshjet me mjete paqësore, me vendosjen e lidhjeve të qëndrueshme të integritetit rajonal;
- përgatitjes për zgjidhjen e problemeve që lindin si rezultat i përpjekjeve për stabilizimin e rajonit, rritjen e besimit midis vendeve të rajonit, stimulimin e dialogut në fushën e ekonomisë, ekologjisë, luftës kundër krimit të organizuar, trafikut të drogës dhe trafiqeve të tjera ilegale.

c. Në fushën ushtarake

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe në NATO, i cili përcaktohet si prioritet i politikës së shtetit ka përcaktuar si objektiv ndërtimin e një force të armatosur të karakterizuar nga një strukturë mbrojtëse, më të vogël në numër, me nivel gatishmërie më të lartë, një forcë të manovrueshme dhe me përgatitje të lartë, e aftë për të mbrojtur

integritetin territorial dhe pavarësinë e Shqipërisë. Kjo forcë duhet të aftësohet që të plotësojë kërkesat për anëtarësim dhe ndërveprim me NATO-n.

Reforma në Forcat e Armatosura përcaktohet nga ndryshimi i situatës strategjike, politike dhe ushtarake në Evropë dhe sidomos në Ballkan, si dhe nga gjendja ekonomike e vendit dhe problemet financiare, materiale e teknike që lidhen me të. Por që reforma të jetë reale dhe efektive duhet të përfshijë të tre aspektet thelbësorë të saj: konceptual (strategji ushtarake, doktrinë), të pajisjeve (modernizimi) dhe të personelit (stërvitje, kualifikim). Të tre këto aspekte të reformës duhet të zhvillohen paralelisht; neglizhimi i njërit ose tjetrit aspekt e bën reformën formale. Për këtë arsye, udhëheqësit politikë dhe aktorët e tjerë të politikës së sigurimit kombëtar duhet të mendojnë për zhvillimin dhe funksionet e Forcave të Armatosura jo mbi bazën e llogarive të sotme ose të ideologjive të djeshme, as mbi bazën e kontradiktave midis Fuqive të Mëdha ose kundërvënies ndaj fqinjëve, por mbi bazën e përvojës historike dhe të perspektivave themelore ndërkombëtare.

2. Mekanizmi i sigurimit kombëtar

Çdo entitet politik ka mekanizmin e tij për ndërtimin e strategjisë. A e ka Shqipëria mekanizmin e nevojshëm të sigurimit kombëtar? Cilat janë anët e forta dhe dobësitë e mekanizmit aktual? Çfarë mësimesh mund të nxirren nga mekanizmat përkatëse të vendeve të tjera? Këto janë disa pyetje që meritojnë vëmendje në çdo debat për sigurimin kombëtar.

Sigurimi kombëtar ka komponentë të ndryshëm, ku ndër më kryesorët janë politik, ushtarak, ekonomik dhe informativ. Këta komponentë janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe në qoftë se njeri është i dobët, sigurimi kombëtar si një i tërë do të jetë i dobët. Prandaj menaxhimi i sigurimit kombëtar kërkon integrimin dhe funksionimin e tyre në mënyrë të koordinuar, efektive dhe harmonike në kohë normale dhe krize.

Mbi bazën e kushtetues është krijuar dhe funksionon Këshilli i Sigurimit Kombëtar, kryetar i të cilit është Presidenti

i Republikës. Ligji mbi Pushtetet dhe Autoritet e Komandimit dhe të Drejtimit Strategjik (Nr. 8671, datë 26.10.2000) përcakton përbërjen dhe detyrat e Këshillit të Sigurimit Kombëtar. Ligji jep kryesisht një përshkrim të përgjithshëm që është karakteristik për çdo republikë parlamentare, por nuk krijon një ide të qartë për detyrimet e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit dhe më kryesorja kush punon dhe kush i ndjek në vazhdimësi çështjet e sigurimit. Nga ana tjetër, i njëjti ligj përcakton autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik, që nga Kuvendi e deri te komandantët e forcave. Vetë termi komandim dhe drejtim duket jo i përshtatshëm, sepse të drejtosh do të thotë të komandosh, aq më tepër në shkallë strategjike, por kryesorja është se si do të realizohet ky komandim, në radhë të parë në situata jo të zakonshme me një zinxhir kaq të gjatë komandimi dhe drejtimi. A nuk duhet të ketë edhe Shqipëria autoritete kombëtare të komandimit, me një përbërje të kufizuar (për shembull, Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes), i cili do të ishte një organizëm ligjor, fleksibël dhe me kompetenca specifike për çështjet e sigurimit dhe të mbrojtjes? Ndoshta mund t'ia vlejë që edhe kjo të jetë një pikë diskutimi në debatet e përgjithshme që bëhen për çështjet e sigurimit kombëtar.

Këshilli i sigurimit duhet t'i përmbahet dy parimeve themelore: ai duhet të ketë një mekanizëm për mendim dhe një tjetër për vendimmarrje. Mungesa kryesore në fushën e vendimmarrjes për sigurimin kombëtar është mungesa e kulturës politike: tërësia e cilësive të nevojshme për të shprehur qartë, për të modeluar dhe për të siguruar logjikën e veprimeve dhe qëllimeve politike, dhe kulturës strategjike: metodat që një komb dhe grupet e tjera të organizuara zgjedhin për të arritur qëllimet e tyre si dhe faktorët kulturorë që ndikojnë në mënyrën si ata kërkojnë bashkëpunimin ose rivalitetin në skenën ndërkombëtare.

Shqipëria nuk ka organizma të mirëfillta kërkimore e studimore për të kontribuar në mënyrë efektive në procesin e sigurimit kombëtar. Formulimet e strategjive dhe zgjidhja e çështjeve të sigurimit kërkon organizma të veçanta që të studiojnë në vazhdimësi dhe me studimet e këshillat e tyre të

krijojnë bazën për trajtimin konstruktiv të sigurisë si një e tërë.

Studimet, këshillat, ekspertiza dhe përvoja janë të domosdoshme, por vlera e tyre minimizohet në mungesë të një lidheshi politik dhe ushtarak të pajisur me kulturë politike dhe strategjike. Çurçilli këshillon se strategu duhet të “ketë në mendje një pamje të përgjithshme, që paraqet fillimin dhe fundin, të tërën dhe secilën pjesë përbërëse të saj, për të kthyer fjalët në vepra, idetë dhe konceptet në veprim”. Uniteti i mendimit dhe veprimit kërkon që strategët ushtarakë të kuptojnë disiplinat e tjera jashtë profesionit të tyre, dhe udhëheqësit civilë të kuptojnë pasojat e politikës për strategjinë e sigurimit kombëtar dhe atë ushtarak. Përvetësimi i artit strategjik kërkon lidhje të ngushta, bashkëpunuese midis institucioneve shtetërore dhe udhëheqës me vizion që të shikojnë përtej barrierave burokratike. Udhëheqësit politikë dhe ushtarakë duhet të punojnë ngushtësisht së bashku, duke ndërvepruar me njëri-tjetrin për qëllimet, objektivat, mënyrat e veprimit, kapacitetet dhe rreziqet sepse nuk ka një ndarje të prerë që përbën pikën ku udhëheqësit politikë dhe ushtarakë të ndajnë përgjegjësitë e tyre. Të dy palët duhet të zotërojnë artin strategjik dhe vartësia e ushtrisë nga udhëheqja civile nuk e zvogëlon rëndësinë e këshillës ushtarake për autoritetet politike ose përgjegjësinë e tyre për të komunikuar dhe koordinuar në çdo nivel të strategjisë në kohë paqeje dhe konflikti. Ky është thelbi i artit strategjik që duhet të zotërojnë lidheshi politik dhe ushtarak.

Këshilli i Sigurimit Kombëtar është një organizëm që ndihmon dhe këshillon Presidentin për çështjet e sigurisë, por në një vend, ku për arsye të ndryshme mungon kultura strategjike, Forcat e Armatosura duhet të luajnë një rol më të rëndësishëm për këto çështje në krahasim me burokracinë civile.

Këshilli i Sigurimit Kombëtar ka dhe duhet të kryejë një funksion jetik për formulimin e strategjisë së sigurimit kombëtar, e cila përbën bazën për formulimin e strategjisë ushtarake kombëtare nga hierarkia ushtarake.

Këshilli i Sigurimit Kombëtar ka edhe një detyrë tjetër jetike – vlerësimin, koordinimin dhe integrimin e informacionit

strategjik, këshillave, përvojës së vendeve të tjera dhe ekspertizës e sugjerimeve që vijnë nga Forcat e Armatosura, agjencitë shtetërore dhe organizmat kërkimore. Është e nevojshme të diskutohet nëse Këshilli i Sigurimit Kombëtar ekzistues është i strukturuar në mënyrë të përshtatshme ose jo për këtë detyrë.

Në këtë diskutim mund të jetë me vlerë të mbahet parasysh se dobësitë në trajtimin e çështjeve të sigurimit rrjedhin nga:

- Mungesa e mendimit dhe planëzimit afatgjatë për shkak të preokupimit për çështjet dhe detyrat ditore dhe afatshkurtër.
- Frenimi i mendimit të ri dhe koordinimit për çështjet e sigurimit për shkak të ndikimit të gabuar të psikologjisë së ngushtë dikasteriale.

3. Qëndrimi publik

Publiku është i interesuar për çështjet e sigurimit dhe pret që lidhshipi politik që drejton shtetin dhe institucionet e tij të marrë masa në kohë jo vetëm për mbijetesën, që përbën interesin jetik themelor kombëtar, por edhe për zhvillimin e gjithanshëm e të sigurt të vendit, të popullit dhe të individit. Publiku duhet të kuptojë në mënyrë të ndërgjegjshme domosdoshmërinë e strategjisë së sigurimit kombëtar për të kuptuar se çfarë duhet bërë dhe ku duhet të shkojë.

Shteti duhet të informojë publikun për strategjinë e sigurimit kombëtar në mënyrë të qartë, të besueshme dhe të mundshme për të fituar mbështetjen e tij. Strategjia e sigurimit kombëtar është detyrë e lidhshipit politik, presidentit dhe këshilltarëve të tij, Këshillit të Sigurimit Kombëtar, institucioneve dhe agjencive shtetërore, komisioneve parlamentare përkatëse dhe vetë Kuvendit të Shqipërisë. Kabineti qeveritar, Presidenti, Këshilli i Sigurimit Kombëtar dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm janë të emëruar, nuk janë zgjedhur nga populli në postet e tyre. Këta të emëruar janë të imunizuar nga sanksionet e drejtpërdrejta elektorale të popullit, rrjedhimisht ata mund të mos e ndiejnë nevojën për të

informuar publikun. Kuvendi gjithmonë ka fuqinë të ushtrojë kontroll ndaj strategjisë së sigurimit nëpërmjet buxhetit, ligjeve, autoritetit për të deklaruar luftën, ratifikimit të marrëveshjeve, vetos për emërimet dhe përgjegjësisë për mbikëqyrjen e veprimtarive të ekzekutivit. Një strategji mund të jetë teorikisht perfekt, mund të bazohet në realitetet e kohës dhe ta pasqyrojë atë drejt, por pa mbështetjen e atyre që do ta zbatojnë bëhet e pavlefshme. Prandaj shteti duhet të informojë gjerësisht dhe fitojë mbështetjen e publikut për strategjinë kombëtare në qoftë se duhet që kjo strategji të zbatohet dhe të jetë e suksesshme. Liderhipi politik dhe ushtarak duhet të mbajnë parasysh se ndërtimi i strategjisë së sigurimit kombëtar, zbatimi i saj dhe sigurimi i mbështetjes së publikut janë çështje institucionale dhe jo personale ose konjunkturale, sepse në një shtet që bazohet në lidhje vetjake, institucionet politike dhe ushtarake shndërrohen në vegla më shumë në duart e pushtetarëve sesa të organeve të ngritura mbi bazën e ligjit. Rezultati: një strukturë pushteti e quajtur si “pronë e dikujt”. Në një rast të tillë edhe strategjia më perfekte është e destinuar të dështojë. Fatkeqësisht, Shqipëria ka përvojë të hidhur në këtë drejtim. Megjithëse pa përvojë të mjaftueshme, dokumenti i parë i strategjisë dhe politikës së mbrojtjes që u përpilua në vitin 1994 i kishte parashikuar drejt, midis të tjerash, disa nga rreziqet e brendshme, të cilat u shfaqën me pasoja të rënda në vitin 1997, por që nuk u shmangën. Kjo duhet të na mësojë, së pari, se në radhë të parë liderhipi politik, por edhe të gjithë institucionet shtetërore, përfshirë Forcat e Armatosura, duhet të kuptojnë se me çështjet e sigurimit nuk mund të luhet, se strategjia e sigurimit kombëtar është një dokument politik themelor, ku duhet të bazohen të gjitha strategjitë e fushave të tjera, se strategjia e sigurimit nuk është një broshurë për të thënë se këtë dokument e ka dhe Shqipëria dhe të bëhet e qartë se moszbatimi i saj duhet të shoqërohet me përgjegjësi ligjore. Së dyti, koncepti i mbështetjes së sigurimit kombëtar në integrimin, pjesëmarrjen aktive dhe bashkëpunimin në organizmat rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare është i drejtë, por nuk duhet të harrojmë se politika ndërkombëtare nuk bazohet në mëshirë, por në

interesa, siç thotë Hans Morgenthrau, të trajtuara si fuqi. Përkthimi është i qartë: Shqipëria duhet të gjenerojë siguri që të mund të shpresojë të fitojë siguri nga të tjerët.

Referenca

- Bassford, Christofer. *Policy, Politics and Military Strategy*. U.S. National War College, 2006
- Buzan, Barry. *Security: A framework for analysis*, 1997
- Clinton, Hillary Rodham. “Keeping America Safe and Strong”, February 13, 2005
- Kennedy, Paul. (ed.). *Grand Strategies in War and Peace*. New Haven: Yale University Press, 1991
- Morgenthau, Hans J. *Politics Among Nations: The Struggle for Power and Peace*, Fifth Edition, Revised. New York: Alfred A. Knopf, 1978
- Lawrence, Eton. *Personnel Development and Resourcing Group*. Canada: **Strategic Thinking**, *A Discussion Paper*, **April 27, 1999**
- Ligji mbi Pushtetet dhe Autoritet e Komandimit dhe të Drejtimit Strategjik (Nr. 8671, datë 26.10.2000)
- Ranquet, Robert. “Think Tanks And The National Security Strategy Formulation Process: A Comparison Of Current American And French Patterns. *Acquisition Review Quarterly*, Winter 1997
- Roskin, Michael G. “National Interest: From Abstraction to Strategy”. *Parameters*, Winter 1994, pp. 4-18
- US Army War College. *Guide to National Security Policy and Strategy*. Part two. 2004
- Yarger, Harry R. *Strategic Theory for the 21st Century: The Little Book on Big Strategy*, 2006

ENGLISH SUMMARY

Albania towards NATO integration in 2008: Summary of two activities

Editorial Board of Security Issues

Lately public activities on Euro-Atlantic integration have intensified in Albania. With the approaching of the Washington Summit, the political class, civil society and the public at large are showing awareness that the responsibility of integration does not stop at the reform of military forces or the security sector reform, but also includes the consolidation of democracy and market economy, rule of law and the responsibility towards the regional security. These issues were emphasized in two recent national activities, the conference “Towards NATO membership 2008: Responsibilities and Duties”, organized by the Parliament of Albania and the conference “Civil Alliance 08: Together towards NATO”.

The functioning of democratic system, rule of law and market economy are ongoing challenges for the democracies

Interview with Tom Ridge

Tom Ridge, the adviser to Prime-Minister Berisha and Former Secretary for Security of President Bush, in his interview for *Security Issues*, evaluates the progress Albania has achieved in the field of security and the NATO integration process. He gives encouraging messages to the emerging contribution of Albanian civil society in the security issues as well as to the contribution of Albania to regional and

international security. Challenges that stand ahead Albania, according to the Secretary Ridge are the fight against organized crime and corruption, the strengthening of the institutions and good governance and these are ongoing challenges for any democracy.

Rethinking human security (I)

By Gary King and Christopher J. L. Murray

The authors note that many attempts to ensure the territorial security of nation-states through military power have failed to improve their total human condition. In response, the international community has moved to combine economic development with military security and other basic human rights to form a new concept “human security”. Unfortunately, by common assent the concept lack a clear definition or any agreed upon measure of it. The authors in this article address this issue.

Political parties and security issues

By Prof. Dr. Servet Pëllumbi

The former chair to parliament, Prof. Dr. Servet Pëllumbi evaluates the roles the political parties play in the security of the country. His starting point is the concept that the parties in a democratic system should be the generators of politics of security. When analyzing the Albanian case he finds this function of political parties wanting and makes the case for a consensual policy across party lines on major issues of national security, prosperity and Euro-Atlantic integration.

Security and defense structures in the age of information

By Zana Xhuka

The current deputy minister of Albania, Zana Xhuka, in

her article summarizes the changes that the revolution in information technologies has brought to the field of security and defense. Some of the areas that she emphasizes are the enlargement of the military strategic capacity, the transformation of military structures and the operations in the field, as well as the changes in the intelligence. Xhuka mentions that to the there traditional dimensions of combat: land, sea air, a fourth one, cyberspace, is added and then she considers some of the implications for the reforms of the armed forces and the war strategies.

Emergency Management Pillar of the Civil Security: Practical Approach

By *Jeffrey Winbourne* and Dr. Velizar Shalamanov

Safety and security are the key elements of the quality of life for all EU citizens and this is an issue of all Association and Stabilization Agreement (ASA) countries as well as new community of the EU Neighborhood Policy (ENP) countries. Recognizing that security is “citizen centric” nowadays the first concern has to be indeed the safety of every EU / ENP citizen and society as a whole. Most common threat is connected with different types of hazardous events – from everyday incidents to the major emergencies, including consequences from man-made, technological accidents and even terrorist acts. This article makes the case for a practical approach to emergency management architecture in European and Euro-Atlantic geographic space, focusing on the IEMS-112 system.

Prospects of NATO integration for Albania and the other countries of the Western Balkans

By *Theodossis Georgiou* and *Matthew Vaikoussis*

The article argues for the NATO integration of Albania and the neighbouring countries, combining the Alliance’s

perspective with the Greek and regional ones. The integration to Euro-Atlantic contexts for countries of the Western Balkans is of major importance for the stability, cooperation, political and economic advance, crime and terrorism decline, political transparency and the general progress of the region. The road to membership has been the driving force for democracy, good neighborly relations and reforms in each individual Balkan country. This performance-driven dynamic will reduce destabilizing effects in the Western Balkans and curb radicalism.

The Comprehensive Political Guidance: A primer

By Paul Saveroux

The Comprehensive Political Guidance (CPG) provides a framework and political direction for NATO's continuing transformation, setting out priorities for all Alliance capability issues, planning and intelligence. Among other points, the CPG identifies terrorism and the spread of weapons of mass destruction as the likely threats to the Alliance over the next 10 to 15 years. The document also underlines the requirement for NATO's forces to remain balanced, flexible and agile, and able to conduct the full range of its missions from high to low intensity. The CPG stresses the need for cooperation with non-NATO nations, institutions and organizations, and for more detailed capability requirements, including the ability to conduct and sustain operations far from home territory with little or no host country support. The implementation of the CPG should lead to the development of more usable capabilities for future operations and missions, thereby ensuring that the Alliance remains effective, credible and relevant in the 21st century.

Terrorist threats to NATO countries: A bestiary

By Friedrich Steinhäusler

Many of the challenges that face NATO member countries are still emerging and pose high risks. These include the threat of global jihad, suicide terrorism, home-grown terror, radiological attack, and weapons of mass destruction. All NATO Summits since 1999 have adopted incremental measures to fight terrorism. In particular, a 2004 “Defence Against Terrorism Programme of Work”, launched under the Conference of National Armaments Directors, has aimed at the coordinated development of cutting-edge technologies to counter terrorist threats. NATO Countries have also adopted a Comprehensive Political Guidance that highlights on the threats posed by terrorism and the spread of weapons of mass destruction. In addition, the Allies now have a fully operational NATO Response Force at their disposal that enhances the Alliance’s ability to mount expeditionary operations. This capability, in turn, will prove useful in confronting threats that originate within failed states. For the foreseeable future, global terrorism will remain the greatest threat to transatlantic defense.

Political and military leadership and its role in national security

By *Col. (ret.). Selim Shiroka*

Ahead of the political and military leadership lies the task of providing the country with a defense strategy. The authors looks into the components of such a strategy for a small, but strategically positioned country, such as Albania. The duty of the leadership is to combine and ensure the harmony of three levels of security: individual, national and international. The consequence is the creation of a specific model of security strategy that takes into account the geography, history, geopolitics and international allies, economic and social stability, and political aims.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHTJE TË SIGURISË - 3

Formati: 15.5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: (4) 240116
Tiranë, 2006